



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Inxhinieri  
Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri  
Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria  
Kibernetike; Multimedia-Dizajn"**

**Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"**

### Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

**Prof. Thoma KORINI**

**Prof.Asoc. Ana KTONA**

**Shkurt / 2023**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn"**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierisë Softuerike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Msc në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr. 565, datë 02.12.2016
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASh Nr. 146, datë 28.08.2020 per profilin Inxhinieri Kompjuterike dhe Big Data; UMASh Nr. 147, datë 28.08.2020 per profilin Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; UMASh Nr. 149, datë 28.08.2020 per profilin Multimedia-Dizajn
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 75 datë 04-10-2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike/ 4 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-

14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishhtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10 PAE/3PAK v.a. 2021-2022 7 PAE/5PAK v.a. 2020-2021 7PAE/5 PAK v.a. 2019-2020
18	Numri i studentëve:	30 Studentë v.a. 2021-2022 51 Studentë v.a. 2020-2021 63 Studentë v.a. 2019-2020
19	Komente / të tjera:	-

## **PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" (KU IKT) është një institucion privat i arsimit të lartë, i licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.781 dt.10.11.2011. KU IKT i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 116, datë 15.12.2017, me kohëzgjatje 5 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 14.12.2022.

Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" ka 2 njësi kryesore: Fakultetin e Inxhinierisë dhe Fakultetin e Ekonomisë. Statuti i KU IKT, në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 "PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" është miratuar me Vendim Senati Akademik të KU IKT nr. 69, datë 21.09.2016 dhe Urdhër Nr.556, datë 24.11.2016 të MASR.

Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn" është hapur me Urdhër Nr. 565, datë 2.12.2016 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë universitare Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profilet përkatëse. Regjistrimi i formës së diplomës i realizuar me Urdhër Nr.146, datë 28. 8. 2020 të MASR, në përputhje me Vendimin nr.75, datë 14.10.2019 të Bordit të Akreditimit "Për Akreditimin e Parë programit të Ciklit të Dytë të Studimit, "Master i Shkencave" në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn" të Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" është e vlefshme deri në datën 30.09.2022. Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Inxhinierisë Softuerike, njësi përbërëse e Fakultetit të Inxhinierisë.


Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 2 vite akademike dhe është organizuar në bazë të sistemit European të transferimit të krediteve në 120 kredite ECTS. Qëllimi i këtij programi studimesh është të përgatisë studentët me njohuri të avancuara mbi rrjetet kompjuterike, sigurinë kibernetike, përpunimin e të dhënave Big Data dhe fushën e Multimedia-Dizajnit, si dhe t'u ofrojë aktorëve të industrisë dhe biznesit specialistët e duhur, me formimin përkatës.

Programi i studimit ofrohet në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e KU IKT. Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn" është akredituar për herë të parë me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 75 datë 4.10.2019, për një periudhë 3 vjeçare. KU IKT ka aplikuar në ASCAL për riakreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn" më datë 25.10.2021. Në këtë mënyrë, kemi të bëjmë me akreditimin periodik të këtij programi studimi.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i përgatitur në Prill 2022. Ky Raport siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur KU IKT për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. KU IKT, po ashtu, nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL, vuri në dispozicion të vlerësuesve një numër eviencash mbështetëse.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkuara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr.531, datë 11.9.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin e MASR Nr. 1, datë 14.1.2020, për “Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë”, Udhëzimin e MASR Nr. 22, datë 3.9.2020, Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë” si dhe gjithë aktet e tjera nënligjore që kanë të bëjnë me organizimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë. GVJ gjatë vlerësimit të jashtëm u mbështet nga specialisti i ASCAL, MSc. Muhamed Prezja. Takimet në institucion, u zhvilluan sipas programit të miratuar nga ASCAL. Takimet në institucion konsistuan në zhvillimin e diskutimeve, me Dekanin e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Përgjegjësin e Departamentit të Inxhinierisë Softuerike, Grupin e Vlerësimit të brendshëm, stafin akademik, studentët, përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Komisionit të Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet, Aplikimet dhe Inovacionin, përfaqësues të Komisionit të Përhershëm për Kurrikulat dhe Programet Mësimore, përfaqësues të Zyrës së Shërbimit ndaj Studentëve si dhe përfaqësues të Sekretarisë Mësimore. Gjithashtu u zhvillua edhe një vizitë e auditorëve, laboratorëve si dhe bibliotekës, shoqëruar me diskutime për elementë lidhur me këtë infrastrukturë. Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kualifikimin e stafit akademik, etj. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet shtesë që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave të paraqitura.



## SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

### I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.75, datë 4.10.2019 janë [Ev. Akreditimi i pare i programit MSc ne Inxh Kompj dhe IT me tre profile nr. 75 date 17.04.2019]:

1. Institucioni të rekrutojë staf të ri akademik me qëllim mbulimin e ngarkesës mësimore të programit të studimit me staf akademik efektiv në masën të paktën 70%.
2. Institucioni, të rishikojë kategorizimin e lëndëve sipas veprimtarisë formuese, në përputhje me VKM nr. 41 datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë".
3. Institucioni, të shtojë përfshirjen e studentëve në projekte kërkimore shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare.

### II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Nga një analizë e dokumentacionit në dispozicion, diskutimeve në lidhje me këta elementë në institucion dhe një vlerësimi të detajuar GVJ është i mendimit se:

Institucioni ka rritur angazhimin e personelit akademik efektiv (PAE) në raport me personelin akademik me kontratë (PAK), duke kaluar nga raporti 7 PAE / 5 PAK në vitin 2019-2020 në raportin 10 PAE/3 PAK në vitin akademik 2021-2022. Në këtë mënyrë është arritur që personeli akademik efektiv të mbulojë rreth 88% të ngarkesës së programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn", ndërsa personeli akademik me kontratë të mbulojë rreth 12% të ngarkesës. Në këtë mënyrë, GVJ konkludon se, rekomandimi i Bordit të Akreditimit është **përmbushur plotësisht**.

Referuar planit mësimor, konstatohet se për programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn", është rishikuar kategorizimi i lëndëve sipas veprimtarisë formuese, në përputhje me VKM nr. 41 datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë". Në këtë mënyrë, lëndët bazë përbëjnë 10% në kredite të formimit të përgjithshëm të programit të studimit, lëndët karakterizuese 55%, lëndët ndërdisiplinore/integruese 10%, lëndët plotësuese 10%, ndërsa detyrimet përmbyllëse përbëjnë 15% në kredite. Kjo është e vlefshme për të gjithë profilet e programit të studimit. GVJ konkludon se rekomandimi i Bordit të Akreditimit është **është përmbushur plotësisht**.

Referuar RVB dhe takimeve në institucion konstatohet se Institucioni ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh në kuadër të programeve Erasmus + si dhe CEEPUS. Gjithashtu për tre vitet e fundit konstatohet se ka një angazhim të konsiderueshëm të studentëve në punën shkencore individuale të personelit akademik (11 studentë), në projekte shkencore të departamentit (12 studentë), në projekte shkencore të Fakultetit të Inxhinierisë (17 studentë) si dhe në projekte

shkencorë në bashkëpunim me të tjerë (9 studentë). Megjithëse angazhimi i studentëve në projekte kërkimore shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare duhet të vazhdojë të mbetet një prioritet i institucionit, GVJ është i mendimit se rekomandimi i Bordit të Akreditimit është **përmbushur plotësisht**.

Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 23.01.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 37 Prot, datë 23.01.2023. Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" përcjell në ASCAL më datë 31.01.2023, me anë të shkresës me Nr. 59/1 Prot, datë 30.01.2023, "Mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit", ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn"**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi "Master i shkencave", në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron program studimi "Master i shkencave"/"Master i arteve" që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" u shërben interesave kombëtare duke përgatitur specialistë të cilët me kompetencat e tyre do t'i shërbejnë zhvillimit teknologjik në një fushë me zhvillim të shpejtë e me kontribut parësor në modernizimin e vendit.  Profili "Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike" ofrohet për studentët e diplomuar që dëshirojnë të punësohen në kompani që kërkojnë njohuri dhe aftësi të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit kompjuterik; të sistemeve operative të

	<p>sigurta, të aplikacioneve të sigurta, apo të vazhdojnë doktoraturën në fushën e sigurisë së informacionit. Gjithashtu, të kuptojnë se si zhvillohet një politikë e sigurisë dhe si politikat drejtojnë vendimet teknologjike, bazuar në njohuritë teorike dhe punës laboratorike në fushën e sigurisë së informacionit.</p> <p>Profili “Inxhinieri Kompjuterike dhe Big Data” është i përcaktuar për studentët me baza të forta në matematikë, shkencat kompjuterike, dhe statistikë të aplikuar. Programi ka si objektiv të sigurojë teorinë dhe metodat themelore të kërkimit të të dhënave, duke plotësuar nevojën e tregut të punës me profesionistë në fushën e të dhënave.</p> <p>Profili “Inxhinieri Kompjuterike dhe Multimedia Dizajn” ofron njohuri kompjuterike, njohuri në fushën e komunikimit interaktiv, përdorimin e teknikave për vizualizimin e të dhënave dhe krijimin e ndërfaqeve të sistemeve kompjuterike. Programi ka si objektiv të formojë inxhinierë me aftësi për projektim dhe ndërtim të ndërfaqeve softuere, për të gjitha platformat celulare, tabletë, desktopët, TV dhe pajisjet te tjera.</p> <p><b>[Ev. nr. 10. Rregullore e programit mesimor Master ne Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni]</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Nga shqyrtimi i statutit të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” [Ev. nr. 1 Statuti i KU IKT 2016, neni 4, Vizioni dhe Misioni.] vlerësohet se programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile “Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn”, synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p> <p>Vizioni i Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” është si vijon:</p> <p><i>“Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” është i vendosur që të përgatisë studentë me aftësi të mbështetura mbi edukimin, vlerat dhe shpirtin etik, mendimin kritik, atë analitik dhe të orientuar drejt zgjidhjes së problemeve, kreativitetit, inovacionit dhe lidershit, të cilat ata do t'i përdorin për t'i dhënë formë jetës, karrierës dhe shoqërisë.”</i></p>



	<p>Misioni i Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" është si vijon:</p> <p><i>"Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" përmes promovimit të kurrikulave të përgatitura me kujdes, mësimdhënies, kërkimit shkencor, hapjes së programeve të reja, ka si mision zhvillimin e aftësive personale dhe mundësive, nxitjen e konkurrencës dhe përmirësimit të cilësisë së edukimit në shërbim të vlerave, duke vlerësuar dhe respektuar diversitetin kulturor dhe vlerat e Shqipërisë."</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Fusha e veprimtarisë së programit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" është teknologjia e informacionit. Në këtë kuadër ky program është në përputhje me qëllimet dhe misionin e Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë". Ndër qëllimet e institucionit është: Ofrimi i programeve të studimit në fushën e teknologjisë së informacionit dhe ekonomisë.</p> <p><b>[Ev. nr. 1 Statuti i KU IKT 2016, neni 4, Misioni]</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn", mundëson që studentët shqiptarë të edukohen me vlera akademike sipas eksperiencës më të mirë ndërkombëtare, përmes një kurrikule të ndërtuar me kujdes dhe në përputhje me fushën e studimit. Programi i studimit synon të përgatisë studentët për karrierë sipas kërkesave teknike të industrisë së inxhinierisë kompjuterike, IT, telekomunikacionit të institucioneve financiare si dhe për studime pasuniversitare post-master në Inxhinieri Kompjuterike ose në fusha të ngjashme. Thelbi i programit fokusohet në formimin e të menduarit kritik të studentëve, aftësinë për të menduar dhe vepruar në të njëjtën kohë si dhe për të gjykuar situata specifike duke dhënë ndihmesë në nxitjen e zhvillimit ekonomik kombëtar. <b>[Ev. nr. 10. Rregullore e programit mesimor Master ne Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni]</b> Programi është hartuar në përputhje me studimin e tregut <b>[Ev. 18. Studimi i tregut &amp; Plani Financiar per hapjen e prog BSc dhe MSc</b></p>

	<b>ne Inxh. Kompj dhe IT, 2016]</b> dhe është miratuar prej Senatit Akademik përmes vendimit nr.1, datë 11/02/2016. [Ev. 1.7 VSA nr.1 date 11.02.2016 aplikim per licensim e progrmeve te reja]			
<b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor	Nga analiza e dokumentacionit të programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile “Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn” dhe takimet në institucion, GVJ arrin në konkluzionin se programi i studimit krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor dhe mundëson përgatitjen e specialistëve me një nivel të tillë njohurish që bën të mundur integrimin e tyre lehtësisht si në tregun lokal të punës ashtu dhe në atë ndërkombëtar, përfshirë dhe angazhimin në veprimtari kërkimore.  [Ev. nr. 10. Rregullore e programit mesimor Master ne Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni; Ev. nr. 16. Planet mesimore 2021 -2022, 2020 - 2021, 2019-2020]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi I.2

**Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Referuar Strategjisë së Zhvillimit të KU IKT [Ev. Nr. 2. <b>Strategjia e Zhvillimit te KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017]</b> dhe takimeve në institucion, GVJ është i mendimit se programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile “Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn” është në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të KU IKT duke qenë se në misionin e KU IKT përcaktohet zhvillimi i aftësive personale dhe mundësive, nxitja e

	<p>konkurrencës dhe përmirësimit të cilësisë së edukimit në shërbim të vlerave, duke vlerësuar dhe respektuar diversitetin kulturor dhe vlerat e Shqipërisë përmes promovimit të kurrikulave të përgatitura me kujdes, mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe hapjes së programeve të reja.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Në drejtimet prioritare të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” përcaktohet formimi i studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit, në fushën e inxhinierisë dhe të ekonomisë. [Ev. nr. 1 Statuti i KU IKT 2016, neni 4, <b>Vizioni dhe Misioni.</b>] Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile “Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn” synon të përgatisë studentët për karrierë sipas kërkesave teknike të industrisë së inxhinierisë kompjuterike, IT, telekomunikacionit dhe të institucioneve financiare. [Ev. nr. 10. <b>Rregullore e programit mesimor Master ne Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni</b>]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Në Rregulloren e Fakultetit të Inxhinierisë përcaktohet se misioni i tij është të përgatisë studentë në fushën e Inxhinierisë Kompjuterike, Teknologjisë së Informacionit, Inxhinierisë Softuerike, Inxhinierisë Industriale dhe disiplinave të tjera të shkencës dhe inxhinierisë, duke dëshmuar për një përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p> <p>[Ev. nr. 8. <b>Regullore e Fakultetit te Inxhinierise; Ev. nr. 10. Rregullore e programit mesimor Master ne Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni; Ev. nr. 1 Statuti i KU IKT 2016, neni 4, Vizioni dhe Misioni.</b>]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Duke ju referuar Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, ku përcaktohen si objektiva strategjike:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmirësimi i infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit si shtylla e zhvillimit të shpejtë të Shoqërisë Shqiptare të Informacionit dhe rritje e gatishmërisë elektronike;</li> <li>- Zhvillimi i mëtejshëm i qeverisjes elektronike dhe realizimi i shërbimeve publike në mënyrë ndëraktive përmes internetit për qytetarët.</li> </ul>

	<p>GVJ është i mendimit se programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" është në përputhje me këtë Strategji në shërbim të interesit kombëtar.</p> <p>Studimi i tregut Janar 2016, i lidhur me programin e studimit [Ev. nr. 18. Studimi i tregut &amp; Plani Financiar per hapjen e prog BSc dhe MSc ne Inxh. Kompj dhe IT, 2016] jep te dhena mbi mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar. Fushat që mbulon programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" janë në përputhje me kërkesat e tregut, me progresin dhe strategjitë e zhvillimit ekonomik të vendit si dhe në përputhje me trendet globale të zhvillimit.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  X

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në institucion GVJ konstatoi se programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" ka për qëllim pajisjen e studentëve me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njohuri dhe koncepte bazë në fushat përkatëse të studimit dhe njohuri të thelluara të fushës kryesore të studimit;</li> <li>- Aftësi për një profesion apo licencë profesionale;</li> <li>- Formim teorik dhe praktik në fushën e zgjedhur;</li> </ul>

<p>cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Aftësi të zhvilluara për kërkim shkencor në fushën e studimit;</li> <li>- Aftësi praktike, të zbatueshme dhe kërkimore;</li> <li>- Aftësi për promovim personal dhe profesional.</li> </ul> <p><b>[Ev. Nr. 10. Ev. 10. Rregullore e programit mesimor Master ne Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni: 3.3 Objektivat e Programit të Studimit]</b></p> <p>Diskutimet me personelin akademik të programit të studimit dhe studentët të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, dëshmojnë për një program studimi i cili zhvillon njohurit të thelluara shkencore, aftësi e kompetenca profesionale të vlerësuara nga tregu i punës <b>[Takime në institucion].</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Në Janar të viti 2016, institucioni ka kryer një studim tregu lidhur me programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" <b>[Ev. Nr.18. Studimi i tregut &amp; Plani Financiar per hapjen e prog BSc dhe MSc ne Inxh. Kompj dhe IT, 2016]</b> i cili është hapur në 2017. Studimi i tregut i vitit 2016, jep te dhëna mbi programet bachelor dhe master të ofruara në fushën e Inxhinierisë kompjuterike dhe Teknologjisë së Informacionit në IAL publike dhe private, mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; apo edhe numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet te tjera.</p> <p>Gjithashtu, për të patur një vështrim të përditësuar mbi tregun e punës dhe integrimin e të diplomuarve të Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" në përgjithësi dhe të programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" në veçanti, GVJ u njoh me studime periodike të organizuar nga institucioni.</p> <p><b>[Ev. Nr. 4. Vleresimi i Programit te Studimit, Tregu i Punes dhe te dhena per studentet pas diplomimit 2019-2021;]</b></p>

**Kriteri 3.** Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.

Në përfundim të studimeve studentët e programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" synohet të punësohen si:

Profili "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data:

- Profesionist/oficer i analizës së të dhënave
- Profesionist/analist i informacionit përgjegjës për analizën statistikore
- Profesionist/analist i të dhënave në ueb
- Profesionist/analist i të dhënave të marketingut
- Konsulent i jashtëm
- Zhvilluesi i sistemit
- Hulumtues në Institucione Financiare ose Hulumtues Operacional

Profili "Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike":

- Profesionist teknik tek kompanitë e mëdha në fushën e sigurisë
- Profesionist/oficer i sigurisë së informacionit
- Analist i inteligjencës
- Profesionist/oficer i informacionit kritik
- Specialist i sigurisë kibernetike
- Profesionist i teknologjisë së sigurisë
- Audituesi i sistemit të informacionit
- Profesionist i hakerimit mjeko-ligjor dhe etik
- Konsulent për sigurinë e informacionit
- Menaxheri i rrjetit
- Administrator IT
- CIO (Drejtues Kryesor i Informacionit)
- Dhe pozicione të tjera që lidhen me sigurinë e informacionit dhe menaxhimin e rrjetit

Profili "Multimedia-Dizajn":

- Profesionistë/konsulentë të multimedias
- Projektues Multimedial
- Animatorë ose prodhues audio dhe video
- Profesionist i teknologjisë së informacionit


	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Profesionalist i IT-së për departamentet qeveritare dhe organizatat kulturore</li> <li>- Krijues i imazhit të OJQ-ve dhe sektorit privat</li> <li>- Sistemet kompjuterike që dizajnojnë profesionistë të industrisë</li> <li>- Profesionalist në industrinë e botimit të softuerëve</li> <li>- Profesionalist në industrinë e reklamave</li> <li>- Profesionalist i marketingut dhe publikimit në ueb</li> <li>- Specialist i studiove televizive dhe krijuese</li> </ul> <p><b>[Ev. 10. Rregullore e programit mesimor Master ne Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni; Takime në institucion]</b></p> <p>Përsa i përket përmbajtjes, GVJ arrin në konkluzionin se në secilin profil të këtij program studiumi janë pasqyruar elementët e nevojshëm formues të cilët garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës, lehtësojnë punësimin e studentëve, mundësojnë transferimin e studimeve në fusha të ngjajshme si brenda institucionit, ashtu edhe në institucione të tjerë që ofrojnë programe të ngjajshme studimi.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Nga analiza e planit mësimor dhe përmbajtjes së programit të studimit si dhe nga takimet e zhvilluara në institucion GVJ u informua se në përgjithësi programet e studimit të ofruara nga KU IKT dhe në mënyrë të veçantë programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" bazohen në kurrikulat Kanadeze. Një gjë e tillë si dhe fakti që programi i studimit zhvillohet në gjuhën angleze, lehtëson njohjen e këtij programi edhe jashtë vendit. Për t'u përshtatur me legjislacionin shqiptar (dhe me sistemin europian në përgjithësi), vlerësimi i lëndëve të programit bëhet me kredite ECTS, por njëkohësisht ofrohet edhe konvertimi sipas sistemit amerikano-verior <b>[Ev. 10. Rregullore e programit mesimor Master ne Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni; Takime në institucion.]</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e</p>	<p>Nga analiza e strukturës së programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG</p>

<p>BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn”, GVJ konstatoi se ai është i organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Elementët e programit të studimit janë në përputhje me VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” [Ev. <b>10. Rregullore e programit mesimor Master ne Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni</b>]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" në funksion të formimit me aftësi profesionale në fushën e Inxhinierisë Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjeteve Kompjuterike dhe Sigurisë Kibernetike; Multimedia-Dizajn përfshin praktikën profesionale prej 12 kreditesh ECTS e cila zhvillohet pranë sipërmarrjeve, bizneseve apo kompanive të ndryshme. [Ev. <b>75. Manuali i Internshipit Master shqip</b>] Bazuar në planin mesimor, praktika mesimore zhvillohet në vitin e dytë, në semestrin e dytë dhe zgjat një semestër. [Ev. <b>16. Planet mesimore 2021 -2022, 2020 - 2021, 2019-2020</b>]</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Referuar Statutit të Institucionit, Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” e zhvillon aktivitetin e tij akademik në gjuhën angleze. Në këtë mënyrë programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile “Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn”, zhvillohet plotësisht në gjuhën angleze duke kontribuar jo vetëm në rritjen e mobilitetit të studentëve dhe forcimin e kërkimit shkencor, por edhe në ndërkombëtarizimin e institucionit. Kjo i ka hapur mundësinë institucionit edhe për thithjen e studentëve të huaj [Ev. <b>1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar, Neni 65, Pika 7</b>].</p>



<p><b>Kriteri 8.</b> Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>Duke qenë se programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile “Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn”, zhvillohet plotësisht në gjuhën angleze, kjo lehtëson ruajtjen e dokumentacionit në gjuhën angleze. [Ev. 7. Libri i Rregulloreve Institucionale]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi I.4</b>  <b>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile “Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn” ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë Softuerike (DIS), pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë. Ky program mbështetet nga një staf total prej 10 punonjësish akademikë efektivë (të dhënat për vitin akademik 2021-2022). Përsa i përket PAE të angazhuar në këtë program studimi, 8 prej tyre janë me gradën shkencore “Doktor”, 1 me titullin akademik “Profesor i Asociuar”, dhe 1 me titullin akademik “Profesor”. Referuar fushës individuale të kualifikimit, GVJ konstatoi se personeli i angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" disponon formimin e duhur për të garantuar një mësimdhënie cilësore [Ev. RVB; Ev. 20. CV e stafit akademik të programit të studimit].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e</p>	<p>Duke ju referuar strukturës së Fakultetit të Inxhinierisë dhe programeve të ofruara të studimeve, GVJ konstatoi se ky fakultet ka në përbërjen e tij 3 njësi bazë (dy departamente dhe një qendër për inovacionin, kërkimin dhe zhvillimin), të cilat garantojnë formimin në diploma që lidhen me inxhinierinë</p>



<p>studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>kompjuterike dhe atë të telekomunikacionit [Ev. 8. Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë]. Në këtë mënyrë, GVJ konkludon se ka një përputhje ndërmjet fushës së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit dhe fushës akademike e kërkimore të Fakultetit të Inxhinierisë. Duke ju referuar kërkesave të Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” përse i përket kodifikimit të programeve të studimit, në kushtet kur mungojnë aktet nënligjore, institucioni ka aplikuar kodifikimin e brendshëm të lëndëve të programit të studimit [Ev. 22. Rregullorja për Kodifikimin e Lendeve].</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Softuerike, përgjegjës për programin e studimeve Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile “Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn”, është pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe takimet në institucion, GVJ konstatoi se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamenti të Inxhinierisë Softuerike. [Ev. 9. Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Softuerike;].</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p><b>Standardi I.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe</p>	<p>Hartimi, mbikëqyrja dhe mbarëvajtja e programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji</p>

<p>mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" mbulohet nga Departamenti i Inxhinierisë Softuerike. Për të mundësuar formimin e studentëve me njohuritë e kërkuara për këtë program të ciklit të dytë, Departamenti i Inxhinierisë Softuerike bashkëpunon edhe me departamente të tjerë të Fakultetit të Inxhinierisë si dhe më gjerë në nivel institucioni duke përcaktuar si nivelin e angazhimit ashtu edhe detyrimet reciproke. Marrëdhëniet ndërmjet njërive brenda institucionit rregullohen nëpërmjet Statutit, Rregullores Institucionale, Librit të Rregulloreve Institucionale, Rregullores së Fakultetit të Inxhinierisë, Rregullores së Departamentit të Inxhinierisë Softuerike, Manualit të Stafit Akademik, etj. [Ev. RVB, Ev. Rregullore të ndryshme; Takime në institucion;].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të DVV, GVJ konstatoi se KU IKT ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit si dhe me aktorë të biznesit [Ev. 23. Marrëveshjet ne kuader te Erasmus+ 2016-2022; Ev. 24. Marrëveshjet me universitetet 2016 – 2022; Ev. 25. Marrëveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione te tjera 2016 - 2022]. Marrëveshjet me institucione homologe jashtë vendit i kanë shërbyer kryesisht mobilitetit si të personelit akademik ashtu edhe të studentëve, por edhe realizimit të konferencave të përbashkëta shkencore si për stafin akademik ashtu dhe për studentët. Përsa u përket marrëveshjeve me biznesin, ato i kanë shërbyer jo vetëm marrjes së informacionit mbi kërkesat e tyre si dhe parashtrimin të ofertave të punësimit, por edhe të garantimit të realizimit të praktikave mësimore [Dok DVV RVB Aneks 1, Tabela 5; Aneks 2, Tab: nr. 19, Tab: nr. 21, Tab: nr. 22]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Marrëveshjet me institucione kërkimore, sipërmarrje, kompani të fushës së inxhinierisë kompjuterike kontribuojnë që studentët e programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" të zhvillojnë praktikat mësimore pranë këtyre institucioneve përgjatë periudhës së përcaktuar në programin e studimit. Gjithashtu institucioni gjatë kësaj kohe është kujdesur që t'u ofrojë studentëve trajnime të ndryshme falas, në mënyrë që ata të</p>

	përformojnë sa më mirë kur aplikojnë për një praktikë mësimore apo një vend pune. [Dok DVV RVB Aneks 1, Tabela 5; Ev. 25. Marrëveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione te tjera 2016 - 2022].			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.	Marrëveshjet me komunitetin e biznesit dhe shoqëritë private, i kanë shërbyer kryesisht realizimit të praktikave profesionale me studentët, krijimit të mundësive të punësimit me kohë të pjeshme të studentëve si dhe punësimit të tyre mbas diplomimit [Dok DVV RVB Aneks 1, Tabela 5; Ev. 25. Marrëveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione te tjera 2016 - 2022]			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	Për vetë natyrën e programit të studimit, realizimi me sukses i të cilit kërkon angazhimin në kërkimin shkencor, KU IKT është i angazhuar në bashkëpunimin reciprok me institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit të cilat kanë ofruar mbështetje në disa fusha të rëndësishme si bashkëpunimi në kërkimin shkencor dhe organizimin e konferencave të përbashkëta, mobilitetet të stafit dhe studentëve, aplikim për projekte të përbashkëta, organizimin e konferencave studentore etj. Bashkëpunimi me institucione të huaja dhe mobilitetet në këto institucione favorizohen edhe nga fakti që KU IKT zhvillon procesin mësimor në gjuhën angleze [Ev. 23. Marrëveshjet ne kuader te Erasmus+ 2016-2022; Ev. 24. Marrëveshjet me universitetet 2016 – 2022; Dok DVV RVB Aneks 1, Tabela 5; Aneks 2, Tab: nr. 19, Tab: nr. 21, Tab: nr. 22].			
<b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	Të dhënat në lidhje me programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn", të cilat përfshijnë informacione në lidhje me konferencat e organizuara, seminarët, leksionet e hapura, marrëveshjet e bashkëpunimit, mobilitetet akademike dhe ato studentore, përpunohen prej zyrave përkatëse dhe publikohen në raportet vjetore që institucioni përgatit për MAS. [Ev. 26. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS; <a href="https://cit.edu.al/annual-report-2/">https://cit.edu.al/annual-report-2/</a> ]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>

<b>Standardi I.6</b>	
<b>Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se publikimi i rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve mbështetet fuqimisht nga institucioni duke ofruar: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mundësinë e publikimit në revistën Shkencore CIT Review.</li> <li>- Organizimin e konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe publikimin e materialeve në Proceedings apo revistën shkencore.</li> <li>- Mbështetjen e studentëve dhe stafit akademik për pjesëmarrje me punimet e tyre në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.</li> <li>- Organizimin e konferencave studentore dhe publikimin e rezultateve. <b>[Dok DVV RVB, Ankes 2]</b></li> </ul>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Vlerësimi i ecurisë së rezultateve në fushën e kërkimit shkencor realizohet nga Qendra për Inovacionin, Kërkimin dhe Zhvillimin e cila përgatit raporte periodike me përmbledhje të dhënash lidhur me kërkimin shkencor, shoqëruar me një analizë e duke përcaktuar edhe objektiva për të ardhmen. <b>[Dok DVV RVB, Ankes 2]</b> Këto qendra janë në nivel fakulteti. Departamentet së bashku me Këshillat e Fakulteteve kontribuojnë në raport duke dërguar informacion mbi kërkimin shkencor i cili vlerësohet nga rektorati. Nëse kërkohet, raportimi mbi kërkimin shkencor bëhet edhe në senat. <b>[Ev. Nr. 7. Libri i Rregulloreve Institucionale]</b> IKT ka akorduar certifikata dhe çmime të ndryshme për stafin, partnerët dhe studentët. <b>[Dok DVV RVB, Ankes 2: Tabela Nr.7/1 &amp; Tabela Nr. 9.1]</b>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Institucioni ka hartuar Strategjinë e RDC - Kërkimit, Zhvillimit dhe Krijimtarisë <b>[Ev. 5. Strategjia e RDC (Kërkimit, Zhvillimit dhe Krijimtarisë) 2014-2024]</b> . Bazuar në parimet e kësaj strategjie institucioni inkurajon dhe mbështet pjesëmarrjen në kërkimin shkencor. Kjo mbështetje fillon që në fazën e programimit të zhvillimit të aktiviteteve kërkimore dhe të

	parashikimit të mbështetjes financiare përkatëse, mbështetjen financiare për pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare e deri në reduktimin e ngarkesës së personelit akademik të angazhuar në programe studimi doktorate [Dok DVV RVB; Takime në institucion].			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	Në nenin 101 të Statutit përcaktohet se KU IKT, ruan të dhënat personale të studentëve, sipas kuadrit ligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Përsa i përket veprimtarisë botuese ajo i nënshtrohet një procesi vlerësimi (peer review) duke ruajtur konfidencialitetin [Ev. 1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar, Neni 101; <a href="https://crj.cit.edu.al/">https://crj.cit.edu.al/</a> ].			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	GVJ konstaton angazhimin e studentëve në aktivitet shkencor të KU IKT duke i bërë pjesë të punës kërkimore të personelit akademik. [Dok DVV RVB, Aneksi 1, Tabela 22, “Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë, në tre vitet e fundit”]. Fakulteti i Inxhinierisë ka organizuar disa konferenca studentore të cilat inkurajojnë ndërmarrjet e iniciativave vetjake të studentëve në fushën e kërkimit shkencor [Dok DVV RVB, Aneksi 2, Tabela nr. 6: Konferenca studentore, seminare dhe kompeticione të organizuara prej Fakultetit të Inxhinierisë.]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit është i organizuar në lëndë e	Referuar planit mësimor, GVJ konstatoi se programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji

<p>module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" është i organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Forma e studimit për këtë program është me kohë të plotë dhe realizohet për 2 vite akademike me nga 2 semestra secili. Përfundimit të këtij programi studimesh i korrespondon grumbullimi i 120 krediteve ECTS, duke realizuar çdo vit 60 kredite. <b>[Ev. Nr10. Rregullore e programit mesimor Master ne Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni]</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" i korrespondon Nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve duke fituar njohuritë, afësitë dhe kompetencat për të mundësuar punësimin si: <b>[Ev. Nr10. Rregullore e programit mesimor Master ne Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni]</b></p> <p><b>&gt; Profili "Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teknik i lartë për kompanitë e mëdha në fushën e sigurisë</li> <li>• Profesional/oficer i sigurisë së informacionit</li> <li>• Analist i inteligjencës</li> <li>• Profesional/oficer i informacionit kritik</li> <li>• Specialist i sigurisë kibernetike</li> <li>• Profesionist i teknologjisë së sigurisë</li> <li>• Audituesi i sistemit të informacionit</li> <li>• Profesionist i mjekësisë ligjore dhe hakerimit etik</li> <li>• Konsulent për sigurinë e informacionit</li> <li>• Menaxheri i rrjetit</li> <li>• Administrator IT</li> <li>• Dhe pozicione të tjera që lidhen me sigurinë e informacionit dhe menaxhimin e rrjetit</li> </ul>

➤ **Profili “Inxhinieri Kompjuterike dhe Big Data”**

- Institucionet financiare apo të kerkimit operativ, me aftësinë për të propozuar veprime të bazuara në analizën (në shkallë të madhe) të të dhënave.
- Menaxher informacioni në kompani, përgjegjës për analizat statistikore të informacionit të pranishëm në bazat e të dhënave të mëdha, si dhe zhvillimin e modeleve për të mbështetur proceset vendimmarrëse në kompani.
- Analist i të dhënave në Web. Për kompanitë me një prani të rëndësishme Web, duke marrë përgjegjësi në vlerësimin e informacionit të mbledhur nga Web, për të zbuluar modelet dhe për parashikimin e rezultateve që përmirësojnë praninë e kompanisë në tregjet e saj.
- Marketing, analist i të dhënave, duke punuar në identifikimin e tendencave të të dhënave të shitjes; ndryshimet në modelet e konsumit hapësinor ose të përkohshme, për të ndihmuar në përcaktimin e strategjive të marketingut të shoqërisë.
- Analisti i dhënave operationale, zbulimin e mundësive të përmirësimit mbi proceset në kuadër të kompanisë, përmes reduktimit të kostove dhe kohës të ekzekutimit, si dhe rritjen e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve të tyre.
- Konsulent i jashtëm, me aftësinë për të ofruar zgjidhje të kompanive për trajtimin e informacionit të tyre, si dhe zbatimin e përmirësimeve në bazë të rezultateve të këtij trajtimi.
- Sistemet zhvilluese, për të zbatuar metoda e analizës së të dhënave të paraqitura në kurset me qëllim të ofrimit të rezultateve të thjeshta për të mbështetur proceset vendimmarrëse në kompani.

➤ **Profili “Inxhinieri Kompjuterike dhe Multimedia Dizajn” (“Multimedia-Design” Profile)**

- Konsulentë multimedia, designers.
- Animatorë tek audio dhe video prodhuesit.
- Mund të punojnë për një sërë organizatash duke përfshirë dhe kompanitë në sektorin e IT.
- Departamentet qeveritare dhe organizatave kulturore.



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sistemet kompjuterike.</li> <li>• Industrinë e projektimit.</li> <li>• Industrinë botuese software, dhe industria e reklamave.</li> </ul> <p>GVJ është i mendimit se njohuritë e përftuara në këtë cikël studimi krijojnë shprehi të veçanta për të ushtruar një shumëllojshmëri relativisht të gjerë profesionesh e specialitetesh të lidhura me shkencat kompjuterike.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" është hartuar në mënyrë të tillë që të përgatisë studentë për karrierë sipas kërkesave teknike të industrisë së inxhinierisë kompjuterike, IT, telekomunikacionit të institucioneve financiare si dhe për studime pasuniversitare post-master në Inxhinieri Kompjuterike ose në fusha të ngjashme. Baza e programit është fokusuar në ndërtimin e mendimit kritik me të cilin merren vendime profesionale. [Ev. Nr10. Rregullore e programit mesimor Master ne Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni: Qëllimi]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ është i mendimit se aftësitë dhe kompetencat e avancuara të përftuara në kuadër të këtij programi studimi mundësojnë nga njera anë një ekspertizë të thelluar në drejtimet Inxhinieri Kompjuterike e BIG Data, Rrjetet Kompjuterike e Siguria Kibernetike dhe Multimedia-Dizajn dhe nga ana tjetër krijojnë një bazë të shëndoshë për t'u angazhuar pranë institucioneve kërkimore si dhe eventualisht për të vazhduar studimet në ciklin e tretë Doktoratë. [Ev. Nr10. Rregullore e programit mesimor Master ne Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>GVJ konstatoi se hartimi i programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" është bërë duke u mbështetur në të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në mënyrë të veçantë, është hartuar duke respektuar kërkesat e VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga</p>

	<p>institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe procedura e hartimit dhe miratimit të tyre ka kaluar në gjitha hallkat e përcaktuara në aktet përkatëse ligjore e nënligjore. [Ev. Nr.10. Rregullore e programit mesimor Master ne Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni; Evidenca Nr. 1.7 VSA nr.1 date 11.02.2016 aplikim per licensim e progrmeve te reja]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Nga analiza e programit të studimit [Ev. RVB; Plani Mësimor Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni, Profili Big Data; Profili Network and Cybersecurity; Profili Multimedia Design;], GVJ konstatoi se janë përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët sipas kërkesave të akteve ligjore dhe nënligjore. Duke i ballafaquar dhe përshtatur në përputhje me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” veprimtaritë formuese të programit mund të grupohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>A. LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (12 kredite – 10%)</li> <li>B. LËNDË KARAKTERIZUESE –përgatitje për disiplinën shkencore (66 kredite – 55%)</li> <li>C. LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (12 kredite – 10%)</li> <li>D. LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, praktika profesionale (12 kredite – 10%)</li> <li>E. DETYRIME PËRMBYLLËSE (18 kredite – 15%)</li> </ul> <p>si dhe respektohet kërkesa që përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B të mos jetë më pak se 60%.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>GVJ u informua se realizimi i temës së diplomës përbën një element shumë të rëndësishëm në procesin e formimit për disiplinën përkatëse. Në planin mesimor realizimit të temës së diplomës i janë rezervuar 18 kredite ECTS. Veç kësaj, pjesërisht në mbështetje të realizimit të temës së diplomës, shërbejnë edhe elementë të praktikës mësimore e cila është planifikuar në S2 të vitit të dytë. Për realizimin e Temës së Diplomës studentët bazohen në Manualin e Punimit të Temës së Diplomës dhe në rregulloren “Për Punimin e Diplomës”. GVJ u informua se punimet e diplomave të realizuara në kuadër të programit të</p>

	studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" përmbajnë elementë të kërkimit shkencor pasqyruar edhe në aktivitetet kërkimore të organizuara me studentët [Ev. Nr.13. Manuali i Punimit të Tezes se Diplomes, Ev. Nr. 7. Libri i Rregulloreve Institucionale]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 116, datë 15.12.2017, me kohëzgjatje 5 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 14.12.2022 [Ev. Nr.1.5 Certifikata e Akreditimit Institucional leshuar nga Bordi i Akreditimit 2017].
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" ka 2 njësi kryesore: 1. Fakulteti i Inxhinierisë; 2. Fakulteti i Ekonomisë; Fakulteti i Inxhinierisë ka në përbërjen e tij 3 njësi bazë (dy departamente dhe një qendër për inovacionin, kërkimin dhe zhvillimin): 1. Departamenti i Inxhinierisë Softuerike; 2. Departamenti i Inxhinierisë Industriale; 3. Qendra për Inovacionin, Kërkimin dhe Zhvillimin (CIRD); duke përmbushur në këtë mënyrë detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike [Ev. RVB; Ev. 1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar, Shtojca 2; Ev. 8. Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë, Neni 4].

<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Fakulteti i inxhinierisë për vitin akademik 2021-2022 ka gjithsej <b>27 pedagogë</b>, nga të cilët <b>25 janë pedagogë efektiv (PAE)</b> nga ku: 3 kanë titullin “Profesorë”, 3 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 12 kanë gradën Dr./PhD, dhe 7 Asistent Lektorë me Msc; dhe <b>2 pedagogë me kontratë (PAK)</b> nga ku 1 ka titullin “Profesor”, 1 ka titullin “Profesor i Asociuar”.</p> <p>Ndërsa stafi akademik i Departamentit të Inxhinierisë Softuerike që është përgjegjës për programin e studimit për tre vitet akademike në raportet PAE/PAK është si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="563 636 1383 1079"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/ grada</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2020-2021</th> <th colspan="2">2019-2020</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr.</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>2</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD.</td> <td>5</td> <td>0</td> <td>3</td> <td>1</td> <td>4</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>3</td> <td>0</td> <td>4</td> <td>0</td> <td>2</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td><b>Totali</b></td> <td><b>9</b></td> <td><b>1</b></td> <td><b>7</b></td> <td><b>3</b></td> <td><b>7</b></td> <td><b>3</b></td> </tr> </tbody> </table> <p><i>GVJ konstatoi se megjithëse ka një tendencë për qëndrueshmëri të stafit akademik kjo problematikë duhet trajtuar me kujdes në një vështrim afatgjatë.</i></p>	Tituj/ grada	2021-2022		2020-2021		2019-2020		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	1	0	0	0	1	1	Prof. Asoc.	0	1	0	2	0	0	Dr./PhD.	5	0	3	1	4	2	Msc.	3	0	4	0	2	0	<b>Totali</b>	<b>9</b>	<b>1</b>	<b>7</b>	<b>3</b>	<b>7</b>	<b>3</b>
Tituj/ grada	2021-2022		2020-2021		2019-2020																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																											
Prof.Dr.	1	0	0	0	1	1																																											
Prof. Asoc.	0	1	0	2	0	0																																											
Dr./PhD.	5	0	3	1	4	2																																											
Msc.	3	0	4	0	2	0																																											
<b>Totali</b>	<b>9</b>	<b>1</b>	<b>7</b>	<b>3</b>	<b>7</b>	<b>3</b>																																											
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV, GVJ konstatoi se Fakulteti i Inxhinierisë si njësi kryesore e Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” dhe Departamenti i Inxhinierisë Softuerike si njësi bazë përgjegjëse për programin e Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile “Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn” përmbushin detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike. [Ev. 1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar: <b>Organet dhe Autoritetet Drejtuese, Shtojca 2; Ev. 8. Regullore e Fakultetit te Inxhinierise]</b></p>																																																
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Softuerike ka në përbërjen e tij për vitin akademik 2021-2022 11 punonjës, nga të cilët 9 janë PAE, 1 PAK dhe 1 personel ndihmës akademik. [Ev. RVB – Të</p>																																																

angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.	<b>dhënat për vitin akademik 2021-2022].</b> Nga takimet në institucion GVJ konstatoi se përgjithësisht realizimi i praktikave mësimore, projekteve studimore e kërkimore etj. drejtohet dhe mbështetet nga personeli akademik efektiv sipas tematikave që u korrespondojnë lëndëve përkatëse.			
<b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Nga takimet në institucion GVJ u informua se Departamenti i Inxhinierisë Softuerike që është përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" ka përcaktuar koordinatorin e programit të studimit Prof.Assoc. Abdulsalam Alkhouli [Ev. Nr. 27. <b>Vendimi i Keshillit të Fakultetit të Inxhinierisë nr. 1 date 14.10.2021]</b> dhe koordinorë për çdo program studimi për të cilin është përgjegjëse. Sipas RVB, koordinorët janë përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e vendosura për programin e studimit.			
<b>Kriteri 7.</b> Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike të drejtuesit të njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit	Referuar RVB, koordinorin e programit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" raporton në mënyrë periodike dhe mban lidhje të drejtpërdrejta me përgjegjësin e Departamentit të Inxhinierisë Softuerike. Ai dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit ashtu siç dhe kontribuon në detyra të tjera që kanë të bëjnë me këshillimin e studentëve, ndjekjen e procesit të përzgjedhjes së temave të diplomave, supervizon procese si ai i praktikave mësimore, regjistrimet në programin e studimit etj. [Ev. RVB].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>

<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" paraqitet i detajuar në elementët e tij që përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Planin mësimor</li> <li>- Rregulloren e programit të studimeve</li> <li>- Programet (syllabuset) e lëndëve</li> <li>- Modelin e diplomës.</li> </ul> <p><b>[Ev. Nr.16. Planet mesimore 2021 -2022, 2020 - 2021, 2019-2020; Evidenca Nr. 10. Rregullore e programit mesimor Master ne Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni; Evidenca Nr. 19. Master in CE_IT...; Evidenca Nr. 17. Shkrese QSHA Urdher 146, dt 31.08.2020 Regjistrim i Formave te Diplomave MSc Inxh Kompj].</b></p> <p>Ky informacion i shoqëruar me kuotat dhe kriteret e përvitshme të pranimit përbëjnë informacionin bazë të programit të studimit, i cili disponohet nga Departamenti i Inxhinierisë Softuerike dhe që vihet në dispozicion të studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga analiza e programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" rezulton se ai është i organizuar në lëndë e aktivitete formuese në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi, ku Lëndët bazë përbëjnë 10%, Lëndët karakterizuese 55%, Lëndët ndërdisiplinore /integruese 10%, Lëndët plotësuese 10% dhe Detyrimet përmbyllëse 15% të totalit të studimit [Ev. <b>RVB; Plani Mësimor Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni, Profili Big Data; Profili Network and Cybersecurity; Profili Multiemdia Design;</b>],</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" është i organizuar sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Forma e studimit për këtë</p>

	<p>program është me kohë të plotë dhe realizohet për 2 vite akademike me nga 2 semestra mësimdhënie secili. Përfundimit të këtij programi studimesh i korrespondon grumbullimi i 120 krediteve ECTS, duke realizuar çdo vit 60 kredite (30 kredite për semestër). [Ev. Nr. 10. Rregullore e programit mesimor Master ne Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni;]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Plani mësimor si elementi bazë i programit të studimit përmban [Ev. Nr.16. Planet mesimore 2021 -2022, 2020 - 2021, 2019-2020]:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndarjen e lëndëve sipas aktiviteteve formuese.</li> <li>- Ndarjen e lëndëve sipas viteve dhe semestrave.</li> <li>- Dhënien për secilën lëndë të ngarkesës në kredite dhe numrit të orëve në auditor.</li> <li>- Ndarjen e ngarkesës në auditor për secilën lëndë në elementët përbërës si leksione, seminare, laboratorë projekte etj.</li> </ul> <p>Në rregulloren e programit të studimit përcaktohen edhe elementë që lidhen me shkallën e detyrueshme të frekuentimit, mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, përmirësimin e notave, mënyrën e diplomimit etj. [Ev. Nr. 10. Rregullore e programit mesimor Master ne Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni;].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të krediteve jepen në Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" dhe në Rregulloren e Fakultetit të Inxhinierisë. Këto informacione mund të aksesohen edhe nëpërmjet faqes WEB të institucionit [Ev. Nr. 10. Rregullore e programit mesimor Master ne Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni; Ev. nr. 8. Rregullore e Fakultetit te Inxhinierise; <a href="https://cit.edu.al/admissions-3/">https://cit.edu.al/admissions-3/</a> ]</p> <p>GVJ është i mendimit se praktikat e prezantuara për transferim studimesh dëshmojnë për procedura të qarta dhe transparente</p>

	të zbatuara nga institucioni [ <b>Evidenca. Vizita në Sekretarinë Mësimore</b> ].			
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Elementë më të detajuar për lektorin apo lektorët që do të zhvillojnë lëndën, semestrin kur zhvillohet, njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti, elementët e mësimdhënies, detyrimet për frekuentimin, literaturën, mënyrën e shlyerjes së lëndës dhe peshën e elementëve të ndryshëm në vlerësimin final jepen në syllabuset e lëndëve [ <b>Ev. Nr. 19. Master in CE_IT...;</b> ]. GVJ është i mendimit se syllabuset e lëndëve përmbajnë gjithë elementët e nevojshëm përcaktuar në VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht	Nga studimi i DVV dhe takimet në institucion dhe GVJ konstatoi se që nga akreditimi i mëparshëm nuk ka patur ndryshime në planin mësimor të programit të studimit. Ndryshimet dhe përmirësimet kanë konsistuar kryesisht në rishikimin e syllabuseve të lëndëve ku janë pasqyruar elementë që lidhen me zhvillimet dinamike në fushën e inxhinierisë kompjuterike dhe teknologjisë së informacionit dhe specifikisht në drejtimit Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn. [ <b>Ev. Nr.16. Planet mesimore 2021 -2022, 2020 - 2021, 2019-2020; Ev. Nr. 19. Master in CE_IT...;</b> ]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>



<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstatoi se ngarkesa mësimore është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Ngarkesa është përcaktuar në bazë të sistemit të krediteve ECTS, duke parashikuar 30 kredite në semestër. Nga totali prej 3000 orësh mësimore për të dy vitet e studimit, 1220 prej tyre (rreth 41%) janë parashikuar në auditor. Në këtë mënyrë, duke ju referuar të dy viteve akademike, rezulton që ngarkesa javore në auditor është 20 orë (me përjashtim të semestrit të fundit që i korrespondon praktikës mësimore dhe diplomimit, ku kjo ngarkesë është parashikuar 20 orë në javë vetëm për praktikën mësimore) [<b>Ev. Nr.16. Planet mesimore 2021 - 2022, 2020 - 2021, 2019-2020;</b>]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga takimi me studentët e programit të studimit GVJ u informua se pjesa dërmuese e tyre janë të punësuar. Po ashtu, nga studimi i të dhënave të transmetuara nëpërmjet DVV, konstatohet se për periudhën 2019-2021 nga 27 të diplomuar të punësuar, për të cilët disponohet informacion (62 të diplomuar në total), 16 prej tyre janë punësuar në përputhje me diplomën, duke dëshmuar në këtë mënyrë se kompetencat e fituara përshtaten me kërkesat e tregut të punës [<b>Ev. RVB; Takime me studentët e programit;</b>]. Në lidhje me profilin Multimedia Dizajn, në 5 vitet e fundit janë diplomuar vetëm 2 studentë (dhe asnjë prej tyre nuk është punësuar në përputhje me diplomën). Nga shqyrtimi i DVV dhe takimet në institucion, GVJ është i mendimit se përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve dhe praktikës profesionale mundësojnë, njohuri, aftësi dhe kompetenca të cilat garantojnë formimin e nevojshëm për punësim të studentëve në profilet Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike.</p> <p><i>Për profilin Multimedia Dizajn nga ana e Departamentit të Inxhinierisë Softuerike nevojitet një analizë e detajuar e shkaqeve si dhe dhënia e zgjidhjeve të përshtatshme për të garantuar vazhdimësinë e këtij profili.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të</p>	<p>Nga vlerësimi i planit mësimor [<b>Ev. Nr.16. Planet mesimore 2021 -2022, 2020 - 2021, 2019-2020;</b>] GVJ konstatoi se shpërndarja e lëndëve të programit të studimit në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe aftësimin profesional</p>

<p>pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>në fushën e Inxhinierisë Kompjuterike dhe Teknologjisë së Informacionit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ është i mendimit se në përgjithësi struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit master i shkencave dhe e përafërt me programe të ngjashme jashtë vendit. Kjo dëshmohet edhe nga mobilitet e kryera nga studentët në universitete të huaja.</p> <p><b>[Ev. Nr.16. Planet mesimore 2021 -2022, 2020 - 2021, 2019-2020; Ev. RVB]</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>GVJ është i mendimit se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, punësim dhe mobilitet. Personeli akademik si dhe studentë të cilët kanë përfituar mobilitete në institucione analoge jashtë vendit në programe të ngjashme kanë konstatuar një përputhje të mirë të këtij programi studimi me programe analoge. <b>[Ev. Nr.16. Planet mesimore 2021 -2022, 2020 - 2021, 2019-2020; Ev. RVB]</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve të këtij programi studimi GVJ konstatoi se ato janë të përditësuara me literaturë bashkëkohore. <b>[Ev. Nr. 19. Master in CE_IT...;]</b> Në rastin e programit të studimit në fushën e Inxhinierisë Kompjuterike dhe Teknologjisë së Informacionit, kjo vjen edhe si domosdoshmëri për arsye të zhvillimeve të shpejta në këtë fushë. Literatura elektronike sigurohet nga bashkëpunimi me McGrawHill Education [<a href="https://www.mheducation.com/">https://www.mheducation.com/</a>]</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn", i vlerësuar në përmbajtje nga GVJ, garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për një program studimi të ciklit të dytë. <b>[Ev. Nr.16. Planet mesimore 2021 -2022, 2020 - 2021, 2019-2020; Ev. Nr. 19. Master in CE_IT...;]</b> Nga takimet me studentët rezultojnë se realizimi faktik i programit të studimit është brenda pritshmërive të tyre <b>[Takime me studentët e programit].</b></p>

<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Referuar DVV dhe takimeve në institucion, GVJ është i mendimit se përmbajtja e programit të studimit në profilet Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike garanton si punësimin direkt mbas diplomimit ashtu edhe eventualisht vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë. Një pjesë e mirë e studentëve të diplomuar në këtë program studimi punësohen si brenda apo edhe jashtë vendit, ndërsa ka dhe prej tyre që janë punësuar në institucion, duke përbërë bazën për qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e mëtejshëm të programit. <b>[Ev. RVB; Takime në institucion].</b></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni në përgjithësi si dhe Fakulteti i Inxhinierisë dhe Departamenti i Inxhinierisë Softuerike në veçanti, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë të ndryshëm nga tregu i punës <b>[Ev. Nr. 25. Marrëveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione të tjera 2016 - 2022]</b> si dhe nëpërmjet projekteve që lidhen me punësimin apo aktivitete të organizuara në lidhje me studentët dhe tregun e punës, <b>[Ev. Nr. 57. Evidenca të organizimit të tryezave të rrumbullakta me kompanite, bizneset]</b> kanë synuar nga njera anë përshtatjen sa më të mirë të programit të studimit me kërkesat e tregut e punës dhe nga ana tjetër ofrimin dhe njohjen e studentëve me këtë treg. Programet e studimit të Departamentit të Inxhinierisë Softuerike janë vlerësuar në mënyrë periodike për të parë ecurinë e tyre si dhe përputhjen me nevojat e tregut <b>[Ev. Nr. 4. Vlerësimi i Programit të Studimit, Tregu i Punës dhe të dhëna për studentet pas diplomimit 2019-2021]</b>. Vlerësimi i programeve të studimit të ofruara nga Fakulteti i Inxhinierisë është kryer nga Komiteti i Kurrikulave duke analizuar përputhshmërinë me objektivat dhe strategjinë e zhvillimit, treguesit e matshëm, zhvillimin e programeve të studimit dhe vlerësimin, analizuar të dhëna për studentët pas diplomimit, të dhëna për zhvillimin e teknologjisë në vend lidhur me programet e studimit si dhe duke formuluar gjetje dhe rekomandime</p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të</p>	<p>Realizimi praktik i programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" ka elementë të kërkimit shkencor që pasqyrohen si gjatë</p>



aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	projekteve të ndryshëm, por kryesisht në realizimin e punimit të diplomës. [Ev. Nr. 16. Planet mesimore 2021 -2022, 2020 - 2021, 2019-2020; Ev. Nr. 13. Manuali i Punimit të Tezes se Diplomes.]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk është	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve


**Kriteri 1.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.

Sipas përcaktimeve ligjore, personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës, kriter i cili plotësohet nga stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi [Ev. RVB, Tabela 7 - Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit].

Tituj/grada	2021 - 2022		2020- 2021		2019 - 2020	
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr	0	1	1	0	1	0
Prof.As.Dr	2	1	1	4	2	3
Dr/PhD	8	1	5	1	4	2
Msc (Dr në proces)	0	0	0	0	0	0
Msc	0	0	0	0	0	0
Në total	10	3	7	5	7	5

Referuar tabelës përmbledhëse, GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është personel akademik kryesisht me kohë të plotë dhe përmbush kërkesat ligjore në fuqi përsa i përket kualifikimit.

	<p>Sipas tabelave 4 dhe 12 në RVB, ngarkesa mësimore e realizuar nga personeli akademik paraqitet si vijon.</p> <table border="1" data-bbox="600 264 1386 510"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Viti akademik</th> <th colspan="2">Ngarkesa mësimore sipas kategorisë së personelit akademik</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2019 - 2020</td> <td>45%</td> <td>55%</td> </tr> <tr> <td>2020 - 2021</td> <td>60.2%</td> <td>39.8%</td> </tr> <tr> <td>2021 - 2022</td> <td>88%</td> <td>12%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Vihet re se ka një përmirësim të dukshëm të raportit të orëve të zhvilluara nga PAE, duke arritur që në vitin akademik 2021-2022 rreth 88% e ngarkesës së mbulohet nga personel akademik efektiv.</p>	Viti akademik	Ngarkesa mësimore sipas kategorisë së personelit akademik		PAE	PAK	2019 - 2020	45%	55%	2020 - 2021	60.2%	39.8%	2021 - 2022	88%	12%
Viti akademik	Ngarkesa mësimore sipas kategorisë së personelit akademik														
	PAE	PAK													
2019 - 2020	45%	55%													
2020 - 2021	60.2%	39.8%													
2021 - 2022	88%	12%													
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Nga analiza e të dhënave të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, GVJ konstatoi se ky personel ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit dhe realizimin e procesit mësimor <b>[Ev. Nr. 20. CV e stafit akademik te programit te studimit]</b></p> <p>Disa nga fushat ku janë të specializuar stafi akademiçjanë: machine learning, rrjeta kompjuterike, siguri kibernetike, sisteme inteligjente, web programming and design, data analysis etj</p>														
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi CV të stafit akademik, GVJ konstatoi se fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. <b>[Ev. Nr. 20.CV e stafit akademik te programit te studimit]</b></p>														
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin</p>	<p>Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” ka nënshkruar një numër marrëveshjesh bashkëpunimi me përfaqësues biznesi e kompani. Këto marrëveshje kanë shërbyer kryesisht për realizimin e praktikave profesionale si dhe për elementë të projekteve në kuadër të procesit mësimor <b>[Ev. Nr. 25. Marrëveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione te tjera 2016 - 2022]</b> Referuar RVB, Për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera</p>														



e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	specifike sipas natyrës së programit të studimit Fakulteti i Inxhinierisë ka vënë në dispozicion staf të kualifikuar, me grada dhe tituj [Ev. RVB].			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit	Nga analiza e informacionit të transmetuar për personelin e Fakultetit të Inxhinierisë rezulton se që nga viti akademik 2020 - 2021 Departamenti ka angazhuar një personel ndihmës akademik [Ev. RVB. RVB – Tabela 2]. Nga diskutimet në institucion, GVJ u informua se për të ndihmuar në procesin e realizimit të orëve laboratorike e sidomos për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore angazhohen edhe personeli akademik i kategorisë Asistent Lektor.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi II.6

**Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përpuhje me objektivat e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	GVJ konstatoi se Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” në përgjithësi si dhe Fakulteti i Inxhinierisë dhe Departamenti i Inxhinierisë Softuerike në veçanti, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë të ndryshëm nga tregu i punës [Ev. Nr. 25. <b>Marreveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione të tjera 2016 - 2022</b> ] si dhe nëpërmjet projekteve që lidhen me punësimin apo aktivitete të organizuara në lidhje me studentët dhe tregun e punës, [Ev. Nr. 57. <b>Evidenca të organizimit të tryezave të rrumbullakta me kompanite, bizneset</b> ] kanë synuar përshtatjen sa më të mirë të programit të studimit me kërkesat e tregut e punës. Programet e studimit të Departamentit të Inxhinierisë Softuerike janë vlerësuar në mënyrë periodike për të parë ecurinë e tyre si dhe përputhjen me nevojat e tregut [Ev. Nr. 4. <b>Vlerësimi i Programit të Studimit, Tregu i Punës dhe të dhëna për studentet pas diplomimit 2019-2021</b> ].


<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Studentët përfshihen në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit. Kjo realizohet nëpërmjet marrjes së mendimit të tyre që realizohet nëpërmjet anketimeve të kryera. Një nga pyetësorët e studentëve i kushtohet vlerësimit të programit të studimit dhe personelit akademik [Ev. Nr. 28. <b>Model Pyetësori Master CE (Computer Engineering &amp; IT)</b>]. Kjo shërben si bazë për propozime eventuale për ndryshime në planin mësimor deri në 20%.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” ka hartuar strategjinë e angazhimit të Alumnit [Ev. Nr. 76. <b>Strategjia e Angazhimit të ALUMNI</b>] dhe mban kontakte me ta [Ev. Nr. 58. <b>Gjurmimi i studenteve të institucionit prej NJSBC</b>]. Në tryezat e rrumbullakta të organizuara nga IKT marrin pjesë dhe Alumni. [Ev. Nr. 57. <b>Evidenca të organizimit të tryezave të rrumbullakta me kompanite, bizneset</b>]</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi</p>	<p>Referuar RVB, në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” me kompani, sipërmarrje, banka dhe industri janë zhvilluar një sërë aktivitete që kanë pasur për qëllim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sjelljen sa më pranë studentëve të eksperiencave më të mira në treg.</li> <li>- Informimin e studentëve për procese të ndryshme që lidhen me fushën e tyre të studimit - Sjelljen e modeleve të suksesshme.</li> <li>- Aftësimin e studentëve me praktikën dhe metodat më të fundit.</li> </ul> <p>[Ev. RVB; Ev. Nr. 67. <b>Katalogu i Veprimtarive 2019-2020; Ev. Nr. 68. Katalogu i Veprimtarive 2020-2022;</b>]</p> <p>KU IKT ka organizuar mjaft aktivitete me kompanitë dhe bizneset, megjithatë ato nuk janë shoqëruar edhe me përshtatjen apo riorganizimin e programeve të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi [Ev. Nr. 57. <b>Evidenca të organizimit të tryezave të rrumbullakta me kompanite, bizneset</b>]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>

				X
--	--	--	--	---

<b>Standardi II.7</b>	
<b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Në strategjinë e zhvillimit të institucionit, të "Misioni, Vizioni dhe Objektivat institucionale" ndërmjet të tjerash, të angazhimet përcaktohet [Ev. Nr. 2. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017]:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ofrimi i programeve të studimit në fushën e teknologjisë së informacionit dhe ekonomisë.</li> <li>- Trajnimi i studiuesve të rinj në fushat e vlerësimit teorik të teknologjisë së informacionit dhe ekonomisë.</li> <li>- Zgjerimi i kualifikimeve profesionale dhe shkencore të të diplomuarve të saj në fushën e teknologjisë së informacionit dhe ekonomisë.</li> <li>- Kryerja e aktiviteteve kërkimore-shkencore për zhvillimin e mëtejshëm të aplikacioneve dhe inovacioneve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe ekonomisë.</li> </ul> <p>GVJ është i mendimit se këta elementë gjejnë pasqyrimin më të mirë në programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn".</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Nga takimet në institucion dhe shqyrtimi i DVV, GVJ u informua se Departamenti i Inxhinierisë Softuerike që është përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" koordinon gjithë veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore të personelit akademik dhe në bashkëpunim edhe me departamente të tjerë të institucionit bashkërendon organizimin e konferencave, publikimin e artikujve në revistën e institucionit si dhe revista të tjera, organizime të eventeve shkencore, takime me të ftuar nga fusha e industrisë dhe sipërmarrjes, duke respektuar liritë akademike dhe forcuar marrëdhënien me institucionet partnere. Dëshmi për këtë janë</p>



	<p>aktivitetet dhe botimet e shumta të Fakultetit të Inxhinierisë në cilat ka kontribuar ose ka drejtuar Departamenti i Inxhinierisë Softuerike [Ev. RVB; Ev. Nr. 67. Katalogu i Veprimtarive 2019-2020; Ev. Nr. 68. Katalogu i Veprimtarive 2020-2022; ].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Nxitja dhe motivimi i studentëve të programit i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data; Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Multimedia-Dizajn" për t'u angazhuar në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore gjen realizimin në punimet e diplomave të cilat kontribuojnë për inicimin e studentëve në kërkimin shkencor duke u bërë pjesë e punës kërkimore të personelit akademik. Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" ka organizuar konferenca studentore si Konferenca e III-të Studentore "Inovacion në Inxhinieri, Shkencë dhe Teknologji, në bashkëpunim me Albanian University në datë 07.05.2021. Po ashtu në revistën shkencore të Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" CIT Review, janë të publikuara edhe një sërë studimesh shkencore të punuara në bashkëpunim mes stafit akademik dhe studentëve. Një ndër projektet e realizuara në bashkëpunim mes studentëve të inxhinierisë softuerike dhe atyre të ekonomisë është edhe punimi i Kalkulatorit të Pagave [<a href="https://cit.edu.al/the-highlights-of-the-payroll-ceremony/">https://cit.edu.al/the-highlights-of-the-payroll-ceremony/</a>].</p> <p>GVJ është i mendimit se rezultatet kërkimore të botuara dëshmojnë për një angazhim të konsiderueshëm të studentëve me mbështetjen e pedagogëve [Ev. RVB: <b>Aneks 2 Të Dhëna Mbështetëse Sasiore Dhe Cilësore Për Rvb 2019-2022</b>].</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Referuar RVB, programi i studimit bazohet në Strategjinë e Zhvillimit të Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë", si dhe në Planin Strategjik, të cilat janë në përputhje me politikat dhe eksperiencat më të mira ndërkombëtare për edukimin cilësor, zhvillimin e aftësive dhe kompetencave tek studentët si dhe mbështetjen e tyre në të mësuarit dhe punuarit mbi vlera etike për të zhvilluar kërkimi shkencor, aplikativ dhe inovativ [Ev. RVB; Ev. Nr. 2. <b>Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024, miratuar me VSA nr.11, 08.05.2017</b>].</p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>	<p>GVJ u informua për format e mbështetjes financiare për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore nga ana e personelit akademik dhe studentëve të programit të studimit. Kjo mbështetje financiare (direkte apo indirekte) konsiston në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Publikimet falas në revistën Shkencore CIT Review.</li> <li>- Pjesëmarrjen falas në konferencat e organizuara prej institucionit ose në bashkëpunim me insitucione të tjera.</li> <li>- Sponsorizimin e artikujve shkencor të publikuar në revista me faktorë impakti.</li> <li>- Reduktimin e ngarkesës mësimore për personelin akademik të angazhuar në projekte.</li> <li>- Mbështetje për pajisje laboratorike.</li> </ul> <p>[Ev. Nr. 7. Libri i Rregulloreve Institucionale; Takime në institucion; Ev. RVB;]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b></p>	<p><b>Asnjë përmbushje</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi II.8</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Bazuar në librin e rregulloreve të institucionit, grupet e punes si dhe grup-lendet analizohen dhe miratohen nga Këshilli i Fakultetit. Në këtë libër është shprehur mbështetja për projektet shkencore, gjithashtu. Kërkimi shkencor organizohet pranë njësive kërkimore të fakulteteve të njohura ndryshe si Njësitë CIRD (Ekonomi dhe Inxhinieri). Kërkimi shkencor ndërtohet në zbatim të filozofisë, misionit dhe vizionit si dhe të Strategjisë së Kërkimit Shkencor në CIT, në përputhje me interesat e institucionit, të personelit akademik dhe studentëve, si dhe në përputhje me kapacitetet njerëzore dhe financiare në zotërim. Në fokus është kërkimi shkencor që përfundon me një produkt me vlerë për shoqërinë, i shërben rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe siguron zbatueshmëri shkencore.</p>

	<p>Departamentet në bashkëpunim sigurojnë zhvillimin e kërkimit shkencor sipas drejtimeve të miratuara, dhe realizimin e produkteve të kërkimit në cilësinë e kohës dhe duhur. [Ev. Nr. 7. <b>Libri i Rregulloreve Institucionale;</b>]</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Nga takimet në institucion dhe shqyrtimi i DVV, GVJ u informua se Departamenti i Inxhinierisë Softuerike, është i angazhuar në studime e projekte me karakter kërkimor shkencor duke përcaktuar objektiva të qartë kërkimore dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. Lista e projekteve në të cilat është i angazhuar institucioni ku marrin pjesë jo vetëm personeli akademik me statusin e punonjësit kërkimor, por edhe studentët e ciklit Master, dëshmon për një institucion dhe në veçanti për një program studimi me lidhje të ngushta me kërkimin shkencor. Këto lidhje kontribuojnë në zhvillimin e aftësive të kërkuesit dhe të përshtatjes me teknologjitë e reja [Ev. Nr. 26. <b>Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS; Takime në institucion; Ev. RVB: Aneks 2].</b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p>	<p>Objektivat kërkimorë të Departamenti i Inxhinierisë Softuerike, realizohen nëpërmjet një numri të konsiderueshëm konferencash e aktiviteteve të tjera në të cilat angazhohen në një masë të konsiderueshme dhe studentët. Këto aktivitete i shërbejnë edhe kualifikimit të personelit akademik të kategorisë Asistent Lektor (MSc) për të mundësuar avancimin e tyre në karrierë [Ev. Nr. 26. <b>Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS; Takime në institucion; Ev. RVB: Aneks 2].</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p><b>Plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>GVJ u informua se zhvillimi dhe përdorimi i metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” bazohet në rregullore të posaçme të hartuara për këtë qëllim. Këto janë pjesë e Rregulloreve Institucionale, ku rregullorja “Mbi Hartimin e Programit të Lëndës” përcakton që Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, ndërmjet të tjerash, përcakton përdorimin e metodave pedagogjike si: Metodatat e mësimdhënies të mbështetura kryesisht te fjala e shkruar, shpjegimi ose te simbolika matematikore, pa mohuar edhe kode të tjera komunikimi, si prezantimet me projektor, power-point etj.</p> <p>Nga takimet në institucion, GVJ u informua se personeli akademik ka në fokusin e tij përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Në mënyrë të veçantë në këtë drejtim kanë kontribuar mobilitetet e personelit akademik si dhe shkollat verore të organizuara nga universitete jashtë vendit. <b>[Ev. Nr. 7. Libri i Rregulloreve Institucionale; Takime në Institucion]</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Në nivel institucional përgjegjëse për vlerësimin në mënyrë periodike aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik është NJSBC. Procedurat e vlerësimit të cilësisë bazohen në "Manualin e Sigurimit të Cilësisë". Vlerësimi i performancës së personelit akademik bën pjesë dhe te detyrat e Përgjegjësit të Departamentit. Për të mundësuar kryqëzimin e të dhënave, krahas vlerësimit nga ana e Përgjegjësit të Departamentit, realizohet edhe një proces vet-vlerësimi nga ana e personelit akademik. <b>[Ev. Nr. 11. Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook; 30. Model Vetvlerësimi i stafit akademik 2020 – 2021; 9. Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Softuerike ]</b>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave</p>	<p>GVJ konstatoi se garantimi i përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve mundësohet nëpërmjet pyetsorit të</p>


<p>e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së lëndëve të programit të studimit, i cili plotësohet në fund të çdo semestri. Ky pyetsor plotësohet online dhe është anonim. Gjithë procesi drejtohet dhe monitorohet nga NJSBC. [Ev. Nr. 28. Model Pyetësi Master CE (Computer Engineering &amp; IT)].</p> <p>Përsa i përket trajtimit të kërkesave të studentëve për çështje akademike, kjo e drejtë sanksionohet në Rregulloren e Departamentit të Inxhinierise Softuerike [Ev. Nr. 9. Rregullore e Departamentit të Inxhinierise Softuerike].</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Pyetësorët përpunohen nga NJSBC dhe rezultatet e tyre u vihen në dispozicion instancave drejtuese (Përgjegjës Departamenti, Dekan, etj). GVJ u informua mbi publikimin në mënyrë periodike nga ana e NJSBC të raporteve të analizës së pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke i vënë kështu në dispozicion si të personelit akademik ashtu edhe të studentëve apo dhe gjithë instancave të tjera të interesuara.</p> <p>[<a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf</a> ; <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Permbledhje-e-pyetsorit-2020-2021.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Permbledhje-e-pyetsorit-2020-2021.pdf</a> ]</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>GVJ konstatoi se një rol të madh në promovimin e shembujve të praktikave të mira, nxitjen dhe inkurajimin e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies luan NJSBC e cila njofton zyrtarisht drejtuesit e institucionit për rezultatet përfundimtare. Njësitë kryesore mund të promovojnë jo vetëm stafin e tyre por edhe praktikën e mira dhe shembujt që nxisin tek studentet dhe stafi përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. GVJ u informua se bazuar mbi vlerësimet, kontributin si dhe ecurinë e proceseve akademike dhe administrative, institucioni ka vlerësuar për kontribute personalitete të ndryshme të stafit akademik dhe studentët për arritjet e tyre si në procesin mësimor ashtu dhe për arritje në aktivitete kurrikulare dhe ekstrakurrikulare të lidhura me kompeticione, projekte etj. [Ev. Nr. 51. Certifikata te dhena nga IKT; <a href="https://cit.edu.al/blog/">https://cit.edu.al/blog/</a> <a href="https://cit.edu.al/a-thank-you-to-prof-llukan-puka/">https://cit.edu.al/a-thank-you-to-prof-llukan-puka/</a> ; ]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

**Standardi III.2**

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Baza e realizimit të procesit mësimor në auditor është ora mësimore. Një orë mësimore e ka kohëzgjatjen 60 minuta. Ndër format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve janë leksionet, ushtrimet, seminarët, laboratorët, detyrat e kursit dhe praktika mësimore. GVJ konstatoi se format klasike të mësimdhënies ndërthuren me metoda të ndryshme bashkëkohore. Nga diskutimi me personelin akademik dhe studentët e programit, GVJ u informua për mënyrën e zhvillimit të lëndëve të ndryshme dhe në mënyrë të veçantë për peshën e elementëve formues të parashikuar në secilën lëndë. U konstatua se personeli akademik i kushton një rëndësi të veçantë realizimit të detyrave apo projekteve të kursit. Gjithashtu aplikohen forma të punës në grup për realizimin e një detyre apo projekti, duke zhvilluar në këtë mënyrë edhe elementë të tillë si menaxhimi i ndarjes së punës, integrimi pjesëve individuale në një të tërë, referimi i materialit përfundimtar nga grupi etj. [Ev. Nr. 7. <b>Libri i Rregulloreve Institucionale</b>; Ev. Nr. 27. <b>Vendimi i Keshillit të Fakultetit të Inxhinierise nr. 1 date 14.10.2021; Takime në institucion</b>].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Për t'ju përgjigjur diversitetit dhe kërkesave të studentëve, personeli akademik mban kontakt të vazhdueshëm me ta nëpërmjet Këshilluesit akademik (një për çdo vit studimesh) si dhe në çdo lëndë mundësohet komunikimi me studentët jo vetëm gjatë realizimit të procesit mësimor në auditor, por edhe jashtë auditorit nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike (e-mail, etj). Në këtë mënyrë, GVJ konstatoi se personeli akademik ka qenë në vazhdimësi i disponueshëm për zhvillimin e konsultimeve për çështje specifike si dhe për t'ju përgjigjur pyetjeve e shqetësimeve individuale të studentëve në lidhje me procesin mësimor. [Ev. 7. <b>Libri i Rregulloreve Institucionale, Kreu III; Takime në institucion</b>].</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>GVJ konstatoi se për të mundësuar përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve, institucioni ka vepruar në disa drejtime:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Së pari, në përmirësimin e infrastrukturës së mësimdhënies, duke ofruar auditorë të pajisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies.</li> <li>- Së dyti, nëpërmjet modernizimit të bazës laboratorike dhe mbajtjes së saj në gatishmëri për zhvillimin e aspekteve praktike të procesit mësimor.</li> <li>- Së treti, nëpërmjet krijimit të oportuniteteve për stafin akademik nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit për të përsosur metodat e mësimdhënies.</li> <li>- Së katërti, duke organizuar trajnime për aspekte të ndryshme që lidhen me inxhinierinë e softuerit. Për këtë është shfrytëzuar edhe qendra e certifikuar CISCO për të ofruar trajnime.</li> </ul> <p><b>[Ev. Nr. 23. Marreveshjet ne kuader te Erasmus+ 2016-2022; Ev. Nr. 7. Libri i Rregulloreve Institucionale; Ev. Nr. 49. Certifikatat e trajnimeve te stafit nga IKT; Ev. Nr. 72. Anetaresimi i IKT ne Cisco Academy; Takime në institucion]</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga shqyrtimi CV të stafit akademik, GVJ konstatoi se fushat e kualifikimit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi përputhen me modulet/lëndët që mbulojnë <b>[Ev. Nr. 20.CV e stafit akademik te programit te studimit];</b>. Gjithashtu nga takimi i zhvilluar me studentët dhe nga rezultatet e pyetësorit të studentëve, rezulton se personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit <b>[Takime në institucion]</b>.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë</p>	<p>GVJ konstatoi se metodat e mësimdhënies janë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve si nga vetë personeli akademik për lëndët që mbulojnë ashtu edhe nga studentët (pyetësorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së lëndëve të programit të studimit) si dhe nga drejtuesi i DIS. Në mënyrë të veçantë përpunimi i të dhënave të pyetësorit të vlerësimit të cilësisë së</p>



<p>proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>mësimdhënies së lëndëve për çdo program studimi i cili plotësohet në fund të çdo semestri shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme [Ev. Nr. 28. Model Pyetesori Master CE (Computer Engineering &amp; IT); Takime në institucion]</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Metodat e mësimdhënies për secilën lëndë janë të paraqitura në programet lëndore. Bazuar në to dhe në takimet me studentët dhe personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi GVJ konstatoi se personeli akademik përdor metoda të ndryshme (që varen edhe nga specifika e lëndëve) për të rritur interesimin për orën e mësimi dhe për të rritur shkallën e përvehtësimit të informacionit të transmetuar. Shpjegimi i leksionit shoqërohet me prezantime powerpoint si dhe me materiale të tjera ilustruese, ndërsa pjesët praktike shoqërohen me teknika inteligjente të pyetjeve, sesione interaktive të kombinuara me supervizim, metoda të ndryshme ndërvepruese, teknika Virtuale Mësimore, punë në grup e bazuar në raste studimore, detyra të bazuara në kërkim dhe hulumtim etj. [Dok DVV Evidencat Nr. 19. Master in CE_IT ...; Takime në institucion;]</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Bazuar në programet lëndore dhe takimet me studentët dhe personelin akademik të programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni", GVJ konstatoi se ka një përpjekje të vazhdueshme për angazhimin e studentëve në punë praktike të cilat inkurajojnë sensin e autonomisë dhe synojnë zgjidhjen e problemeve të caktuar. Ky element konkretizohet nëpërmjet detyrave e projekteve të kursit si dhe punëve laboratorike. Në rastin e detyrave e projekteve të kursit, të cilat në mjaft raste organizohen në grup, nuk mungon edhe ndjekja e vazhdueshme nga ana e pedagogut përkatës dhe asistimi prej tij për tejkalimin e problematikave. [Dok DVV Evidencat Nr. 19. Master in CE_IT ...; Takime në institucion;]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi III.3**





**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita e realizuar në institucion, GVJ konstatoi se procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. Fakulteti i Inxhinierisë e zhvillon aktivitetin e tij në ambiente me sipërfaqe totale prej rreth 2100m<sup>2</sup>, ndërsa në shërbim të programit të studimit (por edhe të programeve të tjera) janë rreth 945m<sup>2</sup> [Dok DVV Evidenca. Nr. 33. Raporti i Grupit të Punës për Verifikimin e Standardeve dhe Normativave të Infrastruktura nga MASR 28.07.2020; 34. Akti kundër Zjarrit Nr. Prot. C-10325.1, 24.05.2021; 35. Akti Higjieno Sanitar 171, date 24.05.2021; RVB: Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Tabela 16); Vizita në Institucion;]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se ambientet në të cilat zhvillohet procesi mësimor janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një zhvillim cilësor të këtij procesi, që përfshin: ngrohje-ftohjen, ndriçimin, tabelat, projektorë dhe çdo gjë tjetër të domosdoshme për këtë qëllim. Një kontribut i rëndësishëm ofrohet nëpërmjet bazës laboratorike, e cila, në drejtim të pajisjeve kompjuterike të nevojshme për zhvillimin e seancave laboratorike, është e viteve të fundit dhe e pajisur me softet e nevojshme. [Vizita në Institucion; RVB].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Për nga vetë profili i programit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni", në masën më të madhe elementët formues të tij funksionojnë mbi bazën e një infrastrukture informatike solide dhe që ndjek ndryshimet e shpejta në këtë fushë. GVJ konstatoi se infrastruktura IT mbështet plotësisht realizimin e procesit mësimor. Disa nga këto sistemet janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• McGrawHill Education</li> <li>• E-learning</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Google Meet/Classes</li> <li>• Check in/out system</li> <li>• CIT Go Digital</li> <li>• Koha</li> <li>• O'Reilly Platform (online reading and learning library)</li> <li>• UMS (University Management System) një sistem menaxhimi i realizuar nga stafi akademik dhe studentët kontribon në menaxhimin e të dhënave lidhur me procesin mësimor</li> </ul> <p><b>[Ev. RVB: Të dhëna të plota për platformat online/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Tabela 17); Takime në institucion; <a href="https://ums.cit.edu.al/">https://ums.cit.edu.al/</a>].</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Nga takimet e zhvilluara me personelin akademik dhe studentët, GVJ u informua se gjithë literatura në mbështetje të procesit mësimor ofrohet në gjuhën angleze. Kjo mbështetet nga një marrëveshje me McGrawHill Education dhe O'Reilly duke mundësuar që pjesërisht të disponohen librat në format letër dhe në një masë të madhe në format elektronik në sajë të bibliotekës virtuale. Për vetë zhvillimet e shpejta të shkencave kompjuterike, biblioteka virtuale mundëson aksesin në tekste që u korrespondojnë viteve të fundit. <b>[Vizita në bibliotekë; Ev. Nr. 65. Marreveshje CIT - McGrawHill]</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka e institucionit ka një kapacitet prej 20 vendesh dhe sipërfaqe prej 90 m<sup>2</sup>. Përveç titujve në bibliotekë, rreth 3000 tituj, KU IKT, në sajë të marrëveshjes me “Agjencinë e Abonimit të Shtypit”, merr rregullisht numrat më të fundit të revistave dhe periodikëve në fushën e ekonomisë dhe të inxhinierisë dhe pasuron bibliotekën me to. Titujt e bibliotekës përditësohen rregullisht në databazën e Bibliotekës dhe çdokush, në çdo kohë mund të ketë akses tek titujt që janë gjendje. <b>[Vizita në Institucion; Ev. Nr. 71. Marreveshja CIT - Agjencia e Abonimit te Shtypit 15.09.2021].</b></p>


<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>KU IKT ka ofruar mundësinë e aksesit në biblioteka online si McGrawHill apo O'Reilly, të cilat kanë një literaturë të pasur për fushat e Inxhinierisë përfshirë këtu për inxhinierinë softuerike, data science, programim, AI, shkencave kompjuterike etj. Online ofrohen më se 65 mijë tituj, libra në version audio, video, evente live (kurse online live në internet, biseda me ekspertë, konferenca teknologjike virtuale Superstream etj.), mësim ndërveprues (Sandboxes, skenarë, dhe fletore Jupyter, të mësohet duke vepruar), provime praktike (testet interaktive që ndihmojnë për t'u përgatitur për provim). Veç këtyre, studentët kanë mundësi të aksesojnë edhe burime të hapura (Open Source) që përfshijnë literaturë, tekste, manualë dhe revista shkencore. Studentëve u jepet informacion dhe ndihmohen, nëpërmjet uebsitit të KU IKT edhe me libraritë që ofrojnë falas tekste mësimore, siç janë ato të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Oxford English Dictionary</li> <li>• Edward Elgar</li> <li>• <i>DOAJ – Directory of Open Access Journals</i></li> <li>• JSTOR</li> <li>• <i>SCIENCE COMMONS – Open access Law Journal</i></li> <li>• BioOne Research Evolved</li> <li>• YAKINDU</li> <li>• IOP Electronic Journals</li> <li>• Oxford Reference</li> <li>• OECD iLibrary</li> <li>• Directory of Open Access Books</li> <li>• The New England Journal of Medicine</li> </ul> <p><b>[Vizita në Institucion; RVB; Te dhena mbi biblioteken OREILLY-TEXO per CIT; <a href="https://cit.edu.al/library-2/">https://cit.edu.al/library-2/</a> ]</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve</p>	<p>GVJ u njoh me laboratorët në shërbim të procesit mësimor për programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” dhe konstatoi se ata janë të pajisur me kompjutera të kohës dhe me softuerët e nevojshëm për të realizuar punët e laboratorit,</p>

<p>specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>detyrat, projektet, temat e diplomave si dhe eventualisht punimet kërkimore. Sistemet e shfrytëzimit si dhe softuerët e instaluar në ta janë të licensuar ose përdorin versione open source [Vizita në institucion; RVB].</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>GVJ u informua për përdorimin në KU IKT në funksion të mësimdhënies të platformave E-learning, Google Meet, Classroom, UMS (University Management System), CIT Go Digital dhe O'Reilly duke mundur komunikimin e lektorëve me studentët dhe anasjelltas, transmetimin e materialeve didaktike, dorëzimin e detyrave e projekteve, informimin e studentëve etj.</p> <p>[Takime në institucion; RVB: Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Tabela 17); <a href="https://ums.cit.edu.al/">https://ums.cit.edu.al/</a> ]</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Për komunikimin në kuadër të realizimit të procesit mësimor për programin e studimit përdoret platforma Google Meet/Classroom. Gjithashtu GVJ u informua se studentët mund të aksesojnë të gjithë informacionin që dëshirojnë rreth programit të studimit, vlerësimit, detyrave, orarit etj nëpërmjet sistemit UMS (University Management System) i cili ofron një akses të individualizuar në sistem (aksesim i mundur nëpërmjet faqes web të institucionit - rubrika My CIT) [Takime në institucion; RVB; <a href="https://cit.edu.al/my-cit-2/">https://cit.edu.al/my-cit-2/</a>; <a href="https://ums.cit.edu.al/">https://ums.cit.edu.al/</a> ].</p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Procedura e përzgjedhjes së temave të diplomave dhe e mënyrës së drejtimit të tyre janë përcaktuar në rregulloren e programit të studimit, manualin e punimit të tezës së diplomës dhe modelin e përcaktimit të temës së diplomës. GVJ u informua se stafi akademik u jep studentëve informacionin e domosdoshëm që ata duhet të dijnë mbi temën e diplomës si dhe paraprakisht orientohen drejt fushave dhe temave që ata mund të zgjedhin përmes listës që u vihet në dispozicion. Gjatë përgatitjes së punimit të diplomës studenti mbikqyret dhe asistohet nga udhëheqësi shkencor i cili e ndihmon atë në të gjitha fazat.</p> <p>[Ev. Nr. 77. Model i përcaktimit të temës së diplomës; Ev. Nr. 13. Manual i Punimit të Tezës së Diplomës;]</p>


Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në shërbim të sigurimit të cilësisë, në KU IKT, është ngritur NJSBC e cila, ndërmjet të tjerave, vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore si dhe vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit. Përfundimet dhe rekomandimet e vlerësimit të brendshëm mbështeten në analizën statistikore të të dhënave, në sondazhet, pyetsorët dhe intervistat e organizuara me stafin akademik dhe studentët. Komisioni i Përhershëm për Programet dhe Kurrikulat kontribuon gjithashtu në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Komisioni i Përhershëm për Programet dhe Kurrikulat, dekani, përgjegjës të departamenteve, dhe Njësia e Sigurimit të Cilësisë mbledhen periodikisht për të diskutuar rishikimin e mësimdhënies dhe performancën e çdo programi studimi.</p> <p><b>[Takime në institucion; Ev. Nr.7. Libri i Rregulloreve Institucionale. Ev. Nr.14. Manuali i Stafit Akademik (Staff Handbook)].</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Softuerike është përgjegjës për realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni”. Në këtë mënyrë, Departamenti i Inxhinierisë Softuerike është njëkohësisht përgjegjës për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, detyrë të cilën e realizon në bashkëpunim me NJSBC. <b>[Ev. Nr.7. Libri i Rregulloreve Institucionale]</b> Në mënyrë të veçantë përpunimi i të dhënave të pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së lëndëve për çdo program studimi i cili plotësohet në fund të çdo semestri shërben si bazë për përmirësimet të mëtejshme. Referuar RVB, Departamenti i</p>

	<p>Inxhinierisë Softuerike organizon takime me stafin e angazhuar në programin e studimit në të cilat diskutohen çështje që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit, literaturës, aspekte teknike të mësimdhënies, rritjen e cilësisë së organizimit të orës së mësimin, kërkimin shkencor dhe angazhimin e studentëve në projekte detyra kursi për të përthithur sa më mirë aftësitë dhe kompetencat që duhet të marrin nga secila lëndë [RVB; Ev. Nr. 28. Model Pyetësi Master CE (Computer Engineering &amp; IT)].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti i Inxhinierisë Softuerike i cili është përgjegjës për programin e studimit, ka mbështetur eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Në mënyrë të veçantë në këtë drejtim kanë kontribuar mobilitetet e personelit akademik si dhe shkollat verore të organizuara nga universitete jashtë vendit [Ev. Nr.23. Marreveshjet ne kuader te Erasmus+ 2016-2022; Dokm DVV Evidenca Nr. 24. Marreveshjet me universitetet 2016 – 2022; Evidenca Nr. 19. Master in CE_IT...;].</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nga shqyrtimi dokumentacionit GVJ konstatoi se Departamenti i Inxhinierisë Softuerike mbështet kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik. Në manualin e stafit akademik, përcaktohet se stafi akademik ka mundësi të marrë leje për zhvillim profesional me autorizim me shkrim nga drejtuesi i programit dhe dekanin si dhe të kërkojë kohë të limituar të mësimdhënies për kërkime shkencore dhe zhvillim. [Ev. Nr. 14. Manuali i Stafit Akademik (Staff Handbook)] Stafi akademik ndjek vazhdimisht kualifikime, trajnime, certifikime në fushën e tyre të kërkimit shkencor me qëllim përmirësimin e mësimdhënies. [Ev. Nr. 49. Certifikatat e trajnimeve te stafit nga IKT]. Departamenti i Inxhinierisë Softuerike ka në përbërjen e tij një staf total (viti akademik 2021-2022) prej 12 punonjësish, nga të cilët 10 janë PAE, 1 PAK dhe 1 personel ndihmës akademik. Përsa i përket kualifikimit të PAE, 1 është me titull akademik Profesor, 5 prej tyre janë me gradën shkencore “Doktor”, 1 në proces të përgatitjes së doktoratës, ndërsa 3 janë me diplomën Master i Shkencave [Ev. RVB – Tabela 1: Të dhënat për vitin akademik 2021-2022]. Për programin e studimit ... DIS ka bashkëpunuar me departamentet e tjera dhe ka vënë në dispozicion të tij staf akademik të kualifikuar. [Ev. RVB – Tabela 6.3:</p>




	<p><b>Stafi akademik për programin e studimit Master në Inxhinieri Kompjuterike &amp; Teknologji Informacioni (Vitin akademik 2021 - 2022)].</b> Nga bisedimet me personelin akademik dhe instancat drejtuese si dhe RVB, GVJ konstatoi se Departamenti i Inxhinierisë Softuerike mbështet kualifikimin, duke mundësuar deri në reduktimin e ngarkesës së personelit akademik të angazhuar në programe studimi doktorate. Kualifikimit të vazhduar shkencor i shërbejnë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit me IAL jashtë vendit konkretizuar nëpërmjet mobiliteteve të stafit akademik të DIS [Ev. RVB; Takime në institucion].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>GVJ konstatoi se në rang institucioni janë organizuar trajnime të ndryshme për personelin akademik për përmirësimin e aftësive të tij në mësidhënie si dhe përdorimin apo implementimin e metodave të reja pedagogjike. Ndër to mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Workshop: Gamification in Education</li> <li>• Seminar: “Increasing the Visibility of Scientific Research and Ranking of the University”</li> <li>• Professional training “Cloud Computing and Devops Training – Competitive Advantage and Faster Time to Market”</li> </ul> <p>[Ev. Nr. 49. Certifikatat e trajnimeve te stafit nga IKT; <a href="https://cit.edu.al/save-the-date-seminar-on-friday-7th-of-may-2021-at-1400/">https://cit.edu.al/save-the-date-seminar-on-friday-7th-of-may-2021-at-1400/</a>; <a href="https://cit.edu.al/improve-innovation-with-gamification-workshop-highlights/">https://cit.edu.al/improve-innovation-with-gamification-workshop-highlights/</a>; <a href="https://cit.edu.al/devops-culture-open-lecture/">https://cit.edu.al/devops-culture-open-lecture/</a>]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmesakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Në manualin e stafit akademik janë përcaktuar përgjegjësitë e stafit akademik për mësimdhënien në klasë dhe jashtë saj. [Ev. Nr. 14. Manuali i Stafit Akademik (Staff Handbook)]. Stafi akademik merr pjesë në trajnime për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. [Ev. Nr. 49. Certifikatat e trajnimeve te stafit nga IKT]. Përmirësimi të aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja i kanë shërbyer dhe mobilitetet e stafit akademik në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit [Ev. Nr. 23. Marrëveshjet ne kuader te Erasmus+ 2016-2022; Evidenca Nr. 24. Marrëveshjet me universitetet 2016 – 2022].</p>



<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>GVJ u informua se testimi i metodave të reja të mësimdhënies u shfaq si domosdoshmëri sidomos në kushtet e pandemisë ku u kalua në zhvillimin e procesit mësimor online. Çdo fundjave realizoheshin pyetorë me studentët dhe përgatiteshin raporte javore që diskutoheshin. Elementë të tjerë inovativë kanë të bëjnë me mënyrën e organizimit të punimeve të detyrave apo projekteve duke aplikuar forma të punës në grup, duke zhvilluar në këtë mënyrë edhe elementë të tillë si menaxhimi i ndarjes së punës, integrimi pjesëve individuale në një të tërë, referimi i materialit përfundimtar nga grupi etj. [<a href="https://cit.edu.al/google-meet-training/">https://cit.edu.al/google-meet-training/</a>; Ev. Nr. 19. Master in CE_IT...; Takime në institucion].</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor</p>	<p>GVJ u informua se, KU IKT ka organizuar tryeza, trajnime, pjesëmarrje në kompeticione dhe vizita në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor. Për cikle të caktuar leksionesh, ka patur edhe personel akademik të ftuar nga jashtë vendit (nga Kanada, Turqi, Greqi) si dhe ligjërata të mbajtura me të ftuar nga industria dhe institucione publike (Deloitte; Lufthansa, etj). Referuar RVB, aktivitetet e zhvilluara me kompani, sipërmarrje, banka dhe industri kanë pasur për qëllim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sjelljen sa më pranë studentëve të eksperiencave më të mira në treg.</li> <li>- Informimin e studentëve për procese të ndryshme që lidhen me fushën e tyre të studimit.</li> <li>- Sjelljen e modeleve të suksesshme.</li> <li>- Aftësimin e studentëve me praktikat dhe metodat më të fundit.</li> </ul> <p>[Ev. Nr. 57. Evidenca te organizimit te tryezave te rrumbullakta me kompanite, bizneset; <a href="https://cit.edu.al/">https://cit.edu.al/</a>; RVB; Takime në institucion;]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi III.5**





**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Rregulloret në të cilat përcaktohen kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale lidhur me programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni";</li> <li>- Kapitulli "Mbi Sistemin e Vlerësimit të Studentit", pjesë e Librit të Rregulloreve Institucionale.</li> <li>- Rregullore e Sekretarisë Mësimore për ciklin e dytë të studimeve.</li> </ul> <p>GVJ u njoh me këto rregullore dhe është i mendimit se në të përcaktohen qartë elementët që lidhen me kriteret dhe menyrën e testimit të njohurive. Elementë të detajuar jepen edhe në syllabuset e lëndëve ku për çdo lëndë jepet mënyra e vlerësimit dhe pesha e elementëve të ndryshëm në vlerësimin përfundimtar.</p> <p>Njohja e studentëve me rregulloren specifike të programit të studimit bëhet që në fillimin e studimeve Master i Shkencave, ndërsa elementë me të cilët eventualisht mund të ballafaqohen gjatë periudhës së studimeve trajtohen nga Këshilltari Akademik, përgjegjësi i DIS ose dhe nga lektorë të veçantë. <b>[Dok Evidenca Nr. 10. Rregullore e programit mesimor Master ne Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni; Evidenca 7. Libri i Rregulloreve Institucionale; Evidenca Nr. 12. Rregullore e Sekretarise Mesimore cikli i dyte 2021-2022; Evidenca Nr. 19. Master in CE_IT...; Takime në institucion].</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Metodologjia e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore është specifike për secilën lëndë, ndaj njohja me to realizohet nga titullari i lëndës që në orën e parë të mësimet. GVJ konstatoi se këta elementë janë të parashikuar në syllabuset e lëndëve të cilët janë hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Elementë mbi strukturën e programit, një përshkrim i shkurtër i secilës lëndë jepen, kalendari akademik, orari i mësimet, guida e studentit etj. gjenden dhe në faqen web të institucionit. <b>[Ev. Nr. Evidenca</b></p>

	<b>Nr. 19. Master in CE_IT...; <a href="https://cit.edu.al/">https://cit.edu.al/</a> ; <a href="https://cit.edu.al/student#resources">https://cit.edu.al/student#resources</a> ]</b>			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	<p>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, të cilat për lëndë të ndryshme kanë elementë të përbashkët, por edhe specifika që lidhen me natyrën e lëndës dhe aktivitetet formuese përkatëse. Përgjithësisht, GVJ konstatoi se vlerësimi final përbëhet nga komponentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesëmarrja.</li> <li>- Vlerësimi i vazhdueshëm (ushtrime, detyra, projekte).</li> <li>- Provimi i ndërmjetëm.</li> <li>- Provimi final.</li> </ul> <p>Përsa i përket diplomimit, realizohet me punim diplome.</p> <p><b>[Ev. Nr. Evidenca Nr. 19. Master in CE_IT...; RVB, Takime në institucion;]</b></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Bazuar në syllabuset e lëndëve, GVJ konstatoi se, për programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" kontrolli dhe vlerësimi i njohurive realizohet gjatë gjithë vitit dhe mbyllet me provimin përfundimtar, pesha e të cilit në vlerësimin e përgjithshëm është rreth 30%. Elementët e tjerë që merren në konsideratë gjatë vlerësimit të lëndës janë provimi i pjesshëm (me një peshë që varion nga 20% në 30%) dhe vlerësimi që lidhet me detyrimet e tjerë siç janë prezenca, laboratorët, seminarët, detyrat e kursit, projekti (me një peshë që varion nga 15% në 45%) <b>[Ev. Nr. 19. Master in CE_IT...;]</b>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të	Aktualisht për programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" nuk

<p>testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>është vënë në zbatim ndonjë sistem elektronik i testimit të vlerësimit. Elementë të përdorimit sistemeve elektronike kanë qenë të pranishëm gjatë pandemisë duke shfrytëzuar platformën Google Classroom [<b>Takime në institucion</b>].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Referuar librit të rregulloreve, praktika profesionale dhe diplomimi realizohen nga komisione të ngritura në mënyrë të posaçme, sipas përcaktimeve të rregulloreve përkatëse. Gjatë provimit në sallë ka dhe monitorues të caktuar nga Departamenti. Referuar RVB, testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga titullari i lëndës/modulit si dhe nga një pedagog tjetër përgjegjës.</p> <p><b>[Ev. Nr. 7. Libri i Rregulloreve Institucionale; RVB; Manuali i Punimit të Tezes se Diplomes;]</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Referuar librit të rregulloreve dhe rregullores së sekretarisë së ciklit të dytë, GVJ konstatoi se testimi i njohurive, dijeve me shkrim zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korigjuara në Sekretarinë Mësimore. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studentëve. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre. Gjithashtu, sigurohet infrastruktura e nevojshme e monitoruar me personel [<b>Ev. Nr. 7. Libri i Rregulloreve Institucionale; Evidenca Nr. 12. Rregullore e Sekretarise Mesimore cikli i dyte 2021-2022</b>]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Referuar Rregullores së Sekretarisë Mësimore, brenda dy javëve nga zhvillimi i provimit, në orarin e caktuar për tutoriat dhe/ose këshillim akademik, pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin. Pas këtij afati, pedagogu plotëson dhe dorëzon procesverbalin përfundimtar në Sekretarinë Mësimore. Procesi i këshillimit në lidhje me procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen është gjerësisht i pranishëm gjatë vlerësimit të komponentit që ka të bëjë me detyrat e kursit dhe projektet ku lektori përkatës shoqëron procesin me komente dhe rekomandime [<b>Ev. Nr. 12. Rregullore e Sekretarise Mesimore cikli i dyte 2021-2022</b>]</p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Referuar librit të rregulloreve,” Plagjiatura ose format e tjera të vjedhjes së pronësisë intelektuale janë të ndëshkueshme. Të gjithë anëtarët e komunitetit universitar duhet të japin të dhëna të sakta për autorët, idetë dhe teoritë që nuk janë të tyre”. Në shërbim të ruajtjes, edukimit, informimit dhe njoftimit të studentëve rreth emelenteve si mashtrimi, kopjimi, apo plagjiatura janë vënë rregullore si Kodi i Integritetit Akademik dhe Kodi i Etikës si dhe një numër elementesh janë pasqyruar në syllabuset e lëndëve dhe Guidën e Studentit. Në mënyrë të veçantë i kushtohet rëndësi procesit të verifikimit të plagjiaturës për temat e diplomave duke përdorur platformën Google Classroom (Check plagiarism). Përdorimi i kësaj platforme lehtësohet nga fakti që temat e diplomave përgatiten në gjuhën angleze. Në të ardhmen mendohet të kalohet në përdorimin e platformës Turnitin [Ev. Nr. 7. <b>Libri I Rregulloreve Institucionale: Kreu I Kodet Dhe Parimet Themelore; Takime në institucion; Libri i Rregulloreve Institucionale;</b>]</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Referuar Rregullores së Sekretarisë Mësimore, brenda dy javëve nga zhvillimi i provimit studenti ka mundësi të diskutojë me pedagogun rezultatet e kontrollit të provimit. Nga diskutimet me lektorë dhe studentë të programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni”, GVJ konstatoi se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën, i korrespondojnë një vlerësimi të shtrirë përgjatë gjithë periudhës së zhvillimit të lëndës duke reflektuar gjithë komponentët e formimit Gjithashtu, u konstatua se rezultatet jepen në kohë, bazuar në përcaktimet e rregulloreve përkatëse. [Ev. Nr. 12. <b>Rregullore e Sekretarisë Mesimore cikli i dyte 2021-2022; Takime në institucion.</b>]</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore përcaktohet se brenda dy javëve nga zhvillimi i provimit, në orarin e caktuar për tutoriat dhe/ose këshillim akademik, pedagogu pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin. Nëse studenti nuk e pranon vlerësimin e kryer, mund të paraqesë me shkrim ankimin e tij pranë Përgjegjësit të Departamentit ku të parashtrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. [Ev. Nr. 12. <b>Rregullore e Sekretarisë Mesimore cikli i dyte 2021-2022</b>]</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga</p>	<p>Në Rregulloren Mësimore përcaktohet se marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit ose Dekani (kur pedagogu i lëndës</p>

komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	është vetë Përgjegjësi i Departamentit), ngre një Komision për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vendimi i Komisionit, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar [Ev. Nr. 12. Rregullore e Sekretarise Mesimore cikli i dyte 2021-2022]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  X

<b>Standardi III.7</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Në qëllimin dhe objektivat e programit Masterit të Shkencës në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” thuhet se ky master është projektuar për të përgatitur studentë për karrierë sipas kërkesave teknike të industrisë së inxhinierisë kompjuterike, IT, telekomunikacionit të institucioneve financiare si dhe për studime pasuniversitare post-master në Inxhinieri Kompjuterike ose në fusha të ngjashme. Programi synon që të formojë specialistë të përgatitur në njërin prej profileve: Rrjetat Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike; Big Data dhe Multimedia-Dizajn dhe që do të jenë të aftë të zgjidhin e trajtojnë sfidat dhe probleme akute të shoqërisë dhe industrisë.</p> <p>GVJ është i mendimit se mënyra e zhvillimit të programit të studimit (me integrimin e detyrave e laboratorëve) dhe njohuritë e përfuara krijojnë mundësi për zhvillimin e aftësive të veçanta të studentëve në fushën e Rrjetave Kompjuterike, Sigurisë Kibernetike; Big Data dhe Multimedia-Dizajn. Disa nga lëndët që japin njohuri të thelluara në këto tre profile janë: Information and Communication Security; Cybersecurity; Computer and Network Security; Advanced Cryptography; Database design and administration; Data Analysis I: Statistics; Data Analysis II: Machine Learning; Design Principles for Multimedia; Multimedia Theory; 3D Animation and Virtual Space; Network</p>



	<p>programing. [Ev. Nr. 10. Rregullore e programit mesimor Master ne Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni; Evidenca Nr. 19. Master in CE_IT...; Evidenca nr. 16. Planet mesimore 2021 -2022, 2020 - 2021, 2019-2020]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni”, për vetë natyrën e tij, garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e inxhinierisë kompjuterike dhe e teknologjisë së informacionit. Zhvillimi i programit në gjuhën angleze jep një ndihmesë të konsiderueshme në shfrytëzimin masiv të literaturës në gjuhë të huaj si dhe lehtëson oportunitetet e mobiliteteve për studentët në institucione homologe të arsimit të lartë jashtë vendit. Referuar programit aktual, në të janë integruar dy lëndë lidhur me menaxhimin e projekteve dhe metodat e avancuara të kërkimit. [Ev. nr. 16. Planet mesimore 2021 -2022, 2020 - 2021, 2019-2020].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde janë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve nga vetë pedagogët për lëndët që mbulojnë, nga studentët (nëpërmjet pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies) si dhe nga Përgjegjësi i Departamentit. Edhe Njësia e Sigurimit të Cilësisë zhvillon, shqyrton dhe monitoron kursin dhe pedagogun përmes pyetesorit të vlerësimit, që synon vlerësimin e mesimdhënies dhe mbarevatjen e elementeve të tjera të kursit/lëndës. Referuar RVB, DIS organizon takime me stafin e angazhuar në programin e studimit në të cilat diskutohen çështje që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit, literaturës, aspekte teknike të mësimdhënies, rritjen e cilësisë së organizimit të orës së mësimin, kërkimin shkencor dhe angazhimin e studentëve në projekte detyra kursi për të përthithur sa më mirë aftësitë dhe kompetencat që duhet të marrin nga secila lëndë. [Ev. Nr. 7. Libri i Rregulloreve Institucionale; Evidenca Nr. 28. Model Pyetesori Master CE (Computer Engineering &amp; IT)]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton</p>	<p>Referuar RVB, java e fundit të programit të lëndës është paraparë që të jetë javë përsëritese, në mënyrë që të ndihmojë studentët për të rishqyrtuar edhe njëherë me lektorin e lëndës të gjitha njohuritë dhe konceptet e marra gjatë semestrit. Në të njëjtën kohë, sipas librit të rregulloreve, stafi akademik zhvillon</p>

<p>studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>edhe aktivitet të tutoriatit për të ndihmuar ecurinë e studentëve në institucion si dhe për të parë e trajtuar problematikat që ata kanë. Në programet e lëndëve janë të përcaktuara edhe orët e konsultimeve që janë të perjavshme ose sipas kërkesës së studentëve. Këto konsultime që pedagogët ofrohen të zhvillojnë orientojne më mire studentet në procesin e të mësuarit [Ev. <b>RVB; Takime në institucion; Ev. Nr. 7. Libri i Rregulloreve Institucionale; Evidenca Nr. 19. Master in CE_IT...;</b>].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion, GVJ u informua se, KU IKT ka organizuar disa leksione të hapura dhe seminare në fusha të ndryshme të inxhinierisë dhe teknologjisë së informacionit. Ndër to mund të përmendim: Trajnim ne Devops Culture, leksion i hapur online me Ing. Arlind Qirjazi; "Teknologjia Blockchain: Bitcoin Dhe Per Teper". leksion i hapur online me Dr. Sourav Sen Gupta. etj [Ev. Nr. <b>68. Katalogu i Veprimtarive 2020-2022; Ev. Nr. 67. Katalogu i Veprimtarive 2019-2020</b>]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Nga studimi i planit mësimor GVJ vëren se pothuajse në të gjithë lëndët janë parashikuar seanca laboratorike. [Ev. nr. <b>16. Planet mesimore 2021 -2022, 2020 - 2021, 2019-2020</b>]. Laboratorët në dispozicion të realizimit të programit janë një mbështetje e mirë për realizimin cilësor të punëve të planifikuara laboratorike, duke mundësuar përvehtësimin më të mirë të lëndës dhe zhvillimin e kompetencave individuale. [Takime në institucion].</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Në programet e lëndës vihet re se ndër metodat e mësimdhënies në pothuajse të gjitha lëndët janë diskutimet dhe puna në grup. Nga takimi me personelin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se aplikohen forma të punës në grup për realizimin e detyrave të kursit apo projekteve duke zhvilluar në këtë mënyrë edhe elementë të tillë si diskutimet për problemin dhe menaxhimi i ndarjes së punës, interpretimi dhe zgjidhja e problemit, integrimi pjesëve individuale në një të tërë, referimi i materialit përfundimtar nga grupi etj. [Evidenca Nr. <b>19. Master in CE_IT...; Takime në institucion</b>].</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara</p>	<p>KU IKT ka organizuar leksione e seminare të hapura me personel akademik të ftuar brenda dhe jashtë vendit, ligjërata të mbajtura me të ftuar nga industria dhe institucione publike si dhe tryeza e konferenca studentore, kompeticione të ndryshme, trajnime etj. të cilat i kanë shërbyer krijimit të një klime të</p>


<p>kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studimeve të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetjes së studentëve. Bazuar në tabelën 22 të RVB, për programin e studimit gjatë tre viteve të fundit janë aktivizuar 11 studentë për punime shkencore individuale të pedagogëve, 12 studentë për projekte shkencore në rang Departamenti dhe 17 studentë për projekte shkencore në rang Fakulteti. [Ev. Nr. 68. Katalogu i Veprimtarive 2020-2022; Ev. Nr. 67. Katalogu i Veprimtarive 2019-2020; RVB: tabela 22].</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Gjatë realizimit të programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni”, për përmbushjen e objektivave të tij, synohet përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor me qëllim aftësimin e tyre në fusha me të cilat lidhet programi. Në mbështetje të këtij qëllimi është dhe strategjia e zhvillimit të institucionit, ku te "Misioni, Vizioni dhe Objektivat institucionalë", ndër të tjera, te angazhimet, përcaktohet kryerja e aktiviteteve kërkimore-shkencore për zhvillimin e mëtejshëm të aplikacioneve dhe inovacioneve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe ekonomisë. Nga shqyrtimi i DVV dhe takimet në institucion, GVJ konstatoi se institucioni ka mbështetur idetë inovative të ardhura prej studentëve ose ka krijuar kushtet financiare në mënyrë që këto ide të zhvillohen dhe studentët të angazhohen në realizimin e tyre. Siç rezulton institucioni ka mbështetur financiarisht studentët të cilët kanë marrë pjesë në punimin e platformave të teknologjisë së informacionit ashtu siç ka mbështetur me bursë dhe çmime studentët që kanë marrë pjesë në startup-e dhe kanë rezultuar fitues në fund. KU IKT ka organizuar edhe konferencën studentore “Konferenca e Parë e Projekteve Studentore”</p> <p>[Ev. Nr. 5. Strategjia e RDC (Kerkimit, Zhvillimit dhe Kretivitetit) 2014-2024; <a href="https://cit.edu.al">https://cit.edu.al</a>; <a href="https://cit.edu.al/conference-on-information-technology-innovation-and-economy">https://cit.edu.al/conference-on-information-technology-innovation-and-economy</a>; RVB; Takime në institucion].</p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve</p>	<p>Referuar dokumentacionit të DVV, GVJ konstatoi se KU IKT ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit [Ev. 23.Marreveshjet ne kuader te Erasmus+ 2016-2022; Ev. 24.Marreveshjet me universitetet 2016 – 2022; ] Marrëveshjet me institucione homologe jashtë vendit i kanë</p>






	shërbyer mobilitetit të studentëve. Gjithashtu, në një masë të madhe, i kanë shërbyer edhe mobilitetit të pedagogëve, të cilët nëpërmjet eksperiencës së përfituar dhe transmetimin e saj nëpërmjet formave të ndryshme të mësimdhënies, lehtësojnë mobilitetin e studentëve. Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i studentëve lehtësohet në mënyrë të konsiderueshme duke qenë se procesi mësimor në KU IKT zhvillohet në gjuhën angleze.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Për realizimin e Temës së Diplomës studentët bazohen në Manualin e Punimit të Temës së Diplomës dhe në rregulloren “Mbi Punimin e Diplomës”. [Ev. 7. <b>Libri i Rregulloreve Institucionale; Evidenca Nr. 13. Manuali i Punimit të Tezes së Diplomës</b> ]. GVJ u informua se Rregullorja dhe Manuali i Diplomës u shpërndahen studentëve nëpërmjet Sekretarisë Mësimore. Për elementë që lidhen me plagjiaturën studentët njihen edhe nëpërmjet Guidës së Studentit, e cila vihet në dispozicion edhe nëpërmjet faqes web të KU IKT [ <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/11/Akademic-Calendar-Master-first-year-2021-2022.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/11/Akademic-Calendar-Master-first-year-2021-2022.pdf</a> ; <a href="https://cit.edu.al/student#resources">https://cit.edu.al/student#resources</a> ].
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Referuar rregullores së programit të studimit, diplomimi realizohet me përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome për një temë të caktuar studimi dhe/ose kërkimi. Në fillim të semestrit të parë të vitit të dytë të programit të studimit, studentëve u jepet informacioni i domosdoshëm mbi temën e diplomës si dhe paraprakisht orientohen drejt fushave dhe temave që ata mund të zgjedhin. Gjithashtu bëhet njohja e studentëve me rregulloren dhe manualin përkatës. KU IKT ka zhvilluar edhe leksione të hapura në mbështetje të mbrojtjes së diplomës. [ <a href="https://cit.edu.al/how-to-write-a-diploma-thesis-open-lecture/">https://cit.edu.al/how-to-write-a-diploma-thesis-open-lecture/</a> ; Ev. nr. 10. <b>Rregullore e programit mesimor</b>



	<b>Master ne Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni; Evidenca Nr. 77. Model i percaktimit te temes se diplomes].</b>
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Diplomimi i studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” realizohet nëpërmjet temës së diplomës. [Ev. nr. 10. Rregullore e programit mesimor Master ne Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni].
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	Rregullorja “Mbi Punimin e Diplomës” përcakton se çdo anëtar i personelit akademik, brenda javës së parë të muajit nëntor, ofron propozime konkrete për temat diplome, të cilat ai/ajo është i gatshëm t'i mbikëqyrë, duke bërë kështu të mundur krijimin e një grupi me tema dhe në vijim studenti i interesuar plotëson formularin e aplikimit duke u konsultuar paraprakisht me një drejtues të mundshëm duke i hapur rrugë miratimit të temave para mbylljes së semestrit të parë. [Ev. 7. Libri i Rregulloreve Institucionale; Ev. Nr. 12. Rregullore e Sekretarise Mesimore cikli i dyte 2021-2022; Evidenca Nr. 77. Model i percaktimit te temes se diplomes]
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	GVJ u informua se baza laboratorike kompjuterike është në dispozicion të studentëve diplomantë. Në dispozicion të studentëve janë 3 laboratorë. Udhëheqësi i diplomës bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me studentin për elementë të tillë si përcaktimi i strukturës së punimit dhe objektivave, përgatitja e planit të punës me afatet përkatëse, përzgjedhja e literaturës, hartimi i grafikut e konsultimeve të programuara (minimalisht tre konsultime), përcaktimin e infrastrukturës së nevojshme laboratorike apo matjeve që duhen kryer, etj] Studentët diplomantë, duke qenë se në masën më të madhe janë të punësuar, mund të shfrytëzojnë edhe infrastrukturën përkatëse apo të dhëna nga biznesit apo



	<p>institucioni ku janë punësuar për të realizuar punimin e diplomës. [Ev. 7. <b>Libri i Rregulloreve Institucionale</b>; Ev. Nr. 12. <b>Rregullore e Sekretarise Mesimore cikli i dyte 2021-2022; Takime në institucion</b>].</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësi i temës ka një rol të veçantë në drejtimin e përgatitjes së diplomës duke ndihmuar studentin në mbledhjen e literaturës dhe burimeve të nevojshme për realizimin e tezës së diplomës, vlerësimin në se puna është në përputhje me planin dhe jep rekomandime në lidhje me çështjet që mund të lindin gjatë punës. Veç kësaj, është detyra e udhëheqësit për të ndihmuar studentin në arritjen e formës përfundimtare të tezës së diplomës, duke patur parasysh kërkesat formale dhe përmbajtjen e saj. Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa marrë miratimin e udhëheqësit si garantues i cilësisë së saj akademike. [Ev. 7. <b>Libri i Rregulloreve Institucionale</b>; Takime në institucion].</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të mbrojtjes së diplomës studentit vlerësohet me notë, duke u bazuar në një sistem pikëzimi të anëtarëve të komisionit të mbrojtjes. Referuar librit të rregulloreve institucionale, për secilën Diplomë, Kryetari i Komisionit plotëson formatin përkatës dhe bën mbledhjen e pikëve të vlerësimit të udhëheqësit, oponentit dhe të secilit anëtar të Komisionit, e përpjesëton atë me numrin e vlerësuesve dhe bën konvertimin e rezultatit në notë përfundimtare, sipas sistemit të vlerësimit në fuqi. Në rastin kur udhëheqësi është edhe anëtar i Komisionit, vlerësimi i tij llogaritet vetëm një herë. Rezultati përfundimtar regjistrohet dhe bëhet publik në fund të çdo seance në prani të kandidatëve [Ev. 7. <b>Libri i Rregulloreve Institucionale</b>]</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Studentët e këtij programi studimi pajisen me diplomën përkatëse që i korrespondon formës së regjistrimit të diplomës e realizuar Urdhër Nr.79, datë 31. 08. 2020 të MASR. Ata pajisen dhe me suplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (anglisht dhe shqip), që hartohet nga Sekretaria Mësimore. [Ev. Nr. 17. <b>Shkrese QSHA Urdher 146, dt 31.08.2020 Regjistrim i Formave te Diplomave MSc Inxh Kompj; Evidenca Nr. 7. Libri i Rregulloreve Institucionale</b>].</p>

<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Ndër detyrat e sekretarisë mësimore është edhe përgatitja, sipas akteve ligjore dhe modeleve tip të miratuara nga MAS, e Suplementit të Diplomës, si dokument që i bashkëngjitet Diplomës, e cila përmban të dhëna të detajuara mbi programin e studimeve. GVJ u informua se në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopja e plotë e programit të studimit të zhvilluar. Studenti ka të drejtë të tërheqë një kopje të programit në çdo kohë që ai e sheh të arsyeshme [Ev. Nr. 7. Libri i Rregulloreve Institucionale; RVB; Takime në Sekretarinë Mësimore].</p>
--	--

<p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen</p>	<p>Ndër detyrat e sekretarisë mësimore është edhe krijimi dhe ruajtja e dosjes me dokumentacionin përkatës për çdo student. GVJ konstatoi se në sekretarinë mësimore, për çdo student të regjistruar gjendet dosja personale me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas udhëzimeve të viteve akademike respektive. Gjithashtu informacioni për çdo program studimi, është i ruajtur në hard copy dhe në mënyrë elektronike. Dosjet gjenden në Sekretarinë e Fakultetit dhe në Arkivin e institucionit. Dokumentacioni ruhet duke respektuar Rregulloren e Arkivës. Sekretaria mësimore çdo vit përgatit të dhëna statistikore lidhur me regjistrimet e studentëve, transferimet, çregjistrimet e tyre, mobilitetin etj. [Ev. 7. Libri i Rregulloreve Institucionale; Takime në Sekretarinë Mësimore].</p>
--	---

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<p><b>Standardi IV.1</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.</b></p>
--

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Nga takimi në zyrën e Burimeve Njerëzore GVJ konstatoi se për stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi disponohet dokumentacioni i plotë. Nga ana e GVJ u ndoq një procedurë për rekrutim. Në këtë dokumentacion përfshihen CV e përditësuar, kualifikime, punimet me të fundit kërkimore shkencore, kontrata e punës etj. Dosjet e konsultuara në mënyrë rastësore nga GVJ u gjetën të plota. Për personelin akademik të huaj kërkohet edhe leja e punës si dhe njohja e diplomave e titujve. U verifikuan edhe disa modele kontratash (me kohë të plotë, me kohë të pjesshme, rinovim kontratash, profesorët Open Lecture, për personel të huaj). Zyra e Burimeve Njerëzore ishte e dixhitalizuar [Ev. Vizitë në Zyrën e Burimeve Njerëzore]. Përsa i përket angazhimit të personelit akademik në çdo semestër dhe vit akademik, të dhënat që kanë të bëjnë me këtë proces ruhen në Sekretarinë mësimore [Ev. RVB; Vizitë në Sekretarinë Mësimore].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Rekrutimi i stafit akademik, ndihmës-akademik, personelit administrativ në KU IKT bëhet në mbështetje të Legjislacionit të Punës në Republikën e Shqipërisë, të ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, akteve ligjore dhe nënligjore të shprehur në Statut dhe në Rregulloret përkatëse. Institucioni garanton zbatimin e procedurave të qarta në lidhje me rekrutimin e personelit akademik efektiv dhe me kontratë. Dokumentacioni i detajuar mbi rekrutimin dhe procedurat gjendet në rregulloren “Politikat dhe procedurat për rekrutimin e stafit akademik” në Librin e Rregulloreve Institucionale [Ev. Libri i Rregulloreve Institucionale]. Në praktikën e tij Fakulteti i Inxhinierisë merr të gjitha masat që në procesin e rekrutimit të punësojë ekspertë që i përshtaten programeve të ofruara të studimit. Në përzgjedhjen e kandidatit në mënyrë specifike vlerësohen edukimi/kualifikimi, kërkimi shkencor dhe eksperiencia profesionale. Fushat e specializimeve të pedagogëve synohet të jenë në përputhje me programin e studimit ose të përafërta me të. Të gjithat të dhënat mbi rekrutimin e personelit akademik disponohen sipas dosjeve përkatëse në vite në Zyrën e Burimeve Njerëzore [Ev. RVB; Vizitë në Zyrën e Burimeve Njerëzore].</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriterere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>GVJ u informua se mbi bazën e nevojave të DIS për mbulimin e programit të studimit me personel akademik hartohet propozimi duke specifikuar profilin dhe detyrat e personelit akademik të kërkuar. Vendimi për shpalljen e vendit vakant dhe kriterëve përkatëse merret nga Rektori. Hapja e vendit ë punës transmetohet në <i>e-albania</i> dhe në zyrën e punës si dhe publikohet në faqen web të KU IKT [Ev. RVB; Ev. Vizitë në Zyrën e Burimeve Njerëzore].</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Gjatë takimit në Zyrën e Burimeve Njerëzore GVJ u njoh me procedurat e rekrutimi dhe vlerësimi të cilat në KU IKT konsistojnë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Preselektim i kandidaturave i cili bëhet në konsultim me Departamentin, duke ju referuar kriterëve të publikuara;</li> <li>- Kandidatët e preselektuar kalojnë një intervistë (përpara një komisioni prej 6 anëtarësh) si dhe u kërkohet të mbajnë një leksion të hapur;</li> <li>- Për renditjen e kandidatëve përdoret një sistem pikëzimi që merr në konsideratë edhe elementë specifike si aftësitë komunikuese, zotërimi i gjuhës angleze, aktiviteti kërkimor e botues dhe përputhshmëria e tij me profilin e ngarkesës mësimore, përvoja e punësimit dhe rekomandimet e punëdhënësve të mëparshëm;</li> <li>- Kandidatët jo-fitues njoftohen individualisht bashkë me një arësytim për moskualifikimin e tyre për pozicionin e shpallur;</li> <li>- Kandidatët fitues paraqiten në Zyrën e Burimeve Njerëzore për të plotësuar dokumentacionin që do të jetë pjesë e dosjes së tyre.</li> </ul> <p>KU IKT synon me prioritet të rekrutojë lektorë të huaj, por proceduara edhe në këtë rast mbetet e njëjtë.</p> <p>[Ev. Vizitë në Zyrën e Burimeve Njerëzore; <a href="https://cit.edu.al/faculty-of-engineering-vacancies/">https://cit.edu.al/faculty-of-engineering-vacancies/</a> ].</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

**Standardi IV.2**



Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe vizitat në institucion, GVJ konfirmon se KU IKT disponon mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike. Transferimi në ambientet e reja në Kompleksin "Xhura", Rruga "Xhanfize Keko" jo vetëm kontriboi në rritjen e kapaciteteve përsa u përket mjediseve, por edhe në ofrimin e mjediseve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor. Gjithashtu, baza laboratorike informatike garanton një zhvillim cilësor të procesit mësimor në përputhje me natyrën specifike të moduleve që ndërtojnë këtë program studimi. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se mjediset në të cilat zhvillohet procesi mësimor i programit të studimit përmbushin më së miri standartet dhe janë në raport të drejtë me numrin e stafit akademik dhe të studentëve të programit. Auditorët, zyrat, laboratorët janë të ndriçuara drejt dhe të pajisura me të gjithë mjetet didaktike që mundësojnë një zhvillim normal të procesit mësimor [Ev. Vizita në institucion].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është personel akademik kryesisht me kohë të plotë dhe përmbush kërkesat ligjore në fuqi përsa i përket kualifikimit [Ev. CV e stafit akademik të programit të studimit]. GVJ u informua se DIS organizon në mënyrë të vazhdueshme konferenca e aktivitete të tjera të cilat në mënyrë të veçantë i shërbejnë kualifikimit të mëtejshëm të personelit akademik. Kualifikimit të vazhduar shkencor i shërbejnë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit me IAL jashtë vendit konkretizuar nëpërmjet mobiliteteve të stafit akademik të DIS [Ev. 26. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS, fq 20-21]. Mbështetja në drejtim të kualifikimit konkretizohet edhe nëpërmjet mbështetjes financiare të institucionit për publikime falas në revistën shkencore institucionale, në sponsorizimin e publikimeve të monografive të tyre, në pjesëmarrjen falas në konferencat e organizuara prej institucionit, ashtu sikurse dhe në sponsorizimin për të marrë</p>

	pjesë në konferenca ndërkombëtare [Ev. Takime në institucion; 56. Evidenca mbi konferencat e KU IKT ].																											
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtëjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	GVJ konstaton se DIS i cili është përgjegjës për programin e studimit, ka mbështetur kualifikimin e mëtëjshëm profesional të personelit akademik si dhe eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Në mënyrë të veçantë në këtë drejtim kanë kontribuar mobilitetet e personelit akademik, shkollat verore të organizuara nga universitete jashtë vendit si dhe trajnimet apo workshop të realizuara nga institucioni. [Marreveshjet ne kuader te Erasmus+ 2016-2022; Marreveshjet me universitetet 2016 – 2022; RVB].																											
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	<p>GVJ konstaton se për realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" Fakulteti i Inxhinierisë ka angazhuar dhe angazhon staf akademik me grada dhe tituj i cili vjen nga brenda dhe nga jashtë vendit.</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020, 2020-2021 dhe 2021-2022 ngarkesa mësimore për programin e studimit është mbuluar nga personeli akademik si vijon:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="3">Viti</th> <th colspan="2">PAE (kategoria)</th> <th colspan="2">PAK (kategoria)</th> </tr> <tr> <th>Profesor (Prof/Prof.As.)</th> <th>Lektor (Dr.)</th> <th>Profesor (Prof/Prof.As.)</th> <th>Lektor (Dr.)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2019-2020</td> <td>3</td> <td>4</td> <td>3</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>2</td> <td>5</td> <td>4</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>2</td> <td>8</td> <td>2</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table> <p>duke dëshmuar për një angazhim optimal të burimeve njerëzore për të përmbushur objektivat e programit të studimit [Ev. RVB - Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit (Tabelat 6); Takime në institucion].</p>				Viti	PAE (kategoria)		PAK (kategoria)		Profesor (Prof/Prof.As.)	Lektor (Dr.)	Profesor (Prof/Prof.As.)	Lektor (Dr.)	2019-2020	3	4	3	2	2020-2021	2	5	4	1	2021-2022	2	8	2	1
Viti	PAE (kategoria)		PAK (kategoria)																									
	Profesor (Prof/Prof.As.)	Lektor (Dr.)	Profesor (Prof/Prof.As.)	Lektor (Dr.)																								
	2019-2020	3	4	3	2																							
2020-2021	2	5	4	1																								
2021-2022	2	8	2	1																								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Në përmbushje</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>																								
				X																								




### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kwrkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe vizitat në institucion, GVJ konfirmon se KU IKT disponon mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse në auditor. Gjithashtu, baza laboratorike informatike garanton një zhvillim cilësor të procesit mësimor në përputhje me natyrën specifike të moduleve që ndërtojnë këtë program studimi. Transferimi në ambientet e reja në Kompleksin "Xhura", Rruga "Xhanfize Keko" jo vetëm kontriboi në rritjen e kapaciteteve përse u përket mjediseve, por edhe në ofrimin e mjediseve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor. Sipas RVB, në shërbim të procesit mësimor të Fakultetit të Inxhinierisë janë 994 m<sup>2</sup>. Prej tyre 3 klasa me një sipërfaqe totale prej 163 m<sup>2</sup> janë për zhvillimin e orëve mësimore teorike për leksione, seminare dhe ushtrime, në shërbim të programit të studimit. Nga vizita e mjediseve, GVJ konstatoi se ato përmbushin më së miri kushtet për zhvillimin e një procesi mësimor cilësor <b>[Ev. Vizita e mjediseve; 31. Planimetrite]</b>. Duhet theksuar dhe fakti që për programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni", duke qenë se studentët në një masë të madhe janë të punësuar, mësimi zhvillohet pasdite <b>[Ev.Takime në institucion]</b>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>KU IKT ka vënë në dispozicion të realizimit të këtij programi studimi mjedise të mjaftueshme, me kushte të përshtatshme dhe të paisura me infrastrukturën e duhur për zhvillimin normal të procesit mësimor. Gjatë vizitës në institucion GVJ pati mundësinë të njihet me infrastrukturën mësimore në funksion të realizimit të këtij programi studimi. Gjithashtu, për nga vetë natyra e programit të studimit, mjediset e zhvillimit të procesit mësimor janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, videoprojektor, si mundësi aksesimi të internetit, etj. Laboratorët mund të aksesohen në çdo moment gjatë gjithë javës (e hënë – shtunë) nga ora 9:00</p>

	deri në 21:00. [Ev. Vizita e mjediseve; Takime në institucion].
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Për programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" realizimi i seancave të ushtrimeve, seminareve, detyrave të kursit dhe projekteve kërkon mbështetjen e një baze të fuqishme informatike. GVJ konstatoi se nga ana e institucionit në përgjithësi dhe Fakultetit të Inxhinierisë në veçanti i është kushtuar një vëmendje e veçantë paisjes me infrastrukturën e duhur informatike në mbështetje të programit. Kjo infrastrukturë informatike është e mbështetur dhe nga sisteme shfrytëzimi dhe programe kompjuterike që i korrespondojnë nivelit të kërkuar të formimit Master i Shkencave. Në RVB jepet lista e sistemeve të shfrytëzimit të instaluar si dhe e programeve të karakterit të përgjithshëm dhe profesional të pranishëm në laboratorët përkatës. GVJ u informua se për sistemin e shfrytëzimit Windows dhe paketën Microsoft Office disponohen licensat përkatëse, ndërsa sistemi i shfrytëzimit Linux si një numër i madh programesh informatike i përkasin së licensuar nën GNU General Public License. GVJ është i mendimit se kjo infrastrukturë informatike plotëson më së miri kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi [Ev. Vizita e takime në institucion; RVB].
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Për vetë natyrën e programit të studimit, mbështetja për realizimin e tij janë laboratorët e informatikës, të cilët janë të paisur me programe profesionale dhe mbështesin realizimin cilësor të procesit mësimor me gjithë elementë e tij përbërës [Ev. Vizita e ambienteve; RVB].
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Marrëveshjet me institucione kërkimore, sipërmarrje, kompani të fushës së inxhinierisë kompjuterike kontribuojnë që studentët e programit të studimit të zhvillojnë praktikat mësimore pranë këtyre institucioneve përgjatë periudhës së përcaktuar në programin e studimit. Po ashtu, GVJ u informua se gjatë kryerjes së praktikave profesionale dhe në mënyrë të veçantë temave të diplomave, studentët shfrytëzojnë edhe infrastrukturën e institucioneve përkatëse. Për studentët e këtij programi studimi kjo lehtësohet edhe nga fakti që duke qenë të punësuar të kenë akses në këtë infrastrukturë. Një shfrytëzim i



	zgjeruar kapacitetesh për zhvillimin e aspekteve praktike të programit mundësohet edhe në kuadër të mobiliteteve të studentëve në universitete jashtë vendit. [Ev. Takim me studentët; 48. Informim mbi mundësitë e punësimit dhe zhvillimit të praktikave mesimore në kompani të ndryshme].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mesimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve një bibliotekë të pasur e cila përbëhet nga dy pjesë integrale: biblioteka me libra të printuar dhe biblioteka virtuale në sajë të marrëveshjes me McGrawHill Education dhe O'Reilly. Biblioteka ka një fond relativisht të pasur me libra në fushat e Inxhinierisë (sektorë të dedikuar për inxhinieri softuerike, data science, programim, AI, shkencave kompjuterike etj) si dhe shkencave të natyrës, matematikë, fizikë, statistikë, kimi. Marrëveshja me McGrawHill Education (e rinovuar në shtator 2021) përmbush nevojën për literature në gjuhën angleze duke patur akses të gjerë nga studentët nga çdo kompjuter brenda dhe jashtë kampusit në tekste on-line [Ev. 64. Dokumentacioni mbi Bibliotekën e KU IKT; 43. Te dhena mbi bibliotekën OREILLY-TEXO per CIT; 65. Marreveshje CIT - McGrawHill].
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mesimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista	GVJ u informua se biblioteka ka rreth 3000 tituj, nga të cilët rreth 2780 tituj në anglisht. Të gjithë titujt e bibliotekës përditësohen rregullisht në databazën e Bibliotekës dhe çdokush, në çdo kohë mund të ketë akses tek titujt që janë gjendje. Biblioteka ka një sipërfaqe prej 90 m <sup>2</sup> dhe një kapacitet prej 20 vendesh, ku 6 vende janë për përdorim kompjuteri dhe

<p>shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>interneti. [Ev. Vizita në bibliotekë; 33. Raporti i Grupit të Punes për Verifikimin e Standardeve dhe Normativave të Infrastruktura nga MASR 28.07.2020; Aneksi: Mjediset e Fakultetit/Njësi Bazë (Tabela 16/2 - INFRASTRUKTURA NË FUNKSION DHE SHËRBIM TË PROGRAMIT Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni")].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ u informua se biblioteka e ofron shërbimin e saj pa pagesë si për studentët ashtu edhe për personelin akademik. Studentët kanë mundësinë të konsultojnë librat (të fondit fizik të saj) në ambientin e bibliotekës, ose të shfrytëzojnë on-line pakufizim bibliotekën shumë të gjerë virtuale. Duhet theksuar se nëpërmjet bibliotekës virtuale studentë kanë akses në botimeve të viteve të fundit, shumë të nevojshme në fushën e inxhinierisë kompjuterike dhe teknologjisë së informacionit ku ka zhvillime shumë dinamike. [Ev. Vizita në bibliotekë; <a href="https://cit.edu.al/library-2/">https://cit.edu.al/library-2/</a>; Aneks 1: Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Tabela 17)].</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka është e paisur me PC të cilët kanë akses dhe në internet duke mundësuar aksesimin në bibliotekat virtuale të cilat institucioni ka abonime [Ev. Vizita në bibliotekë].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>GVJ konstaton që KU IKT ndjek një politikë të qartë në lidhje me pasurimin e fondit të bibliotekës. Duke u kushtëzuar edhe nga pandemia, prioritet vitet e fundit ju dha bibliotekës virtuale duke mundësuar në këtë mënyrë aksesimin në literaturën e viteve të fundit. Në rastin e programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni", për të cilin mësimdhënia realizohet në gjuhën angleze, zgjerimi i përdorimit të bibliotekës virtuale përbën një avantazh të konsiderueshëm, duke shmangur ballafaqimin e studentëve me barrierën e gjuhës. Nga takimet në institucion GVJ u informua se përdorimi i bibliotekës virtuale, për vetë avantazhet që ajo paraqet, do të vazhdojë të bëjë pjesë në prioritetet e orientimit të fondit financiar të dedikuar bibliotekës [Ev. 42. Te dhëna mbështetese për blerjen e</p>

	<b>literatures ne biblioteken e IKT; 64. Dokumentacioni mbi Biblioteken e KU IKT; Takime në institucion].</b>			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Biblioteka qëndron e hapur çdo ditë, E Hënë –E Premte, ora 09:00 – 13:00 dhe 14:00 – 18:00 dhe të Shtunën 08:00-15:00. GVJ është i mendimit se, në njëfarë mase, këto orare mbulojnë edhe nevojat e studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni", kjo dhe për faktin që ata kanë mundësi të pakufizuar për të shfrytëzuar në distancë bibliotekën shumë të pasur virtuale [Ev. <a href="https://cit.edu.al/library-2/">https://cit.edu.al/library-2/</a> ; Takime në institucion].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.5


**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Menaxhimi i informacionit që lidhet me aktivitetin e studentit në KU IKT garantohet nga Rregulloret përkatëse [Ev. <b>Libri i Rregulloreve Institucionale; Rregullore e Sekretarise Mesimore cikli i dyte 2021-2022</b> ]. Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se dokumentacioni që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me mbajtjen në format letër të Rregjistrimit themeltar, Rregjistrimit të arritjeve akademike, Rregjistrimit të kursit dhe Rregjistrimit të diplomave si dhe me dokumentacionin e dorëzuar nga studenti në momentin e regjistrimit/transferimit. Për menaxhimin e informatizuar të informacionit në KU IKT është zhvilluar një sistem i emërtuar UMS (University Management System), i cili është i bazuar në një platformë online, i aksesueshëm nga të gjithë studentët, stafi administrativ (sekretaritë) dhe ai akademik i KU IKT, nëpërmjet një Username-i dhe Fjalëkalimi të mundësuar nga

	departamenti i IT [Ev. Vizita në institucion; <a href="https://ums.cit.edu.al/index.php?signIn=1">https://ums.cit.edu.al/index.php?signIn=1</a> ].
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i informacionit i KU IKT (UMS) synon të kontribuojnë në menaxhimin e institucionit. Ky sistem është në përmirësim të vazhdueshëm dhe <i>GVJ është i mendimit se akoma nuk e ka arritur fazën e një sistemi informacioni tërësor</i> për të menaxhuar plotësisht informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit [Ev. Vizita në institucion]; <a href="https://ums.cit.edu.al/index.php?signIn=1">https://ums.cit.edu.al/index.php?signIn=1</a> ].
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Aksesi në sistemin UMS mundësohet nëpërmjet faqes web të KU IKT ku propozohet hyrja dedikuar studentëve dhe stafit nëpërmjet adresës email dhe fjalëkalimit të personalizuar. Me anë të këtij sistemi i mundësohet sekretarive mësimore të hedhin online rezultatet e provimeve për studentët, të ndarë sipas grupeve dhe programeve përkatëse [Ev. Vizita në institucion; <a href="https://ums.cit.edu.al/index.php?signIn=1">https://ums.cit.edu.al/index.php?signIn=1</a> ].
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	GVJ konstatoi se një nga rubrikat e sistemit UMS mundëson aksesimin në platformën Google Classroom dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. Në mënyrë të veçantë në kushtet e pandemisë, u shfrytëzua gjerësisht platforma Google Classroom nëpërmjet të cilës postoheshin edhe materialet për çdo temë mësimore si dhe Google Meet për të mundësuar komunikimin online [Ev. Takime në institucion; <a href="https://ums.cit.edu.al/index.php?signIn=1">https://ums.cit.edu.al/index.php?signIn=1</a> ].
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Referuar RVB, sistemi i menaxhimit UMS garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe u mundëson studentëve informacion mbi vlerësimet, mungesat, provimet etj. Ndërkaq sistemi prodhon edhe raportime individuale ose të përgjithshme me të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. [Ev. Takime në institucion; <a href="https://ums.cit.edu.al/index.php?signIn=1">https://ums.cit.edu.al/index.php?signIn=1</a> ]
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në	Faqja web e KU IKT është e mirëorganizuar dhe ofron një informacion të zgjeruar mbi institucionin në përgjithësi si dhe programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri

<p>faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni". Gjithashtu, nëpërmjet faqes web, mund të përftohet informacion i zgjeruar për stafin akademik, informacion mbi kriteret e pranimit, tarifat e studimit, përfitim e bursave të studimit dhe çdo lloj informacioni tjetër, që ka të bëjë me aktivitetet e përditshme të Insitucionit. Ndërkohë, në faqen web ndodhet një seksion i veçantë për studentët, ku gjenden informacione për aktivitetet e tyre të përditshme. Për informacionet e përgjithshme faqja web mund të aksesohet nga çdo përdorues, pa limitime aksesi, ndërsa rubrikat e <i>My CIT</i> mund të aksesohen vetëm nga përdorues të rregjistruar (me username et password). Informacioni në faqen web ofrohet në të dy gjuhët: shqip dhe anglisht.</p> <p>[Ev. <a href="https://cit.edu.al/">https://cit.edu.al/</a>; <a href="https://sq.cit.edu.al/">https://sq.cit.edu.al/</a>; <a href="https://cit.edu.al/faculty-of-engineering/">https://cit.edu.al/faculty-of-engineering/</a>; <a href="https://sq.cit.edu.al/fakulteti-i-inxhinierise/">https://sq.cit.edu.al/fakulteti-i-inxhinierise/</a>; Takime në institucion].</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Standardi IV.6</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ pati në dispozicion planin e financimit të Departamentit të Inxhinierisë Softuerike ku në zërin e të ardhurave figurojnë tarifat për dhe gjatë shkollimit, ndërsa te shpenzimet elementë të tillë si: Pagat dhe kontributet e sigurimeve, Shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes, shpenzime të tjera, investime, kërkimi shkencor dhe konferenca. Në tabllonë e paraqitur, për vitin 2021-2022, për Departamentin e Inxhinierisë Softuerike, shpenzimet përfaqësojnë vetëm rreth 46% të të ardhurave, por në rang institucioni, shpenzimet përfaqësojnë rreth 91% të të ardhurave. Duhet theksuar se informacioni nuk është i veçantë për programin</p>



e studimit [Ev. Fakulteti i Inxhinierise - Raporti Financiar 2019 - 2022 dhe Plani i Financimit 2021 - 2025; RVB].

**Kriteri 2.** Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.

Duke ju referuar të dhënave financiare të institucionit të shprehura në përqindje në tabelën e mëposhtme, GVJ konstatoi se institucioni ka qëndrueshmëri financiare, duke qenë se shpenzimet, për tre vitet e fundit, variojnë nga 87 deri në 93% të të ardhurave.


Të ardhurat	2021-2022	2020-2021	2019-2020
	%	%	%
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	98.3	95.8	93.7
Shërbimet trajnuese	1.6	4.1	6.2
Donacionet	0.1	0.1	0.1
<b>Shuma</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>

Shpenzimet	%	%	%
Pagat dhe kontributet e sigurimeve	65.3	66.5	61.5
Shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes	22.0	22.8	24.9
Shpenzime të tjera	0.8	0.8	0.7
Investime	2.1	2.2	0.2
Kërkimi shkencor	0.5	0.5	0.0
Konferenca	0.1	0.1	0.1
<b>Shuma</b>	<b>91</b>	<b>93</b>	<b>87</b>

Ndërsa kërkimi shkencor i cili nuk ka qenë financuar në vitin 2019-2020, konsatohet që tashmë bën pjesë në zërat e financuara. Megjithatë, duke qenë se masa e financimit **kërkim shkencor plus konferenca**, i marrë sëbashku, është relativisht i ulët, GVJ rekomandon rritjen e peshës së këtyre zërave në vitet në vijim. E



	njejta gjë mund të thuhet edhe për Fakultetin e Inxhinierisë, i cili ka peshën më të madhe qoftë në të ardhurat, qoftë në shpenzimet <b>[Ev. Fakulteti i Inxhinierise - Raporti Financiar 2019 - 2022 dhe Plani i Financimit 2021 - 2025]</b> .
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Referuar RVB, "CIT shpk" kryen Auditim Financiar të jashtëm çdo vit. "CIT Shpk" angazhon Audit të pavarur për të kryer auditimin e pasqyrave financiare të çdo viti fiskal. Bilanci zyrtar i përvitshëm pasqyron auditimin e plotë financiar dhe ligjor të situatës financiare të "CIT shpk" në përputhje me ligjet dhe udhëzimet e kontabilitetit. Referuar RVB dhe raporteve të kërkuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, konstatohet se institucioni paqaset një tablo të të ardhurave nga tarifatat për dhe gjatë shkollimit, shërbimet trajnuese dhe Donacionet. GVJ konstaton gjithashtu se burimi parësor i të ardhurave janë të ardhurat nga tarifatat për dhe gjatë shkollimit, të cilat për tre vitet e fundit variojnë nga 93.7% të të ardhurave në vitin 2019-2020 deri në 98.3% në vitin 2021-2022 <b>[Ev. RVB; Raport i Auditit të Jashtëm për institucionin; Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS]</b> .
<b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	GVJ u informua se prej Zyrës së Financës kryhet në mënyrë të vazhdueshme një analizë financiare për ecurinë e programeve të studimit dhe prej saj nxirren dhe përpunohen të dhëna mbi ecurinë e programeve të studimit, ndërhyrjet e posaçme, apo dhe mbështetjet e domosdoshme kur kërkohet, në mënyrë që të sigurohet ecuria dhe mbarëvajtja normale e programeve të studimit. GVJ pati në dispozicion planin e financimit të tre viteve të fundit dhe konstatoi se në global garantohet qëndrueshmëria financiare (të dhënat deri në nivel Departamenti). Megjithatë GVJ nuk gjeti informacion të detajuar mbi ecurinë e programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" për të mundësuar një gjykim më të thelluar të ecurisë dhe perspektivës së këtij programi studimi <b>[Ev. RVB; Fakulteti i Inxhinierise - Raporti Financiar 2019 - 2022 dhe Plani i Financimit 2021 - 2025]</b> .
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të	Duke ju referuar të dhënave financiare të institucionit, GVJ konstatoi se institucioni ka qëndrueshmëri financiare, duke qenë se shpenzimet, për tre vitet e fundit, variojnë nga 87 deri në 93% të të ardhurave. Gjithashtu GVJ konstatoi se, në se u referohemi tre viteve të fundit, ka një rritje të të ardhurave (rritje vjetore rreth 14%), gjë që dëshmon se institucioni, në se ruhet kjo tendencë,



mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	garanton qëndrueshmërinë financiare. Referuar RVB, kërkohet një angazhim edhe më i madh prej institucionit në fushën e aplikimit të projekteve shkencore dhe atyre kërkimore [Ev. RVB; Fakulteti i Inxhinierise - Raporti Financiar 2019 - 2022 dhe Plani i Financimit 2021 - 2025]			
Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ u informua për procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni". Pranimi i studentëve, përparimi i tyre përgjatë kursit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në mënyrë të veçantë realizimi i këtyre elementëve mbështetet në Statutin e KU IKT, Rregulloren e institucionit, Rregulloren e Fakultetit, Rregulloren e DIS, Rregulloren e programit të studimit, Librin e rregulloreve institucionale (ku përfshihen, ndërmjet të tjerash, Rregulloret. Mbi hartimin e programit të lëndës, Strategjitë e mësimdhënies në KU IKT, Vlerësimin e studentit, Mbi praktikën profesionale, Mbi punimin e diplomës, Kriteret e regjistrimit për studentët e ciklit të dytë, Kriteret për transferimin dhe mobilitetin e studentëve. Mbi përfshirjen e studentëve në vendimmarrje në KU IKT, Politikat dhe procedurat e ankimimit të studentëve). Nga takimet në

	<p>institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e KU IKT zhvillohet në përputhje me këto rregullore dhe se u garantohet barazia dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet [Ev. Statuti i KU IKT; Libri i Rregulloreve Institucionale; Rregullore e Fakultetit të Inxhinierise; Rregullore e Departamentit të Inxhinierise Softuerike; Rregullore e programit mesimor Master në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat e ndjekura nga KU IKT janë të mirëpërcaktuara duke garantuar barazinë tek çdo student në këtë program studimi. GVJ konstatoi se garancia sigurohet nëpërmjet përcaktimit në rregulloret e ndryshme të të gjithë elementëve që lidhen që me pranimin në këtë program studimi, ndjekjen e procesit mësimor, vlerësimin e studentit e deri në diplomim. Procedurat e ndjekura janë në përputhje dhe përshtaten në mënyrë të vazhdueshme me udhëzimet, vendimet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Veprimtaria mësimore organizohet dhe realizohet nga DIS dhe drejtohet dhe kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese përkatëse me kompetenca të përcaktuara në rregulloret përkatëse. [Ev. RVB; Rregullore të institucionit; Takime në institucion].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e regjistrimit bazohen në legjislacionin në fuqi dhe shpallen pas miratimit të tyre në Senatit Akademik dhe aprovimit prej Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. GVJ konstatoi se një ndihmesë të rëndësishme në procesin e informimit të kandidatëve për studentë dhe njohjes së kriterëve dhe procedurave japin faqja web e institucionit [Ev. <a href="https://cit.edu.al/">https://cit.edu.al/</a>] (kryesisht për pranimet, ofertën akademike, një tablo të përgjithshme të KU IKT etj.) dhe Guida e Studentit (ku jepet informacion për elementë të tillë si marrëdhënien e studentit me administratën, detyrat dhe përgjegjësitë, të drejtat, udhëzime të përgjithshme, udhëzime për provimet, detyrat e kursit, frekuentimin, vlerësimin, ankimimin, politikat e pranimit, transferimit, shërbimet mbështetëse, IT, bibliotekën, politikat dhe rregullore të ndryshme etj). Kriteret dhe procedurat janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku [Ev. <a href="https://cit.edu.al/student">https://cit.edu.al/student</a>; <a href="https://cit.edu.al/master-in-computer-engineering-it-computer-engineering-and-big-data-2/">https://cit.edu.al/master-in-computer-engineering-it-computer-engineering-and-big-data-2/</a> ].</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të krediteve jepen në Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" dhe në Rregulloren e Fakultetit të Inxhinierisë. Këto informacione mund të aksesohen edhe nëpërmjet faqes web të institucionit. Si kriter specifik (vetëm preferencial dhe jo detyrues) përcaktohet nota mesatare e ciklit Bachelor jo më e vogël se 7.5. GVJ konstatoi se <b>kriteri i notës mesatare në përgjithësi nuk është zbatuar</b>. Duke ju referuar notës mesatare të studentëve të pranuar në këtë program për tre vitet e fundit, rezultojnë se ajo varion nga 5.5 në vitin akademik 2019-2020 për profilin "Multimedia Dizajn" deri në 7.99 në vitin akademik 2020-2021 në profilin "Big Data". Gjithashtu, vihet re që ka një rënie të cilësisë së studentëve të pranuar në vitin akademik 2021-2022 (nota mesatare e studentëve të pranuar varion nga 5.93 në profilin "Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike" deri në 6.25 në profilin "Multimedia Dizajn"). Kriter tjetër specifik është që kandidati të ketë përfunduar në përgjithësi studimet e ciklit të parë në inxhinieri softuerike, inxhinieri kompjuterike, IT, telekomunikacion, në programe të përafërta të inxhinierisë si dhe në ato të shkencave natyrore (por ky kriter nuk është pasqyruar në faqen web). [Ev. Rregullore e programit mesimor Master ne Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni; <a href="https://cit.edu.al/admissions-3/">https://cit.edu.al/admissions-3/</a> ]</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit publikohen në faqen web përpara fillimit të vitit akademik [Ev. <a href="https://cit.edu.al/admissions-3/">https://cit.edu.al/admissions-3/</a> ]. Referuar RVB dhe takimeve në institucion, GVJ u informua se pjesë e informimit dhe udhëzimit të publikut janë dhe Ditët e Hapura të organizuara nga institucioni si dhe panairët e studimit organizuar nga MAS [Ev. RVB; Takime në institucion]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Studentët e programit të studimit njihen me strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit nëpërmjet Guidës së Studentit dhe informacioneve në faqen web të institucionit që i korrespondojnë jetës studentore [Ev. <a href="https://cit.edu.al/student">https://cit.edu.al/student</a> ]. Në Guidën e Studentit jepen elementë të tillë si procesi që ndjek studentin nga regjistrimi, kriteret e pranimit, tarifat, bursat dhe pagesat e ndryshme, pezullimi i studimeve, çrregjistrimi nga institucioni, pjesëmarrja në mësim dhe lajmërimi përpara përmbushjes së limit të mungesave, ndjekja e lëndëve sipas viteve akademike, vlerësimi sipas tabelës së miratuar, kur kalon dhe kur ngel në një lëndë të caktuar, të drejtat për t'u ankuar lidhur me notën ose vlerësimin, procedurat që duhet të ndjekë për ankimimin, provimi përfundimtar, progresi akademik si dhe diplomimi [Ev. <b>RVB; Guida e Studentit</b> (<a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020.pdf</a>)].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.</p>	<p>Pranimi në programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile, bëhet për kandidatët që minimalisht zotërojnë një diplomë të nivelit të parë (Bachelor) në fushën përkatëse ose të ngjajshme. Në rastin e kandidatëve të huaj kërkohet paraprakisht ekuivalentimi i diplomës nga strukturat përkatëse të MAS. Për kandidatët të cilët kanë një diplomë universitare të nivelit Master (të fituar brenda ose jashtë vendit) dhe pranohen për të ndjekur këtë program studimi procesi i njohjes dhe vlerësimit të programit të studimit bëhet në nivel Fakulteti, ndërsa procesi i vlerësimit të kurrikulës dhe njohjes së lëndëve bëhet nga Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimit (të Kurrikulës) i Departamentit [Ev. <b>Rregullore e Sekretarise Mesimore cikli i dyte 2021-2022; Takime në Sekretarinë Mësimore</b>]. Nga takimet në institucion, GVJ u informua se për studentët të cilët përfitojnë mobilitete jashtë vendit, nëse ata fitojnë kredite në institucionet pritëse, këto kredite mund t'ju njihen edhe në KU IKT [Ev. <b>Takime në institucion</b>].</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Sipas RVB, në javën e parë të semestrit që është edhe “Javë Orientimi”, studentët informohen prej stafit akademik dhe prej secilit pedagog në lëndën përkatëse, mbi elementët e programit të lëndës, duke përfshirë dhe vlerësimim. Elementë më të detajuar për lëndët që bëjnë pjesë në programin e studimit, jepen nga pedagogët në seancën e parë, duke u bërë të njohur dhe vënë në dispozicion të studentëve të syllabusit të lëndës dhe duke detajuar objektivat e lëndës, temat përkatëse, elementët formues të programit (leksione, ushtrime, detyra kursi, laboratorë et.), mënyrën e shlyerjes si dhe literaturën përkatëse [Ev. RVB; Takime në institucion].</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ u informua se realizimi i temës së diplomës përbën një element shumë të rëndësishëm në procesin e diplomimit në programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile. Në planin mësimor realizimit të temës së diplomës i janë rezervuar 18 kredite ECTS. Për realizimin e Temës së Diplomës studentët bazohen në Manualin e Punimit të Temës së Diplomës dhe në rregulloren “Për Punimin e Diplomës”. Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit u bëhen të njohura studentëve që në Javën e Orientimit. Rregullorja mbi “Punimin e Diplomës” (pjesë e Librit të funksionimit të KU IKT) përcakton se çdo anëtar i personelit akademik, brenda javës së parë të muajit nëntor ofron propozime konkrete për tema diplome, të cilat ai/ajo është i gatshëm t'i mbikëqyrë, duke bërë kështu të mundur krijimin e një grupi me tema dhe në vijim studenti i interesuar plotëson formularin e aplikimit duke u konsultuar paraprakisht me një drejtues të mundshëm duke i hapur rrugë miratimit të temave para mbylljes së semestrit të parë (deri në 30 nëntor) [Ev. Takime në institucion, Manuali i Punimit të Tezes se Diplomes; Libri i Rregulloreve Institucionale].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Referuar RVB dhe takimeve në institucion, GVJ konstatoi se për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit nga institucioni organizohen Javë të Hapura. Këtij qëllimi i shërbejnë dhe panairët e studimit organizuar nga MAS. Zyra e Marketingut dhe ajo e Shërbimit ndaj Studentëve në bashkëpunim me stafin akademik të KU IKT zhvillojnë takime informuese në të gjithë Shqipërinë. Udhëzues të ndryshëm publikohen edhe në faqen web të</p>

	institucionit. [Ev. RVB; Takime në institucion; <a href="https://cit.edu.al/master-in-computer-engineering-it-computer-engineering-and-big-data-2/">https://cit.edu.al/master-in-computer-engineering-it-computer-engineering-and-big-data-2/</a> ].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Ky informacion u transmetohet që në javën e parë të fillimit të procesit mësimor gjatë prezantimit të syllabuseve të lëndëve, detyrimeve përkatëse, mënyrës së shlyerjes së tyre dhe infrastrukturës laboratorike e kompjuterike në dispozicion të tyre [Ev. Takime në institucion]. Informacioni në lidhje me këta elementë shpërndahet edhe përmes sekretarisë mësimore e cila luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve, notat etj [Ev. Takim në Sekretarinë Mësimore].
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ konstatoi se një burim i rëndësishëm informacioni për studentët përveç faqes web të institucionit është dhe sistemi i informacionit UMS (University Management System) i cili ofron një akses të individualizuar në sistem (aksesim i mundësuar nëpërmjet faqes web të institucionit - rubrika <i>My CIT</i> ). Studentët mund të aksesojnë të gjithë informacionin që dëshirojnë rreth programit të studimit, vlerësimit, detyrave, orarit etj nëpërmjet këtij sistemi. Për komunikimin në kuadër të realizimit të procesit mësimor për programin e studimit përdoret edhe platforma Google Meet/Classroom duke mundësuar postimin e materialeve për çdo temë mësimore si

	dhe për të mundësuar komunikimin online. <b>[Ev. Takime në institucion; RVB; <a href="https://ums.cit.edu.al/">https://ums.cit.edu.al/</a> ]</b> .
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<p>Referuar RVB, institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit që vijnë në institucion prej kompanive apo sipërmarrjeve përmes ofertave që ato dërgojnë, duke ua dërguar këto mundësi atyre me email. Përfundim të këtij informacioni, duke hapur mundësinë e realizimit të praktikave profesionale të studentëve, punësimit me kohë të pjesshme si dhe punësimit të tyre mbas diplomimit, i shërbejnë dhe marrëveshjet me komunitetin e biznesit dhe shoqëritë private. Në periudhën 2016-2021, në programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni", për të tre profilet, janë diplomuar gjithsejt 62 studentë, nga të cilët 16 janë punësuar në përputhje me diplomën dhe 27 jo në përputhje me diplomën (për të 19 të tjerët nuk ka informacion).</p> <p><i>GVJ është i mendimit se numri i të punësuarve në përputhje me diplomën është relativisht i ulët, ndaj nevojitet ndërmarrja e hapave konkretë e të individualizuar në drejtim të punësimit të të diplomuarve në përputhje me formimin e tyre.</i></p> <p><b>[Ev. RVB- Aneksi 1: Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23); Marreveshjeve me biznesin, sipërmarrjet dhe institucione të tjera 2016 - 2022; Takime në institucion].</b></p>
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Elementë të tjerë si orari i mësimave, struktura e vitit akademik, formularë të ndryshëm, modele të testimeve/provimeve që përdoren në institucion, aplikime për bursë, periodikun CIT E-Newsletter, manualin e mobilitetit të studentëve etj, mund të aksesohen nëpërmjet faqes web të institucionit (<a href="https://cit.edu.al/student#resources">https://cit.edu.al/student#resources</a>). Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan dhe Sekretaria Mësimore <b>[Ev. RVB; Takime në institucion; <a href="https://cit.edu.al/">https://cit.edu.al/</a> ]</b>.</p>
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të	GVJ u informua se studentët mund të aksesojnë të gjithë informacionin që dëshirojnë rreth programit të studimit, vlerësimit, detyrave, orarit etj nëpërmjet sistemit UMS



menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	(University Management System) i cili ofron një akses të individualizuar në sistem (aksesim i mundësuar nëpërmjet faqes web të institucionit - rubrika <i>My CIT</i> ). [Ev. Takime në institucion; RVB; <a href="https://ums.cit.edu.al/">https://ums.cit.edu.al/</a> ].			
<b>Kriteri 6.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	Sistemi i informacionit i KU IKT (UMS) synon të kontribuojnë në menaxhimin e institucionit. Ky sistem është në përmirësim të vazhdueshëm dhe GVJ është i mendimit se akoma nuk e ka arritur fazën e një sistemi informacioni tërësor për të menaxhuar plotësisht gjithë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve. Në këtë kuadër, një pjesë e mirë e informacionit shpërndahehet dhe i mundësohet aksesimi në distancë nëpërmjet platformës Google for Education (Google Drive, Google Classroom) [Ev. RVB; Takime në institucion].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Një nga strukturat më të rëndësishme për mbajtjen e statistikave është Sekretaria mësimore e KU IKT e cila funksionon mbi bazën e detyrave të përcaktuara në Rregulloren përkatëse [Ev. 12. <b>Rregullore e Sekretarise Mësimore cikli i dytë 2021-2022</b> ]. Në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me mbajtjen në format letër të Rregjistrimit themeltar, Rregjistrimit të arritjeve akademike, Rregjistrimit të kursit dhe Rregjistrimit të diplomave si dhe me dokumentacionin e dorëzuar nga studenti në momentin e regjistrimit/transferimit. Për periudhën 2016-2021 janë diplomuar gjithsejt 62 studentë (për të tre profilet) [Ev. <b>Aneks 1: Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23)</b> ; Takimi në Sekretarinë mësimore].

**Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.

Statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve mbahen nga Sekretaria Mësimore. Të dhënat ruhen në rregjistra përkatës dhe në formë elektronike. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me dokumentacionin që ka të bëjë me studentët e pranuar në programin e studimit. Rregjistrimet, përfshirë transferimet, për tre vitet e fundit paraqiten si vijon:

Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike, profili: <i>Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike</i>			
Viti akademik	2019-2020	2020-2021	2021-2022
Studentë	25	28	19

Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike, profili: <i>Big Data</i>			
Viti akademik	2019-2020	2020-2021	2021-2022
Studentë	26	18	6

Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike, profili: <i>Multimedia Dizajn</i>			
Viti akademik	2019-2020	2020-2021	2021-2022
Studentë	12	5	5

[Ev. RVB – Aneksi 1: Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 21), Takimi në Sekretarinë mësimore].

**Kriteri 3.** Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.

Sekretaria mësimore disponon gjithë informacionin për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Këto të dhëna disponohen në format letër (në rregjistrat përkatës) si dhe në Sistemin e Menaxhimi të Institucionit (UMS), ku stafi akademik hedh të dhënat dhe ndjek ecurinë e studentëve përgjatë vitit akademik, po ashtu edhe vetë studentët mund të ndjekin ecurinë e tyre, si dhe të

	informohen për mungesat, vlerësimet, etj përmes sistemit [Ev. RVB, Takimi në Sekretarinë mësimore].																																				
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Për menaxhimin e informatizuar të informacionit në KU IKT është zhvilluar një sistem i emërtuar UMS (University Management System), i cili është i bazuar në një platformë online, i aksesueshëm nga të gjithë studentët, stafi administrativ (sekretaritë) dhe ai akademik i KU IKT, nëpërmjet një Username-i dhe Fjalëkalimi të mundësuar nga departamenti i IT [Ev. RVB; Vizita në institucion; <a href="https://ums.cit.edu.al/">https://ums.cit.edu.al/</a> ].																																				
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	<p>GVJ u informua se në përfundim të vitit akademik përgatiten raporte lidhur me cilësinë në hyrje të studentëve dhe atë në dalje, si dhe punësimin e tyre në profil apo jashtë profilit. Këto raporte i vihen në dizpozicion edhe njësisive të tjera si NJSBC, Komiteteve të Kurrikulave, Njësisive të Kërkimit Shkencor CIRD, të cilat më pas i analizojnë dhe konkludojnë duke dhënë sugjerimet përkatëse.</p> <p>Të dhënat për cilësinë në hyrje paraqiten si vijon:</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <tr> <td colspan="4" style="text-align: center;">Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike, profili: <i>Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike</i></td> </tr> <tr> <td>Viti akademik</td> <td>2019-2020</td> <td>2020-2021</td> <td>2021-2022</td> </tr> <tr> <td>Nota mesatare në hyrje</td> <td style="text-align: center;">7.32</td> <td style="text-align: center;">6.85</td> <td style="text-align: center;">5.93</td> </tr> </table> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <tr> <td colspan="4" style="text-align: center;">Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike, profili: <i>Big Data</i></td> </tr> <tr> <td>Viti akademik</td> <td>2019-2020</td> <td>2020-2021</td> <td>2021-2022</td> </tr> <tr> <td>Nota mesatare në hyrje</td> <td style="text-align: center;">7.26</td> <td style="text-align: center;">7.99</td> <td style="text-align: center;">6.14</td> </tr> </table> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <tr> <td colspan="4" style="text-align: center;">Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike, profili: <i>Multimedia Dizajn</i></td> </tr> <tr> <td>Viti akademik</td> <td>2019-2020</td> <td>2020-2021</td> <td>2021-2022</td> </tr> <tr> <td>Nota mesatare në hyrje</td> <td style="text-align: center;">5.5</td> <td style="text-align: center;">6.58</td> <td style="text-align: center;">6.25</td> </tr> </table> <p>[Ev. RVB - Aneks 1: Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 21)]</p>	Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike, profili: <i>Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike</i>				Viti akademik	2019-2020	2020-2021	2021-2022	Nota mesatare në hyrje	7.32	6.85	5.93	Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike, profili: <i>Big Data</i>				Viti akademik	2019-2020	2020-2021	2021-2022	Nota mesatare në hyrje	7.26	7.99	6.14	Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike, profili: <i>Multimedia Dizajn</i>				Viti akademik	2019-2020	2020-2021	2021-2022	Nota mesatare në hyrje	5.5	6.58	6.25
Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike, profili: <i>Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike</i>																																					
Viti akademik	2019-2020	2020-2021	2021-2022																																		
Nota mesatare në hyrje	7.32	6.85	5.93																																		
Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike, profili: <i>Big Data</i>																																					
Viti akademik	2019-2020	2020-2021	2021-2022																																		
Nota mesatare në hyrje	7.26	7.99	6.14																																		
Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike, profili: <i>Multimedia Dizajn</i>																																					
Viti akademik	2019-2020	2020-2021	2021-2022																																		
Nota mesatare në hyrje	5.5	6.58	6.25																																		

Të dhënat në lidhje me punësimin e tyre për periudhën 2016-2021 janë:

Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike, profili: <i>Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike</i>			
Numri total i të diplomuarve	Numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën	Numri total i të punësuarve në jo përputhje me diplomën	Të papërcaktuar
33	10	13	10

Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike, profili: <i>Big Data</i>			
Numri total i të diplomuarve	Numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën	Numri total i të punësuarve në jo përputhje me diplomën	Të papërcaktuar
27	6	12	9

Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike, profili: <i>Multimedia Dizajn</i>			
Numri total i të diplomuarve	Numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën	Numri total i të punësuarve në jo përputhje me diplomën	Të papërcaktuar
2	0	2	0

**[Ev. RVB - Aneks 1: Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23); Takime në institucion]**

*GVJ është i mendimit se, në mënyrë të veçantë për profilin Multimedia Dizajn, duke qenë se në 5 vitet e fundit janë diplomuar vetëm 2 studentë (dhe asnjë prej tyre nuk është punësuar në përputhje me diplomën), nga ana e DIS nevojitet një analizë e detajuar e shkaqeve si dhe dhënia e zgjidhjeve të përshtatshme për të garantuar vazhdimësinë e këtij profili.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p><i>Neni 99 i Statutit të KU IKT</i>, përcakton funksionimin në institucion të Qeverisë Studentore (Këshillit Studentor) si organizim i pavaruar i studentëve. Qeveritë studentore shprehin mendime dhe bëjnë propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” dhe të fakultetit përkatës, siç janë ato për planet dhe programet e studimeve; për hapjen e programeve të reja; për rregulloret e veprimtarisë mësimore; për cilësinë e shërbimeve; për nivelin e tarifave të shkollimit; për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj [Ev. <b>Statuti i KU IKT 2016</b>]. Veç kësaj me amendimin e Statutit, që prej vitit 2019, në anëtarët e Senatit Akademik përfshihen dhe tre studentë, respektivisht Kryetari i Këshillit Studentor, një përfaqësues nga Fakulteti i Ekonomisë dhe një përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë, duke mundësuar në këtë mënyrë transmetimin e zërit të studentëve në këtë organ drejtues si dhe pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje. Gjithashtu GVJ u informua se studentët përfaqësohen edhe në Këshillat e Fakulteteve, Këshillin e Etikës, Komitetin e Bursave, NJSBC etj. [Ev. <b>RVB; Statuti i KU IKT 2019 i amenduar</b>].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me</p>	<p>KU IKT garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje duke mundësuar përfaqësimin e tyre në Senat, NJSBC, Këshillat e Fakulteteve, Këshillin e Etikës si dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm e përgatitjen e RVB. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me kontributin e studentit pjesë e GVB në përgatitjen e RVB, duke certifikuar elementët e pasqyruar në raport, sidomos ata elementë që kishin të bënin me mobilitetin e studentëve, praktikën profesionale, diplomimin dhe punësimin e tyre. Përveç pjesëmarrjes në organet e</p>

<p>rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>sipërcituar, studentët marrin pjesë dhe në vlerësimin e procesit akademik nëpërmjet pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së lëndëve të programit të studimit, i cili plotësohet në fund të çdo semestri. GVJ u informua mbi publikimin në mënyrë periodike nga ana e NJSBC të raporteve të analizës së pyetsorëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke i vënë kështu në dispozicion si të personelit akademik ashtu edhe të studentëve apo dhe gjithë instancave të tjera të interesuara. [Ev. RVB; Takime në institucion; Model Pyetesori Master CE (Computer Engineering &amp; IT)].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Hartimi i programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" është bërë në përputhje me VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë" dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" duke marrë në konsideratë që ngarkesa javore në auditor të mos kalojë 25 orë (aktualisht është 20 orë/javë) [Ev. Planet mesimore 2021 - 2022, 2020 - 2021, 2019-2020]. GVJ konstatoi se elementë të njohjes së studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme janë marrë në konsideratë në rregulloret përkatëse [Ev. Rregullore e Sekretarise Mesimore cikli i dyte 2021-2022]. Procesi i vlerësimit të kurrikulës dhe njohjes së lëndëve bëhet nga Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimit (të Kurrikulës) i Fakultetit [Ev. RVB; Rregullore e Sekretarise Mesimore cikli i dyte 2021-2022].</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Tërheqja e mendimit të studentëve për programin e studimit realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në organet vendimmarrëse të KU IKT. Gjithashtu, nëpërmjet pyetsorëve të studentëve tërhiqet, ndërmjet të tjerash, mendimi për elementë që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit të studimit. Në mënyrë të veçantë përpunimi i të dhënave të pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së lëndëve për çdo program studimi, i cili plotësohet në fund të çdo semestri, shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme. Referuar RVB, DIS organizon takime me stafin e angazhuar në programin e studimit në të cilat diskutohen çështje që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit, literaturës, aspekte teknike të</p>

	<p>mësimdhënies, rritjen e cilësisë së organizimit të orës së mësimi, kërkimin shkencor dhe angazhimin e studentëve në projekte detyra kursi për të përthithur sa më mirë aftësitë dhe kompetencat që duhet të marrin nga secila lëndë [Ev. RVB; Model Pyetesori Master CE (Computer Engineering &amp; IT)]. Megjithatë, referuar dokumentacionit të paraqitur, GVJ konstaton se nuk ka patur përmirësime në kurrikulën e programit të studimit në tre vitet e fundit, por vetëm në syllabuset e lëndëve [Ev. Takime në institucion; RVB].</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezulttit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Përsa i përket procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, zbatohen procedurat e përcaktuara në rregulloret përkatëse. Këto procedura synojnë të garantohet barazia dhe ndershmëria e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Studentëve u njihet e drejta e ankimimit. Në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore përcaktohet se brenda dy javëve nga zhvillimi i provimit, në orarin e caktuar për tutoriat dhe/ose këshillim akademik, pedagogu pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin. Nëse studenti nuk e pranon vlerësimin e kryer, mund të paraqesë me shkrim ankimimin e tij pranë Përgjegjësit të Departamentit ku të parashtrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Përgjegjësi i Departamentit ndjek procedurën e përcaktuar në rregullore për trajtimin e ankimimeve duke garantuar transparencë dhe barazi [Ev. Rregullore e Sekretarisë Mesimore cikli i dyte 2021-2022]. Nga takimet me studentët GVJ u informua se nuk ka patur problematika të evidentuara në lidhje me procesin e vlerësimit të tyre nga ana e pedagogëve.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>

<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Referuar RVB, prej vitit 2016 e deri më sot, prej institucionit, janë organizuar 13 konferenca, nga të cilat 10 janë organizuar prej Fakultetit të Inxhinierisë. Gjithashtu janë organizuar edhe një numër i madh aktivitete në formë të seminareve të hapura apo simpoziumeve shkencore. Të ftuar në këto aktivitete kanë qenë pjesëmarrës nga vende të ndryshme të botës dhe nga universitete të mirënjohura në rajon dhe më gjerë [Ev. RVB; <a href="https://cit.edu.al/research-2/">https://cit.edu.al/research-2/</a> ]. Lista e projekteve në të cilat është i angazhuar institucioni ku marrin pjesë jo vetëm personeli akademik me statusin e punonjësit kërkimor, por edhe studentët e ciklit Master, dëshmon për një institucion dhe në veçanti për një program studimi me lidhje të ngushta me kërkimin shkencor. Këto lidhje kontribuojnë në zhvillimin e aftësive të kërkuesit dhe të përshtatjes me teknologjitë e reja [Ev. Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS; Takime në institucion; Permbledhje e kerkimi shkencor ne 5 vitet e fundit Fakulteti Inxhinierise].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të DVV, GVJ konstatoi se KU IKT ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione homologe jashtë vendit [Ev. <b>Marreveshjet ne kuader te Erasmus+ 2016-2022; Marreveshjet me universitetet 2016 - 2022</b>]. Këta elementë konfirmohen edhe nga takimet në institucion. Marrëveshjet me institucione homologe jashtë vendit i kanë shërbyer kryesisht mobilitetit si të personelit akademik ashtu edhe të studentëve, por edhe realizimit të konferencave të përbashkëta shkencore si për stafin akademik ashtu dhe për studentët si dhe aplikimit në projekte të përbashkëta. [Ev. <b>Takime në institucion</b>].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>Publikimi i rezultateve të kërkimit shkencor, studimeve e punimeve shkencore të personelit akademik dhe studentëve mbështetet fuqimisht nga institucioni duke ofruar mundësinë e publikimit në revistën Shkencore CIT Review, organizimin e konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe publikimin e materialeve në Proceedings apo revistën shkencore, mbështetjen e studentëve dhe stafit akademik për pjesëmarrje me punimet e tyre në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe organizimin e konferencave studentore. Referuar RVB, në tre vitet e fundit, në total janë 19 studentë të cilët kanë publikuar punimet e tyre shkencore në CIT Review. Veç kësaj janë organizuar edhe disa</p>





	konferenca, akademi, seminare dhe kompeticione me pjesëmarrje të gjerë të studentëve [Ev. RVB; Takime në institucion; Permbledhje e kerkimi shkencor ne 5 vitet e fundit Fakulteti Inxhinierise].
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	Pavarësisht se në RVB evidentohet se institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore e shkencore të personelit akademik të institucionit, në aspektin praktik i është kushtuar më tepër vëmendje publikimit në revistën e institucionit CIT Review dhe është synuar që kjo revistë të përftojë indeksime ndërkombëtare si dhe të përfshihet në citimet me faktor impakti. Megjithatë, referuar CV të personelit akademik, konstatohet se ka publikime në revista shkencore ndërkombëtare dhe referime në kongrese apo konferenca ndërkombëtare [Ev. CV e stafit akademik te programit te studimit].
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	Për të mundësuar nxitjen dhe motivimin e studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" për t'u angazhuar në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore, një rol të veçantë kanë punimet e diplomave, të cilat kontribuojnë për iniciimin e studentëve në kërkimin shkencor duke u bërë pjesë e punës kërkimore të personelit akademik. Veç kësaj, GVJ konstatoi se, institucioni ka investuar në krijimin e kushteve për mbështetjen e ideve dhe përpjekjeve studentore nëpërmjet iniciimit së fundmi të qendrave CIT HUB (qendër krijuese për promovimin e inovacionit dhe sipërmarrjes) dhe BigMath (me objektiv krijimin e një komuniteti aktiv studentësh dhe pedagogësh të interesuar për analizën dhe kërkimin në fushën e Big Data, duke zgjeruar njohuritë e tyre në fushat e matematikës, statistikës, informatikës, fizikës, etj).[Ev. Takime në Institucion; <a href="https://cit.edu.al/cit-hub-and-bigmath-presentation/">https://cit.edu.al/cit-hub-and-bigmath-presentation/</a> ].
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	GVJ u informua se realizimi i temës së diplomës përbën një element shumë të rëndësishëm në procesin e formimit për disiplinën përkatëse dhe se punimet e diplomave të realizuara në kuadër të programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile, përmbajnë elementë të kërkimit shkencor pasqyruar edhe në aktivitetet kërkimore të organizuara me studentët [Ev. Takime në institucion, Manuali i Punimit të Tezes se Diplomes]. GVJ u informua se baza laboratorike kompjuterike

	e institucionit është në dispozicion të studentëve diplomantë. Udhëheqësi i diplomës bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me studentin për elementë të tillë si përcaktimi i strukturës së punimit dhe objektivave, përgatitja e planit të punës me afatet përkatëse, përzgjedhja e literaturës, hartimi i grafikut e konsultimeve të programuara, përcaktimin e infrastrukturës së nevojshme laboratorike apo matjeve që duhen kryer, si dhe ofron asistencën e nevojshme për testimet e softuerit, përpunimin e rezultateve etj. Studentët diplomantë, duke qenë se në masën më të madhe janë të punësuar, mund të shfrytëzojnë edhe infrastrukturën përkatëse apo të dhëna nga biznesit apo institucioni ku janë punësuar për të realizuar punimin e diplomës [Ev. Takime në institucion].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përkrahje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi V.7</b>	
<b>Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	GVJ konstatoi se KU IKT ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione homologe [Ev. Marreveshjet me universitetet 2016 - 2022]. Marrëveshjet me institucione homologe brenda vendit i kanë shërbyer zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta. Përsa u përket mobiliteteve, për të kontribuar në ndërkombëtarizimin e institucionit dhe mbështetur nga fakti që mësimdhënia në KU IKT është në gjuhën angleze, ato janë zhvilluar në universitete homologe jashtë vendit duke integruar edhe elementë të që lidhen me zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta [Ev. Takime në institucion; Marreveshjet ne kuader te Erasmus+ 2016-2022].
<b>Kriteri 2.</b> Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri	Punimet e diplomave të realizuara në kuadër të programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" përmbajnë elementë të kërkimit shkencor pasqyruar edhe në aktivitetet kërkimore të organizuara me studentët. GVJ, gjatë vizitës në institucion, u njoh me raste

dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	të rekrutimit të personelit akademik i cili ka përfunduar studimet në KU IKT. Për këtë kategori personeli paraqitet si domosdoshmëri vazhdimi i studimeve të ciklit të tretë doktoratë <b>[Ev. Takime në institucion; CV e stafit akademik te Fakultetit te Inxhinierise].</b>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.	Nga takimet në institucion me drejtues të tij dhe me personelin akademik të programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni", GVJ u informua për mbështetjen e dhënë studjuesve të rinj. Kjo mbështetje ka konsistuar si në pjesëmarrjen në përgatitjen e projekteve kërkimore, ashtu edhe në reduktimin e ngarkesës mësimore në se ka angazhime në projekte. Për të mundësuar aplikimin në projekte dhe rritjen e shkallës së fitimit të tyre, janë organizuar edhe trajnime në fushën e menaxhimit të projekteve. Referuar RVB, institucioni ka përgatitur në total 22 projekte, ka fituar 4 prej tyre ndërsa 3 janë ende në pritje të vlerësimit përfundimtar, ndërkohë që për vitin aktual akademik po aplikon edhe për 5 projekte të tjera.  <b>[Ev. RVB – Aneksi 2- Tabela nr. 10: Projekte të fituara, Tabela nr. 12: Projekte të punuara por jo të fituara prej IKT dhe Tabela 12/1: Projekte të cilat janë duke u përgatitur për aplikim nga IKT; Takime në institucion].</b>
<b>Kriteri 4.</b> Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	GVJ konstatoi se, favorizuar dhe nga fakti që gjithë procesi mësimor në institucion zhvillohet në gjuhën angleze, ka ndjekur një politikë integruese për staf akademik të huaj me përvojë në institucione të njohura jashtë vendit. Në këtë mënyrë, referuar RVB, në institucion aktualisht ka një staf të huaj akademik i cili vjen prej disa shtetesh, si Maqedonia e Veriut, Turqia, Greqia, Kosova, Jemeni, Kanadaja, Britania, Spanja, Kroacia <b>[Ev. RVB; Takime në institucion].</b> GVJ, gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore, u informua se në procesin e rekrutimit të personelit akademik u jepet prioritet rekrutimit të personelit akademik nga vendet e OECD <b>[Ev. Takim në Zyrën e Burimeve Njerëzore].</b>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	Mobiliteti i studentëve në kuadër të programeve Erasmus+ dhe CEPUS ka synuar jo vetëm ndjekjen e cikleve të leksioneve apo moduleve të lëndëve, por edhe angazhimin në kuadër të kryerjes së stazheve duke rritur më tej rezultatet e të nxënit dhe zhvillimin e aftësive personale. Politika e institucionit është që

	<p>studentët të mund të studiojnë jashtë vendit në një institucion partner të arsimit të lartë ose të kryejnë një praktikë profesionale në një sipërmarrje, një institut kërkimi, laborator, një organizatë ose në ndonjë vend tjetër pune.</p> <p>[Ev. <b>RVB</b>; <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Staf-Students-Mobility-Manual.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Staf-Students-Mobility-Manual.pdf</a> ]</p>								
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>KU IKT është i angazhuar në bashkëpunimin reciprok me institucione të tjera të arsimit të lartë jashtë vendit të cilat kanë ofruar mbështetje në disa fusha të rëndësishme, si bashkëpunimi në kërkimin shkencor dhe organizimin e konferencave të përbashkëta, mobilitetet të stafit dhe studentëve, aplikim për projekte të përbashkëta, organizimin e konferencave studentore etj. GVJ u informua se, për cikle të caktuar leksionesh, ka patur edhe personel akademik të ftuar nga jashtë vendit (nga Kanada, Turqi, Greqi) si dhe ligjërta të mbajtura me të ftuar nga industria dhe institucione publike (Lufthansa, Telekom etj). Referuar RVB, personeli i huaj i ardhur në institucion ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për eksperiencën që kanë ndarë si dhe për shkëmbimin e informacionit me stafin dhe studentët [Ev. <b>RVB</b>; <b>Takime në institucion; Marreveshjet ne kuader te Erasmus+ 2016-2022</b>].</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

<p><b>Standardi V.8</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet</p>	<p>Në institucion funksionojnë struktura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët dhe Garantimin e të Drejtave Studentore;</li> <li>- Sekretaria Mësimore;</li> <li>- Zyra për Shërbimet ndaj Studentëve;</li> </ul>

<p>ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>- Tutoriati akademik. [Ev. 7. Libri i Rregulloreve Institucionale]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Për të mundësuar informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, përveç Sekretarisë Mësimore e cila disponon dhe vë në dispozicion të studentëve gjithë informacionin në lidhje me regjistrimin dhe avancimin akademik të tyre, një rol të veçantë luan tutorati akademik i studentëve i konkretizuar nëpërmjet Këshilluesit Akademik (një për çdo vit akademik). Këshilluesi Akademik jep ndihmesë lidhur me ndjekjen e ecures së studentëve në institucion si dhe për të parë e trajtuar problematikat që ata kanë. Veç kësaj, departamenti në bashkëpunim me Zyrën për Shërbimet ndaj Studentëve, këshillon dhe orienton studentët lidhur me përzgjedhjen e institucionit për zhvillimin e praktikës profesionale si dhe përzgjedhjen e temave të diplomave [Ev. 7. Libri i Rregulloreve Institucionale (anglisht), “Tutoriati dhe Këshillimi Akademik”, fq. 57-58; Takime në institucion].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra për Shërbimet ndaj Studentëve në KU IKT u ofron studentëve një numër shërbimesh si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndjekje dhe organizim i çështjeve të karrierës së studentëve;</li> <li>- Ofron këshillim dhe udhëzime në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve;</li> <li>- Bashkëpunon ngushtë me departamentet e fakulteteve për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave profesionale të studentëve;</li> <li>- Bashkëpunon ngushtë me Zyrën e Pranimeve për informimin e studentëve mbi programet që ofron KU IKT dhe orienton ata në programet që i përshtaten gjatë periudhave të regjistrimit;</li> <li>- Ndjek ecurinë e realizimit të praktikave profesionale të studentëve.</li> </ul> <p>GJVJ, u informua mbi bashkëpunimin e kësaj zyre me shoqatat studentore, organizimin e një sërë aktiviteteve si dhe bashkëpunimin e kësaj zyre me struktura të tjera të institucionit.</p> <p>[Ev. Manuali i Këshillimit të Karrierës; RVB; Takime në institucion]</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Në raport me punësimin e të diplomuarve dhe ndjekjen e vazhdueshme të tyre pas punësimit, Zyra për Shërbimet ndaj Studentëve në KU IKT mundëson:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbjajtjen e të dhënave për punësimin e të diplomuarve;</li> <li>- Ndjekjen e punësimit të të diplomuarve;</li> <li>- Është përgjegjëse për organizimin e panairëve të punës;</li> <li>- Mbjajtjen e marrëdhënieve të vazhdueshme me shoqatat apo organizime të tjera të ALUMNI dhe i mbështjen e funksionimit të tyre.</li> </ul> <p>Referuar RVB, deri më sot kjo zyrë ka ndjekur ecurinë e mbi 600 studentëve të diplomuar për të cilët janë mbledhur të dhëna rreth punësimit të tyre, punësimit në profil ose jo, në cilat kompani janë duke punuar si dhe kontakte email ose telefon të tyre.</p> <p><b>[Ev. Manuali i Keshillimit të Karrierës; RVB]</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	--

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

<p><b>Standardi VI.1</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënljigore në fuqi dhe</p>	<p>Në institucion, që prej vitit 2013, zhvillon aktivitetin Njësia për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë (NJSBC), miratuar me Vendim Nr. 16, datë 22. 05. 2013 të Senatit Akademik. Aktiviteti i kësaj njësie bazohet në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e</p>

<p>me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Cilësisë të Arsimit të Lartë, Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit, Statutin e KU IKT dhe Manualin e Sigurimit të cilësisë të KU IKT. NJSBC është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion.</p> <p><b>[Ev. RVB; Manuali i Sigurimit te Cilesise - QAU Handbook]</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>NJSBC është organ kolegjal dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët dy janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore (një për secilën njësi), një personel i administratës, një përfaqësues i studentëve; dhe një ekspert i jashtëm që drejton njësinë. Anëtarët e NJSBC miratohen nga Senati Akademik me propozim të Rektorit, me mandat 4 vjeçar. Referuar RVB, ndër politikat dhe rregulloret që standardizojnë funksionimin dhe detyrat apo angazhimin e NJSBC mund të përmenden, Organizimi i Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve dhe Politikat dhe procedurat e vetëvlerësimit. Dokumenti kryesor që rregullon punën e NJSBC është Manuali i Sigurimit të cilësisë të KU IKT, i cili është përgatitur në përputhje me standartet e cilësisë, azhurnohet në mënyrë periodike dhe shërben si udhërrëfyes për problemet e cilësisë në KU IKT <b>[Ev. RVB; Manuali i Sigurimit te Cilesise - QAU Handbook]</b>.</p> <p>NJSBC për vjeljen e informacionit mbi ecurinë e programit dhe performancën e personelit etj. përdor një numër vlerësimesh si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies ;</li> <li>- Vlerësimi nga studentët për institucionin;</li> <li>- Vlerësimi i studentëve për programin;</li> <li>- Vlerësimi i stafit për institucionin;</li> <li>- Vlerësimi i Rektoratit për strukturat menaxhuese;</li> <li>- Vlerësimi i stafit nga instancat drejtuese (Dekan/Zv.Dekan);</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e</p>	<p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë garantohej nga vetë institucioni dhe menaxhohet nga NJSBC. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në nivel institucioni dhe programesh studimi organizohet në mënyrë periodike nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në</p>

<p>lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Arsimin e Lartë (ASCAL). KU IKT i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 116, datë 15.12.2017, me kohëzgjatje 5 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 14.12.2022, ndërsa programi i studimit i KU IKT, Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn" është akredituar për herë të parë me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 75 datë 4.10.2019, për një periudhë 3 vjeçare, akreditim i cili është i vlefshëm deri në datën 30.09.2022 [Ev. RVB; Akreditimi i pare i programit MSc ne Inxh Kompj dhe IT me tre profile].</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV, GVJ u informua se sigurimi, monitorimi dhe përmirësimi i cilësisë në programet e studimit të KU IKT realizohet sipas një procesi të mirëpërcaktuar bazuar në "Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit", pjesë e Librit të Rregulloreve Institucionale. Sipas RVB, kjo rregullore përcakton kornizën bazë për vlerësimin e cilësisë dhe realizueshmërisë së të gjitha programeve, si dhe për monitorimin dhe rishikimin sistematik të tyre. Ndër elementët që monitorohen me qëllim përmirësimin e cilësisë së programit të studimit janë ata që lidhen me cilësinë e mësimdhënies, përmbajtjen e programit të studimit si dhe përmbajtjen e programeve të lëndëve të programit (syllabuset). Kjo realizohet, në një masë të madhe, bazuar në pyetsorët që plotësohen në fund të çdo semestri e që i kushtohen vlerësimit të programit të studimit dhe personelit akademik [Ev. Model Pyetesori Master CE (Computer Engineering &amp; IT)]. Pyetësorët përpunohen nga NJSBC dhe rezultatet e tyre u vihen në dispozicion instancave drejtuese (Përgjegjës Departamenti, Dekan, etj.). GVJ u informua mbi publikimin në mënyrë periodike nga ana e NJSBC të raporteve të analizës së pyetsorëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke i vënë kështu në dispozicion si të personelit akademik ashtu edhe të studentëve apo dhe gjithë instancave të tjera të interesuara. Përpunimi i të dhënave të pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së lëndëve të programit të studimit dhe njohja me to e personelit akademik, studentëve etj, shërben jo vetëm si bazë për përmirësime të mëtejshme, por njëkohësisht kontribuon në krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive</p>



	përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit [Ev. RVB, Takime në institucion; Libri i Rregulloreve Institucionale].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

### Standardi VI.2


**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Monitorimi, shqyrtimi, mbikëqyrja, rishikimi i programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" mundësohet kryesisht nëpërmjet tre stukturave:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Komisioni i Përhershëm i Kurrikulave dhe Programeve Mësimore;</li> <li>- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</li> <li>- Departamenti i Inxhinierisë Softuerike.</li> </ul> <p>Komisioni i Përhershëm i Kurrikulave dhe Programeve Mësimore kryen vlerësimin e programeve të studimit të ofruara nga Fakulteti i Inxhinierisë duke analizuar përputhshmërinë me objektivat dhe strategjinë e zhvillimit, etj, shqyrton përputhshmërinë me aktet ligjore e nënligjore në fuqi (për të pasqyruar ndryshimet përkatëse), përputhjen e standartet e cilësisë si dhe me praktikatat më të mira ndërkombëtare që i korrespondojnë modeleve të zgjedhur nga KU IKT. NJSBC, nga ana e saj, organizon gjithë punën, nga njera anë për tërheqjen e mendimit të studentëve dhe personelit akademik nëpërmjet pyetsorëve të ndryshëm dhe nga ana tjetër duke përçarur këtë informacion të përpunuar tek gjithë të interesuarit për përmirësimin e cilësisë në institucion. Të dy këto struktura bashkëpunojnë ngushtë me Departamentin e Inxhinierisë Softuerike si njësia përgjegjëse për programin e studimit, ku do të jetësohen elementët që lidhen me përmirësimin e cilësisë mbi bazën e rekomandimeve përkatëse. [Ev. 7. Libri i Rregulloreve</p>

	<b>Institucionale (anglisht) (Kreu II, fq. 33-35); Takime në institucion].</b>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	Mbikëqyrja e herëpashershme e programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" bazohet në vjeljen e informacionit nëpërmjet pyetsorëve që plotësohen në fund të çdo semestri e që i kushtohen vlerësimit të programit të studimit dhe personelit akademik [Ev. Model Pyetesori Master CE (Computer Engineering & IT)]. Gjithashtu vlerësimi i programeve të studimit të ofruara nga Fakulteti i Inxhinierisë është kryer edhe nga Komisioni i Përhershëm i Kurrikulave dhe Programeve Mësimore duke analizuar përputhshmërinë me objektivat dhe strategjinë e zhvillimit, treguesit e matshëm, zhvillimin e programeve të studimit dhe vlerësimin, analizuar të dhëna për studentët pas diplomimit, të dhëna për zhvillimin e teknologjisë në vend lidhur me programet e studimit si dhe duke formuluar gjetje dhe rekomandime [Ev. Vlerësimi i Programit të Studimit, Tregu i Punës dhe të dhëna për studentet pas diplomimit 2019-2021].
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	Një element tjetër i konsideruar, ka të bëjë me përshtatjen e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës. Referuar DVV, DIS ka kryer edhe vlerësime periodike të programeve të studimit (i fundit në shtator 2021) për të parë ecurinë e tyre si dhe përputhjen me nevojat e tregut [Ev. Vlerësimi i Programit të Studimit, Tregu i Punës dhe të dhëna për studentet pas diplomimit 2019-2021; Evidenca të organizimit të tryezave të rrumbullakta me kompanite, bizneset]. Vlerësimi i ecurisë së programit të studimit mbështetet edhe në pyetsorët e plotësuar nga studentët e programit lidhur me komponentë që kanë të bëjnë me mësimdhënien; programin e lëndës; metodologjinë e përdorur gjatë mësimdhënies, korrektësinë, etikën e pedagogut, zhvillimin e orëve të mësimit sipas planit mësimor, përdorimin e literaturës; angazhimin e studentëve etj. [Ev. Takime në institucion]
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Rezultatet e përfuara nga përpunimi i pyetsorëve u vihen në dispozicion instancave drejtuese (Përgjegjës Departamenti, Dekan, etj). GVJ u informua mbi publikimin në mënyrë periodike nga ana e NJSBC të raporteve të analizës së pyetsorëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke i vënë kështu në dispozicion si të personelit akademik ashtu edhe

	<p>të studentëve apo dhe gjithë instancave të tjera të interesuara me qëllim përmirësimin e cilësisë [Ev. <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Questionnaires-report.pdf</a> <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Permbledhje-e-pvetsorit-2020-2021-1.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Permbledhje-e-pvetsorit-2020-2021-1.pdf</a> <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Survev.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Survev.pdf</a> ].</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Nga studimi i DVV dhe takimet në institucion dhe GVJ konstatoi se që nga akreditimi i mëparshëm nuk ka patur ndryshime në planin mësimor të programit të studimit. Ndryshimet dhe përmirësimet kanë konsistuar kryesisht në rishikimin e syllabuseve të lëndëve, ku janë pasqyruar elementë që lidhen me zhvillimet dinamike në këtë fushë [Ev. <b>Takim me përfaqësues të Zyrës së Kurrikulave</b> ]. Referuar RVB dhe takimeve në institucion, një formë e vlerësimit sidomos për stafin akademik është edhe vlerësimi i tij prej strukturave përgjegjëse e drejtuese në fund të çdo vitit akademik. Njësitë kryesore pasi marrin në dorëzim raportet, i analizojnë konkluzionet me stafet e tyre akademike, ku ftohen dhe përfaqësues të NJSBC për të dhënë komentet përkatëse, dhe ndërmarrin veprime me hapa konkretë për përmirësimin e situatës. Sipas RVB, në formatin e vetëvlerësimit të stafit akademik, strukturat menaxhuese kur e shohin të arsyeshme kanë mundësi të bëjnë komente dhe sugjerime për secilin pjestar të stafit. GVJ u informua se mbi bazën e vlerësimeve të përsëritura negative, ka patur raste të mosrinovimit të kontratës për personelin akademik [Ev. <b>Takim me NJSBC</b>]. Në disa raste, për të adresuar problematikat e konstatuara, janë zhvilluar trajnime si për shembull për kuptimin e kurrikulës nga stafi i ri, përdorimin e teknikave moderne të mësimdhënies etj. [Ev. <b>RVB; Certifikatat e trajnimeve te stafit nga IKT</b>]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Në përmbushje</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

**Standardi VI.3**



**Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësisia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Elementë të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit mundësohen nga pyetsori i vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së lëndëve të programit të studimit, i cili plotësohet në fund të çdo semestri, proces i cili drejtohet dhe monitorohet nga NJSBC. Një burim tjetër që mundëson krijimin e tabloje më të plotë për ecurinë e programit të studimit dhe respektimin e standarteve të cilësisë, është vlerësimi i programit nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Ky proces, i cili paraprihet nga hartimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe plotësimi i Dosjes së Vetvlerësimit, shoqërohet me vizitën në institucion të ekspertëve të vlerësimit të jashtëm, përgatitjen e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm dhe me vendimmarrjen e Bordit të Akreditimit. Konkluzionet dhe rekomandimet e formuluar nga Bordi i Akreditimit përbëjnë një bazë të mirë nga e cila niset institucioni për përmirësimin e programit. Në rastin e programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni", akreditimi i mëparshëm ka qenë me afatin 3 vjet dhe është shoqëruar me disa rekomandime. Institucioni, në shërbim të përmirësimin të cilësisë, u është referuar rekomandimeve të Bordit të Akreditimit shprehur në Vendimin Nr.75, datë 4.10.2019, duke i trajtuar e dhënë zgjidhje problematikave të ngritura. GVJ është i mendimit se rekomandimet e Bordit të Akreditimit janë përmbushur. <b>[Ev. Akreditimi i pare i programit MSc ne Inxh Kompj dhe IT me tre profile nr. 75 date 17.04.2019, RVB; Manuali i Sigurimit te Cilesise - QAU Handbook].</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Procesi i vlerësimit të brendshëm në institucion bazohet në Kodin e Cilësisë të Arsimit të Lartë, Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit, Statutin e KU IKT dhe Manualin e Sigurimit të cilësisë të KU IKT. Mbi këtë bazë përdoren një sërë pyetsorësh (shih më sipër) të cilët plotësohen në rrugë elektronike, dhe përmirësohen nga NJSBC duke pasqyruar edhe eksperiencën kanadeze <b>[Ev. Takime me NJSBC]</b>. Veç këtyre, një informacion i vlefshëm</p>

	<p>tërhiqet edhe nëpërmjet tryezave të rrumbullakta dhe vlerësimeve prej ekspertëve të jashtëm, Raportet vjetore për MAS, studime për tregun e punës pas diplomimit etj. [Ev. RVB; Takime në institucion; Evidenca te organizimit te tryezave te rrumbullakta me kompanite, bizneset; Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Referuar RVB, metodat e drejtpërdrejta të përdorura në procesin e vlerësimit kanë përfshirë, takimet e autoriteteve drejtuese me studentët, takimet e autoriteteve drejtuese me qeverinë studentore, takimet e përgjegjësve të departamenteve me studentët e programeve të studimit, takimet me studentët ALUMI, vëzhgime në auditor për metodat dhe pedagogjinë e mësimdhënies së stafit akademik apo angazhimin e studentëve, vlerësimet e testimeve dhe ecuria gjatë një viti akademik e studentëve programit, analizë e problematikave lidhur me frekuentimin dhe kalueshmërinë etj. GVJ pati rastin të konfirmojë një pjesë të këtyre elementëve gjatë takimeve në institucion me stafin akademik, studentët, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm dhe NJSBC [Ev. Takime në institucion].</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program</p>	<p>Referuar RVB, institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si pyetësorë, anketime, raporte vjetore, raporte vlerësimi programi, raporte vlerësimi prej strukturave drejtuese, vetvlerësim të stafit akademik, RVB për proceset e akreditimit të programit, RVJ për proceset e akreditimit të programit, pyetësorët me studentët ALUMNI, vlerësimet e studentëve ALUMNI, gjurmimin e studentëve dhe mbledhjen e të dhënave për punësimin (për punësimin në profil ose jashtë profili etj), takimet me ALUMNI në institucion, gjatë trajnimeve ose në sipërmarrjet ku ata punojnë. Evidencat e paraqitura dëshmojnë për përdorimin e metodave dhe instrumenteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të vlerësimit në institucion [Ev. 28. Model Pyetesori Master CE (Computer Engineering &amp; IT); 29. Model Pyetesori per Stafin; Takime në institucion; 4. Vleresimi i Programit te Studimit, Tregu i</p>

	<b>Punes dhe te dhena per studentet pas diplomimit 2019-2021].</b>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>		<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi VI.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**


<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Sigurimi i brendshëm i cilësisë në institucion menaxhohet nga NJSBC, aktiviteti i së cilës synon përfshirjen e numri sa më të madh aktorësh të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Në varësi edhe të fushës së ekspertizës, aktorët e brendshëm angazhohen më tepër në drejtim të përmirësimit të cilësisë së mësidhënies në gjithë elementët përbërës të saj, ndërsa aktorët e jashtëm kontribuojnë në drejtim të përshtatjes së programit të studimit me kërkesat e tregut të punës. I gjithë aktiviteti i NJSBC bazohet në Statutin e KU IKT, Librin e Rregulloreve dhe në mënyrë të veçantë në Manualin e Sigurimit të cilësisë të KU IKT. [Ev. RVB; Manuali i Sigurimit të Cilësisë - QAU Handbook]. Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit nga NJSBC me rëndësi konsiderohet edhe informacioni dhe eksperiencat e përftuara në kuadër të mobiliteteve në universitete jashtë vendit [Ev. Takime në institucion; Marreveshjet ne kuader te Erasmus+ 2016-2022].
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Referuar RVB, përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë dhe strukturat e angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë janë të përcaktuara në dokumentet bazë si Organizimi i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, Politikat dhe procedurat e vetëvlerësimit, Manualin e Sigurimit të cilësisë të KU IKT [Ev. Libri i Rregulloreve Institucionale].

<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Vlerësimi dhe sigurimi i cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" është garantuar përmes një procesi gjithëpërfshirës. Nga takimi me GVB, u konstatua se ka patur një koordinim të mirë të të gjithë instancave drejtuese dhe pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve etj. për të mundësuar një vlerësim real të programit të studimit me qëllim jo vetëm përmbushjen e detyrimit ligjor, por edhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programit [Ev. RVB; Takime me GVB].</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Me qëllim sigurimin e brendshëm të cilësisë, në veprimtarinë e saj, NJSBC mbështetet edhe nga institucioni në përgjithësi si dhe nga Fakulteti i Inxhinierisë dhe Departamenti i Inxhinierisë Softuerike në veçanti. Në punën e saj NJSBC zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie. GVJ nuk gjeti praktika të prekjes së integritetit apo ankimimit në lidhje me procesin në përgjithësi si dhe anketimet e kryera në veçanti.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Referuar RVB, në procesin e vlerësimit, Fakulteti i Inxhinierisë ka përfshirë edhe aktorë apo bashkëpunëtorë të jashtëm, në nivel eksperti. DIS ka kryer edhe vlerësime periodike të programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" (i fundit në shtator 2021) për të parë ecurinë e tij si dhe përputhjen me nevojat e tregut. Në këtë rast është konsideruar me prioritet opinioni i bashkëpunëtorëve të jashtëm për të vlerësuar dhe pasqyruar elementë që lidhen me trendet e zhvillimit teknologjik [Ev. RVB; Vlerësimi i Programit të Studimit, Tregu i Punës dhe të dhëna për studentet pas diplomimit 2019-2021; Evidenca të organizimit të tryezave të rrumbullakta me kompanite, bizneset].</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi VI.5**

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Transparenca e veprimtarive në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit sigurohet nëpërmjet publikimit të rezultateve në trajtën e raporteve, manualeve dhe vlerësimeve që kanë të bëjnë me institucionin dhe studentët. Një pjesë e këtij informacioni bëhet publik nëpërmjet faqes web të institucionit dhe është i aksesueshëm nga gjithë të interesuarit [Ev. <a href="https://cit.edu.al/quality-assurance-unit-2/">https://cit.edu.al/quality-assurance-unit-2/</a>]. Një numër elementësh gjejnë vend edhe në Raportin Vjetor që institucioni përgatit për MAS [Ev. <b>Raport Institucional Vjetor i KU 'IKT' 2020 - 2021 per MAS</b>].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Informacioni me rezultatet e vlerësimeve të publikuara në faqen web të institucionit respektojnë lirinë akademike si edhe ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, ndryshuar me ligjin nr.48/2012 dhe ligjin nr.120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, duke garantuar ruajtjen e konfidencialitetit [Ev. <a href="https://cit.edu.al/quality-assurance-unit-2/">https://cit.edu.al/quality-assurance-unit-2/</a>]. Gjithashtu, stafi akademik i KU IKT, me nënshkrimin e kontratës së punës pranon të respektojë konfidencialitetin për një numër elementësh me të cilët ka të bëjë gjatë aktivitetit të tij në KU IKT [Ev. <b>Kontrate tip Stafi</b>].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Nga takimi në institucion GVB u informua për elementë të cilët kanë qenë në fokusin e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit e që kanë rezultuar nga anketimet e kryera. Po ashtu, në raportet e përgatitura për instancat e ndryshme, ka elementë të rekomandimeve apo përmirësimeve të nevojshme. Një rol me rëndësi luan dhe Qendra për Inovacionin, Kërkimin dhe Zhvillimin (CIRD) duke përgatitur raporte me përmbledhje të dhënash lidhur me arritjet akademike dhe kryesisht kërkimin shkencor lidhur me programin e studimit, duke përcaktuar edhe objektiva për të ardhmen si dhe elementë që duhen përmirësuar. Gjithashtu, GVJ është i mendimit se, adresimi i problematikave të konstatuara gjatë hartimit të RVB dhe të dala gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm dhe Vendimit të Bordit të Akreditimit për</p>





	akreditimin institucional dhe akreditimin e mëparshëm të programit të studimit, konfirmojnë angazhimin e institucionit në këtë drejtim.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Procesi i vlerësimit dhe sigurimit të efektivitetit dhe impaktit të veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit është një proces kompleks i cili kërkon angazhimin e të gjithë strukturave të institucionit. Në nivel institucioni kjo, sipas RVB, realizohet përmes strategjive, matshmërisë së realizimit të objektivave, studimeve të tregut, raporteve, analizave, vlerësimeve të brendshme dhe të jashtme, pyetësorëve dhe anketimeve, angazhimin të ekspertëve dhe të gjitha instrumenteve të tjera akademike dhe administrative. <i>Megjithatë, GVJ është i mendimit që, një proces i monitoruar në mënyrë më gjithpërfshirëse, me rekomandime mbi bazë vjetore duke u nisur nga analiza të brendshme për çështje të caktuara, do të kishte një impakt më të spikatur në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe rritjen e numrit dhe cilësisë së studentëve të rregjistruar në këtë program studimi.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Referuar RVB, me stafin akademik të Departamentit të Inxhinierisë Softuerike, NJSBC ka zhvilluar takime të ndryshme për të diskutuar mbi proceset e vlerësimit të programeve të studimit, vlerësimin e programit të lëndës si dhe mbi rregulloret që standardizojnë sigurimin e cilësisë. Gjithashtu, hartimi i RVB dhe grumbullimi i informacionit për DVV ka qenë një proces në të cilin është angazhuar jo vetëm GVB, por edhe gjithë instancat drejtuese të KU IKT, njësia përgjegjëse për programin e studimit si dhe studentët nëpërmjet përfaqësuesit të tyre. Në këtë mënyrë, nga një analizë e thelluar e programit të studimit, është mundur evidentimi i pikave të forta, dobësive, kërcënimeve dhe janë paraqitur mundësitë që paraqiten para studentëve të këtij programi.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni" me profile "Inxhinieri Kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn"**

**a. Pikat e forta dhe Afirmime:**

1. Fakulteti i Inxhinierisë dhe Departamenti i Inxhinierisë Softuerike organizojnë këtë program studimi përmes angazhimit të një stafi akademik të motivuar dhe me kualifikimin e kërkuar për të garantuar një mësimdhënie cilësore;
2. Zhvillimi i Inxhinierisë Kompjuterike dhe Teknologjisë së Informacionit e bën këtë program të kërkuar në tregun e punës;
3. Infrastruktura, laboratorët janë sipas standardeve të kërkuara për të garantuar cilësinë në mësimdhënie;
4. Zhvillimi i mësimin në gjuhën angleze i cili favorizon mobilitetet si për studentët ashtu dhe për personelin akademik, mundëson aksesin në një literaturë të gjerë teknike si dhe lehtëson njohjen e këtij programi edhe jashtë vendit;
5. Një bibliotekë e pasur e cila përbëhet nga dy pjesë integrale: biblioteka me libra të printuar dhe biblioteka virtuale në sajë të marrëveshjes me McGraëHill Education dhe O'Reilly që mundësojnë aksesin në tekste që u korrespondojnë viteve të fundit;
6. Ndjekja e një politikë integruese për staf akademik të huaj me përvojë në institucione të njohura jashtë vendit;
7. Marrëdhënie të institucionalizuara me universitete të huaja homologe dhe ato brenda vendit, përfshirë edhe biznesin, në shërbim të kualifikimit dhe shkëmbimit të eksperiencave;

**b. Pika të dobta:**

1. Numri i të diplomuarve për profilin "Multimedia Dizajn" është i ulët, dhe asnjë prej tyre nuk është punësuar në lidhje me diplomën; (*Standardi V.4, Kriteri 5*);
2. Masa e financimit, kërkim shkencor plus konferenca, e marrë së bashku, është relativisht e ulët; (*Standardi IV.6, Kriteri 2*).


## **Rekomandime**

1. Për profilin Multimedia Dizajn, duke qenë se në 5 vitet e fundit janë diplomuar vetëm 2 studentë (dhe asnjë prej tyre nuk është punësuar në përputhje me diplomën), nga ana e DIS nevojitet një analizë e detajuar e shkaqeve si dhe dhënia e zgjidhjeve të përshtatshme për të garantuar vazhdimësinë e këtij profili;
2. Rritje më tej të peshës së financimit për zërat kërkim shkencor dhe konferenca në vitet në vijim;
3. Një proces i monitoruar në mënyrë më gjithpërfshirëse, me rekomandime mbi bazë vjetore duke u nisur nga analiza të brendshme për çështje të caktuara, do të kishte një impakt më të spikatur në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe rritjen e numrit dhe cilësisë së studentëve të regjistruar në këtë program studimi;
4. Duke qenë se sistemi i informacionit i KU IKT (UMS) nuk e ka arritur akoma fazën e një sistemi informacioni tërësor për të menaxhuar plotësisht informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit, rekomandohet përmirësimi i tij i mëtejshëm;

## **Conclusions of the evaluation of the second cycle program Master of Science in "Computer Engineering and Information Technology" with profiles "Computer Engineering and Big Data"; "Computer Networks and Cyber Security"; "Multimedia Design"**

### **a. Strengths and affirmations:**

1. The Faculty of Engineering and the Department of Software Engineering organize this study program through the commitment of a motivated academic staff with the required qualification to guarantee quality teaching;
2. Advancements in computer engineering and information technology make this program in demand in the labor market;
3. The infrastructures, the laboratories comply with the standards required to guarantee the quality in teaching;
4. The teaching in English, which promotes the mobility of students and academic staff, allows access to a wide technical literature and facilitates the recognition of this program abroad;
5. A rich library which consists of two integral parts: a library with printed books and a virtual library thanks to the agreement with McGrawHill Education and O'Reilly which allow access to books corresponding to the last years;
6. Pursuing a policy of integration of foreign academic staff with experience in recognized institutions abroad;



7. Institutionalized relations with counterpart foreign universities and those within the country, including business, in the service of qualification and the exchange of experiences.

**b. Weaknesses**

1. The number of graduates for the "Multimedia Design" profile is low, and none of them have been employed in connection with the degree (*Standard V.4, Criteria 5*);
2. The amount of funding for scientific research plus conferences, taken together, is relatively low (*Standard IV.6, Criteria 2*).

**Recommendations:**

1. For the Multimedia Design profile, given that only 2 students have graduated in the last 5 years (and none of them have been employed in accordance with the degree), a detailed analysis of the causes and the provision of solutions by the DIS are necessary to guarantee the sustainability of this profile;
2. Further increase in funding for scientific research and conferences in the following years;
3. A process monitored in a more inclusive way, with recommendations on an annual basis starting from internal analysis for certain issues, would have a greatest impact on improving the quality of teaching and increasing the number and quality of students enrolled in this study program;
4. Given that the information system of KU IKT (UMS) has not yet reached the stage of a all-inclusive information system to fully manage the information, documentation and activity of academic staff, academic support staff, administrative staff and partners engaged in the realization of program, its further improvement is recommended;

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

